



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 17 SHTATOR 2012**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 17. SEPTEMBRA 2012. GODINE**

**SHTATOR - SEPTEMBAR
2012**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Debat parlamentar, sipas kërkesës së deputetit Visar Ymeri, mbështetur edhe nga gjashtë deputetë të tjerë lidhur me procesin e privatizimit në Kosovë,
4. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Avokatit të Popullit për vitin 2011,
5. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2011,
6. Shqyrtimi i Raportit vjetor të performansës me pasqyrat e audituara financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2011.

Dnevni red

1. Vreme za deklarisanja van dnevnog reda,
2. Vreme za parlamentarna pitanja,
3. Parlamentarna rasprava, prema zahtevu poslanika Visar Ymeri, uz podršku još šest ostalih poslanika u vezi procedure privatizacije na Kosovu,
4. Razmatranje godišnjeg Izveštaja Narodnog advokata za 2011. god.
5. Razmatranje godišnjeg Izveštaja centralne banke Republike Kosova za 2011. god.
6. Razmatranje godišnjeg Izveštaja performansi sa revidovanim finansijskim pregledima kancelarije generalnog revizora za 2011. god.

Seancën e drejtoi kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuari zëvendëskryeministër,
Ministra të Kabinetit qeveritar,
I hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Koha është e kufizuar në 30 minuta, diskutimet në emër të grupeve parlamentare janë 5 minuta, në emër të deputetëve 3 minuta. Fillojmë sipas radhës. Deputeti Halit Krasniqi e ka kërkuar fjalën.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryetar!
Përsëritet për të gjithë,
Kur PDK-ja e ka marrë besimin e shumicës së votuesve dhe është ngarkuar me përgjegjësi për ta drejtuar qeverisjen e vendit, ka qenë fat për këtë vend.

Ky besim nuk bën të venitët dhe përgjegjësisë së besimit nuk bën t'i iket. PDK-ja mund t'i ndërrojë politikat e Qeverisë, por në favor të ruajtjes së kontrollit të tërësisë territoriale, mund ta ndërrojë ekipin e Qeverisë në masën e lejuar, por vetëm për suksese më të mëdha. Mund t'i rrisë partnerët në koalicion, por vetëm për unitet të vendit, mund ta ndërrojë edhe partnerin e koalicionit, por vetëm për ta forcuar sigurinë dhe për ta bërë kult respektimit e ligjit, mund të bëjë edhe veprime të tjera, por assesi të lëshojë drejtimin e Ekzekutivit. Mund të ndërrohen ministrat, zëvendëskryeministrat, por kryeministri assesi, sepse në fushatën elektorale ka qenë kryeprotagonist, kur e ka rrezatuar edhe besimin e pakonkurrencë. Duhet të justifikohet ky besim, duke mos reshtur për t'i përmbushur premtimet e fushatës elektorale.

Besimi i plotë i kryeministrit nuk bën të huazohet nga të tjerët, as besimi në PDK për të qeverisur nuk mund të konvertohet te një subjekt tjetër, aq më pak tani kur brishtësisë së koalicionit i vijnë goditje nga më të ndryshmet, njëra pas tjetrës, duke dëshmuar publikisht anëtarët e Kabinetit njëri për tjetrin, madje edhe për vete, për konsumim të veprave penale. Për këto çështje duhet ta thonë fjalën e vet institucionet e drejtësisë. Këtu as si jurist nuk i jap të drejtë vetes të sugjeroj ndonjë gjë, por institucioni i moralit politik, i cili duhet të funksionojë vazhdimisht, e sidomos në këto zhvillime, e kërkon dorëheqjen nga funksioni ekzekutiv doemos dhe në mënyrë të parevokueshme për t'i krijuar hapësirë të lirë për veprime institucionale drejtësisë. Goditje më e rëndë në imazhin e Qeverisë nuk mund të gjendet deri tani.

Babëzia për pushtet e pasuri nuk mund të merret me mend se mund të shpjerë deri këtu. Institucioni i besimit qytetar është trandur, por edhe besimi i administratës së shtetit për

ta kryer një procedurë pa ndërhyrje dhe pa mitë është vënë në dyshim. Kur mitë duhet të japin figurat më të larta të Qeverisë, si mund të kryejnë shërbime të tilla qytetarët pa ndërhyrje, në një mënyrë apo një tjetër, kur toleron, bie në dilema e hamendësohet për ta denoncuar një vepër penale një zëvendëskryeministër, duke i lejuar vetes të konsumojë dyshim për vepër penale të moskallëzimit, është moment për alarm në ndërgjegjen tonë. As besimi në eksperiencën e kryeministrit, as vlerësimi i lartë nga institucionet ndërkombëtare për karizëm e rrezatim vlerash, as përkushtimi i tij në parime e devocion të dëshmuar, as eksperiencia e tij jetësore në lidhshmëri nuk e bëjnë Kabinetin qeveritar imun sa akti i dorëheqjes i atyre që janë implikuar në dyshime të konsumimit të veprës penale. Ky akt, së bashku me veprimet tjera pragmatike që do t'i sugjerojë PDK-ja, e që kanë besim në eksperiencën e kryeministrit, do t'i implementojë me sukses do ta kthejmë besimin e lëkundur në Kabinetin qeveritar, të riformatizuar doemos.

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Alma Lama.

ALMA LAMA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Çështja që dua të ngre sot ka të bëjë me Radiotelevizionin e Kosovës. Pak ditë më parë, në adresën e redaksive të mediave, si dhe besoj edhe në adresa të deputetëve kanë ardhur materiale, të cilat sjellin fakte për keqpërdorime të jashtëzakonshme në këtë institucion.

Nuk bëhet fjalë për disa qindra euro, por për miliona. Dokumentet që serviren sjellin dëshmi për afera korrupsioni në shkallë të lartë, për kontrata favorizuese, për financime të pajustificueshme. Në këto dokumente janë faksimilet e transferove të parave të bëra nëpërmjet bankës që atakojnë menaxhmentin e RTK-së dhe pjesë të tjera të stafit dhe në rast se këto dëshmi provohen nga institucionet kompetente si të vërteta, Radiotelevizioni Publik do të jetë në krye të top-listës së institucioneve më të korruptuara në Kosovë. Dëshmitë flasin për serialet pa ndonjë vlerë që janë paguar më shumë se 20 000 euro për seri, e të cilat nuk i janë nënshtruar ndonjë konkursi publik kur janë kontraktuar. Favorizimi i një grupi është i dënueshëm, pasi e dëmton konkurrencën e vlerave në treg. Dokumentet sjellin dëshmi se si klientelizmi e nepotizmi kanë çuar në shpërdorimin e qindra-mijëra eurove. Këto shpërdorime e kanë futur RTK-në në një borxh prej 2,7 milionë eurosh. Kjo është shifra zyrtare që është pranuar zyrtarisht edhe nga menaxhmenti.

Shkelja e ligjit për hapësirën reklamuese është një çështje tjetër. Këto të dhëna nuk janë paraqitur me hollësi në raportin vjetor për vitin 2011, që i është dorëzuar Kuvendit, e i cili nuk është miratuar, pasi nga deputetët janë kërkuar të dhëna shtesë. Kjo do të thotë se RTK-ja i ka fshehur edhe të dhënat. Unë do t'ua dërgoj më vonë në postën elektronike të gjithë deputetëve materialet, në mënyrë që secili ta bëjë krahasimin e të dhënave dhe ju inkurajoj të gjithëve që ta thoni të vërtetën, e jo të frikësoheni se më pas nuk u jep hapësirë RTK-ja.

Të nderuar kolegë,

Të gjitha këto që thashë më sipër kanë të bëjnë me aspektin financiar, e jo me përmbajtjen programore apo editoriale. Politizimi, anshmëria, propaganda proqeveritare

janë një histori tjetër, ku nuk dua të ndalem sot. Mirëpo, ajo që dua të them është se kur një institucion, që në përshkrimin e punës e ka informimin e drejtë dhe të paanshëm të publikut, shndërrohet në një kompani që gllabëron para në mënyrë të paligjshme, kemi të bëjmë me një deformim të skajshëm të misionit për të cilin është krijuar.

Lëvizja “Vetëvendosje” kërkon mbështetje për ngritjen e një komisioni hetimor parlamentar, i cili duhet ta shqyrtojë çështjen e menaxhimit të buxhetit nga RTK-ja. Po ashtu, i kërkon Bordit të Drejtorëve të sapozgjedhur që të sjellin në Kuvend në mënyrë urgjente raport të saktë në lidhje me situatën financiare të RTK-së. Është e domosdoshme...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Regjia, në emër të grupit!

ALMA LAMA: ...që institucionet kompetente, Agjencia Kundër Korrupsionit, Auditori i Përgjithshëm dhe Prokuroria të mos rrinë të bëjnë sehir, por të merren me këtë çështje. Dhe, në fund, shpresoj që RTK-ja nuk do të nxjerrë ndonjë avokat apo tellall, siç bën zakonisht, që të thotë se kjo është ndërhyrje politike në punën editoriale. Kjo që po kërkojmë ne sot është kërkesë për transparencë në lidhje me shpërdorimet e mundshme të parave të taksapaguesve të qytetarëve të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Emilija Rexhepi.

EMILIJÀ REDŽEPI: Poštovani predsedniče!

Poštovani predstavnici Vlade,

Kolege poslanici,

Za ovom govornicom želim istaći jednu problematiku u prizrenskom regionu, odnosno zabrinutost roditelja i učenika u nastavi na bosanskom jeziku.

I pored svih napora koje rukovodstvo naše Skupštine opštine grada Prizrena čini da bi rešilo sve probleme koje imamo na nastavi na bosanskom jeziku, neophodna je pomoć sa centralnog nivoa, odnosno podrška Ministarstva za obrazovanje oko otvaranja jednog novog odeljenja u srednjoj školi gimnazije “Đon Buzuku” u Prizrenu, gde ima više od 50 odličnih učenika, a samo je jedno odeljenje u programu. Tako da molimo centranu vlast i ministra, i pored njegove samo usmene podrške, da da pismenu podršku Direktorijatu obrazovanja u Skupštini opštini Prizrena, kako bi se ovaj problem rešio u pozitivnom smislu. Zahvaljujem se!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Fadil Demaku.

FADIL DEMA KU: I nderuari kryetar i Kuvendit!

I nderuar zoti zëvendëskryeministër, ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Dua ta ngre një çështje që ka të bëjë me krijimin e kuadrove për tregun e punës në Republikën e Kosovës.

Krijimi i kuadrove në shpërputhje me nevojat e tregut është një proces që na përcjell që nga e kaluara në vendin tonë. Universitetet në gjithë botën, siç e dimë, janë transferuesit e dijes ndër gjenerata. Ato janë edhe promotorë të zhvillimit ekonomik. Në vendin tonë, i gjithë marketingu i madh që bëhet nga universitetet e ndryshme që i joshin të rinjtë në forma nga më të ndryshme që të bëhen pjesë e studimeve në to, nuk kanë bërë edhe oferta, të cilat do të ishin risi për ambientin tonë dhe për nevojat e tregut të punës. Përkundrazi, ato kanë vazhduar me të njëjtin sistem vit pas viti, duke i promovuar profilet “atraktive” me një tendencë të krijimit të një opinioni të qëllimshëm në emër të sistemeve bashkëkohore dhe me perceptimin se lehtë edhe mund të diplomohesh në to.

Disa universitete në Republikën e Kosovës janë shndërruar në biznese mjaft fitimprurëse. Duke angazhuar numër të madh të studentëve, po e krijojnë një treg sasior të kualifikuarve, që në tregun tonë të punës përbëjnë shumë më tepër ofertë se sa që ka realisht kërkesë për ta. Është e nevojshme besoj që institucionet tona përgjegjëse, krahas bërjes së shumë ligjeve për fushën e arsimit, në përgjithësi, të krijojnë strategji të qartë dhe mekanizma, të cilët do t'i shërbenin krijimit të sa më shumë profileve arsimore, të atilla që do ishin në funksion të dinamikës së tregut të punësimit. Kosova është e njohur si një vend me pasuri të ndryshme, por esenciale është sa dhe si mund të bëhet shfrytëzimi i tyre. Është e ditur se shfrytëzimi i kapaciteteve ka të bëjë shumë me faktorin njeri, e kjo është derivat i cilësisë së arsimit.

Edhe pse te ne ka një forcë pune mjaft të re, ajo nuk është shumë atraktive për investitorët, për shkak të arsimimit joadekuat. Është i domosdoshëm krijimi i një force punëtore të kualifikuar dhe inovatore, që do të përdorej lehtë nga bizneset e reja. Do të ecnim në hap me kohën dhe si rezultat do të zvogëlohej numri i të papunëve me përgatitje universitare, do të ndihmohej kreativiteti i njerëzve për sipërmarrje të ndryshme, do të mundësohej zgjerimi dhe shumëllojshmëria e bizneseve. Edhe në Raportin e Progresit është evidentuar si problematik funksionimi dhe lidhja ndërmjet tregut të punës dhe sistemit arsimor. Tregu i punës kërkon përkushtim më analitik dhe më shkencor që nxjerrja e kuadrove të përkohë me kërkesat dhe të ketë një harmonizim të plotë ndërmjet tyre. Kjo do të ishte në interes të vendit tonë. Besoj në një të ardhme jo të largët, edhe rezultatet nuk do të mungonin. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Xhevahire Izmaaku.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryetar!

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Të respektuar kolegë deputetë,

Përdorimi i simboleve kombëtare shtetërore dhe ekspozimi i tyre më shumë se asnjëherë tjetër, më bëri përshtypje me rastin e vizitës së presidentit të Shqipërisë zotit Nishani, mëngjesin e ditës kur ai po hynte në Prishtinë. I gjithë sheshi ishte i mbushur me flamuj kombëtarë e shtetërorë dhe, më shumë se herë të tjera, Prishtina dukej e pastër dhe e bukur.

Por, çka nuk i shkonte aspak kësaj feste, dhe asnjë feste tjetër, ishte vendosja e flamujve kombëtarë e shtetërorë në mënyrë aspak dinjitoze, ashtu siç duhet trajtuar simbolet shtetërore e kombëtare. Me përjashtim të objektit të Kuvendit, këta flamuj të vendosur në vendet e duhura nuk ishin të duhurit, të shlyer e të vjetër. Të vendosur të tillë vazhduan edhe në festën e përmbylljes së mbikëqyrjes së pavarësisë. Tema ime, pra, ka të bëjë me ekspozimin e flamujve kombëtarë e shtetërorë të vjetër e të zhubrosur në objektet publike dhe private, pa u kontrolluar nga askush. Në shesh, në shkolla, në qendra kulturore, në rrugë, e ku jo tjetër, shohim për çdo ditë flamuj të tillë, disa nga të cilët vendosen me rastin e festave tona të ndryshme dhe disa të tjerë nuk largohen fare derisa era, shiu e dielli t'ua humbë krejt në fund edhe formën, edhe dukjen. Konkretisht, e kam vëzhguar ditë e javë të tëra flamurin e madh shtetëror në hyrje të Rrethi, në Prishtinë pra, të cilin po e shihja me javë të tërë ashtu të shlyer e me fije të dala, por edhe të dëmtuara shumë. Kështu ishte edhe sot në mëngjes.

Dhe, ishte për keqardhje ato ditë se si së paku nuk u kujtua askush nga e gjithë Administrata e Komunës së Prishtinës të kërkonte zëvendësimin e tij me një të ri. Po e shihja edhe hotelin "Grand" që, si duket, nga paslufta askush s'i ka hequr ata flamuj, që më nuk ngjajnë në flamuj. Por, jo vetëm Komuna e Prishtinës, por fatkeqësisht gjithkund nëpër Kosovë secili nga ne mund ta shohë një pavetëdijesim tonin qytetar dhe institucional të mosrespektimit të simboleve tona shtetërore e kombëtare, edhe ndërkombëtare. Por, edhe të një mosinteresi të institucioneve tona, pa dallim, nëpër secilën komunë e secilin vend, një jokontroll për mirëmbajtjen e tyre. Që nga paslufta, ne e dimë se edhe objektet tona publike dhe private i janë nënshtruar kushtimisht një fenomeni emocional të përdorimit të simboleve të ndryshme kombëtare dhe shtetërore, e më së shumti vendosjes së tyre, edhe atyre të shteteve tona mike që e ndihmuan vendin tonë. Unë jam e sigurt se nuk i bëjmë nder asnjë shteti mik, kur një qytetar a përfaqësuesi i tij vjen dhe e sheh flamurin e tij të vendosur, e të lënë në harresë, të shlyer nga era dhe dielli.

Mendoj që tani më ka kaluar mjaft kohë për të mësuar nga gabimet, të mësohemi që me detajet e vogla të dukemi të mëdhenj, të marrim mësim, pse jo edhe nga shtetet, si: Franca, Turqia, SHBA-ja, që dënim i është goxha i madh për atë person që nuk e respekton edhe formalisht mirëmbajtjen e flamurit të vet. Jo më në Kosovën, shtet i pavarur, flamuj të zhubrosur e të shlyer, e të harruar mbi kulmet tona, në sheshet tona! Mirëmbajtja e simboleve dhe ekspozimi i tyre të bëhet në mënyrë të dinjitetshme dhe të mbrohen në mënyrë të dinjitetshme. Faleminderit!

(Drejtimin e seancës e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Musliu e ka fjalën.

GANIMETE MUSLIU: I nderuari kryesues i Kuvendit!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuara kolege dhe ju kolegë deputetë,

Pas 100 vjet përpjekjesh mbinjerëzore për liri dhe dinjitet të shqiptarëve, këtë vit u promovua Abetarja e përbashkët mbarëshqiptare.

Kësaj abetareje i zbehet kuptimi përderisa fëmijëve të Preshevës, Medvegjës e Bujanocit u mohohet e drejta për të mësuar me të, ndërsa mësuesve të cilët tentojnë ta praktikojnë atë u kanoset rreziku permanent. Shqiptarëve të këtyre tri komunave u janë bërë e po u bëhen padrejtësi në vazhdimësi, andaj kërkoj nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë që ta luajnë rolin e tyre që kjo abetare ta gjejë implementimin në Preshevë, Medvegjë e Bujanoc. Përndryshe, Abetarja mbarëshqiptare do të jetë e zbehtë dhe nuk do ta ketë kuptimin e plotë të Abetares mbarëshqiptare.

Banorët e Luginës së Preshevës, Medvegjës e Bujanocit janë të shtyrë që edhe më tutje të mësojnë nga abetarja që është e zhveshur nga gjithçka që ka të bëjë me identitetin, historinë dhe prejardhjen e tyre. Përderisa Evropa propagandon për çdo ditë për rëndësinë e respektimit të të drejtave themelore të minoriteteve në Kosovë, e shoh të arsyeshme që këto të drejta të kërkojnë edhe për shqiptarët e Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit. Përndryshe, ne nuk do të mund të zhvishemi asnjëherë nga akuzat për zbatim të standardeve të dyfishta kur janë në pyetje të drejtat themelore të njeriut.

Edhe njëherë, si deputete, u bëj thirrje të dy qeverive që ta përdorin ndikimin e tyre politik e diplomatik në arenën ndërkombëtare që të respektohen të drejtat themelore të shqiptarëve kudo që janë në tokat e tyre në rajonin e Ballkanit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja Kadaj-Bujupi, pyetje për zotin Hoxhaj. Zoti Hoxhaj nuk është këtu, e as deputetja.

Deputeti Visar Ymeri, pyetje për ministrin Mujota.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Zoti ministër, në fund të gushtit të këtij viti, ministria juaj, nëpërmjet këshilltarit Lah Nitaj, ka raportuar se konsorciumit “Bechtel&Enka” i janë paguar deri tash gjithsej 509 milionë euro për 44 km autoudhë, të cilat janë lëshuar në përdorim. Ndërkohë, që kur ishin lëshuar në përdorim 38 km e parë, ministria juaj pati deklaruar se ato patën kushtuar 330 milionë euro. Pra, çmimi mesatar për kilometra atë botë i binte të jetë 8,68 milionë euro, ndërkohë që tash ky çmim mesatar është rritur 12,11 milionë euro. A mund të na tregoni çka po e shkakton këtë rritje të çmimit kaq enorme në këtë projekt?

KRYESUESI: Zoti Mujota, e keni fjalën.

MINISTRI FEHMI MUJOTA: Faleminderit! I nderuari nënkryetar!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit të Qeverisë,

Të nderuar deputetë,

I nderuar deputet Ymeri,

Pyetja juaj, e shtruar me të dhëna, të cilat i keni përdorur, i referohet një shkrimi gazetaresk, të interpretuar si deklaratë e këshilltarit politik, të përgjysmuar.

Unë konsideroj që në vend se t'u referoheni këtyre shkrimeve gazetareske, keni pasur mundësinë si deputet dhe mbi të gjitha si anëtar i Komisionit Funkcional, që bëni mbikëqyrjen e kësaj ministrie të ju referoheni të dhënave zyrtare. Prandaj, unë do t'i përcjell me besnikëri të dhënat zyrtare për shpenzimet e deritashme.

Mjetet financiare të cilat janë paguar për ndërtimin e pjesës së parë të rrugës, përfshirë ndërtimin e rreth 60,4 km, nga Morina deri në Gjurgjicë, përkatësisht për finalizimin e 42km të parë dhe për punët e përfunduara e të faturuara deri më 31 gusht 2012, duke përfshirë këtu sektorin e segmentit të pestë Duhël - udhëkryqi M9 - Gjurgjicë. Pra, i nderuari deputet, ju u referoheni shifrave për 38km e para që janë lëshuar në përdorim, nuk u jeni referuar saktësisht shpenzimeve të bëra për 42 km e finalizuara që janë tani në përdorim dhe punëve, të cilat janë përfunduar në segmentin e pestë. Për dijeninë tuaj dhe të publikut, segmenti i pestë i autostradës i ka 18,4 km gjatësi dhe deri më 31 gusht 2012, punët të cilat janë përfunduar dhe janë faturuar për ministrinë janë pjesë e kësaj pagese prej 516 milionë, tani kur po raportojmë.

Andaj, përgjigjja është kjo dhe unë besoj se ju do të keni mundësi në ditët e ardhshme t'i vizitoni bashkërisht me komisionin parlamentar punimet që kanë hyrë në intensitet të lartë në segmentin e pestë dhe për informimin tuaj dhe të publikut, rreth 80% të punimeve në këtë segment janë përfunduar dhe sipas dinamikës që po ndodh, më 27 nëntor do të bëhet përrurimi i kësaj rruge, i këtij segmenti prej 60,4 km dhe besoj se edhe ju do të mund të udhëtoni në këta 60,4 km drejt Tiranës më datën 28 nëntor.

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zoti Ymeri? Po!

VISAR YMERY: Ministër, faleminderit që po na jepni lejen për të udhëtuar nëpër autostradë. Nuk e kam ditur se duhet leje e veçantë, por mirë që na e dhe.

Pyetja shtesë që lidhet me këtë që e thatë është se së pari mua po më çudit se si nuk keni reaguar ndaj shkrimeve, se nuk është vetëm një shkrim në gazetë që ka dalë, por janë disa media që e kanë raportuar këtë shifër, e ju nuk keni reaguar fare, që është e çuditshme pse ministria nuk reagon ndaj këtyre "keqinterpretimeve", siç po i quani ju. E dyta, është se ju kam pyetur edhe herën e kaluar, kur janë lëshuar 38 km e parë, sipas dinamikës që po e shihni që po ndodh, me shpenzimet edhe koston e përgjithshme, a mund ta kemi një vlerësim real të asaj se sa do të kushtojë përfundimisht kjo autoudhë? Për shkak se në vlerësimet preliminare, në momentin kur janë nënshkruar kontratat dhe pastaj në interpelancën, që e kemi thirrur ne, ju keni thënë që e tërë kostoja e autostradës do të jetë diku 750 milionë euro, pa koston për shpronësim, e tash kemi arritur në shumën prej 509 milionë eurove, ose 516 milionë, siç e thatë ju, ku i kemi të paguara...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Mujota!

FEHMI MUJOTA: I nderuari deputet!

Punimet në autostradë po shkojnë krejtësisht sipas planit të paraparë dhe sipas dinamikës. Jemi brenda shpenzimeve të parapara me Buxhetin e Republikës së Kosovës dhe brenda kontratës. Prandaj, për të gjitha të dhënat që ju ju interesojnë dhe që mund të jenë objekt i komentimit apo debatimit jemi të gatshëm në çdo kohë të japim raporte detaje ashtu siç e kemi bërë edhe në të kaluarën brenda Komisionit FunkSIONAL, por edhe për publikun.

Pra, nuk ka asnjë shqetësim që kontrata nuk po shkon sipas asaj që është paraparë, nuk është ndërruar asnjë presje dhe asnjë pikë nga kontrata që është nënshkruar.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Visar Ymeri, pyetje për ministrin Besim Beqaj. Ministri nuk është këtu. Dëshironi ta bëni pyetjen, ta lexoni apo ta lini për seancën e ardhshme? Zoti Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Vetëm desha edhe pak t'i shtoj asaj që e tha ministri, që mua po më çudit. Pse po thërret që ta bëjmë këtë vlerësimin për autostradën në një mbledhje të mbyllur, e nuk po e tregon në seancë, e cila është e hapur. Shumë e çuditshme!

Sa i përket ministrit Beqaj, i cili nuk është këtu, pyetja ka të bëjë me koston për përdorimin e kodeve të Serbisë dhe Monakos për telefoninë fikse dhe atë të telefonisë mobile, prej kur i përdor Kosova. Pyetja ka qenë pra, sa kemi paguar ne para në buxhetet e këtyre dy vendeve për përdorimin e kodit të tyre?

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Kymete Bajraktari, pyetje për ministrin Ramë Buja. Ministri nuk është këtu, dëshironi ta bëni pyetjen? Deputetja Bajraktari e ka fjalën.

KYMETE BAJRAKTARI: Faleminderit, zoti kryesues!

Pyetja ime ka të bëjë në lidhje me statistikën për numrin e mësimitdhënësve të cilët punojnë në arsim, e që janë në gjendje jo të mirë shëndetësore. Pasi ministri nuk është këtu, do ta lë për seancën e ardhshme dhe shpresoj që ministri do të fillojë të punojë në këtë problematikë dhe në seancën e ardhshme do të na sjell këto statistika. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Hykmete Bajrami, pyetje për ministrin Hajredin Kuçi. Ministri nuk është këtu. Dëshironi ta bëni pyetjen? Zonjës Bajrami fjalën, ju lutem!

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryesues!

Unë po e parashtroj pyetjen, sepse pyetja nuk është shumë ngushtë e lidhur me ministrin. Unë e kam një çështje, e cila më ka brengosur prej kur kam hyrë në Parlament.

Për shkak të situatës politike dhe ndryshimeve të shumta që ka pësuar Kosova që nga paslufta, ky Kuvend, kjo legjislaturë, duke përfshirë edhe legjislaturat e tjera, ka bërë shumë plotësim-ndryshime të ligjeve, duke sjellë për secilin rast një ligj të ri, që e plotëson dhe e ndryshon një ligj ekzistues. Ky proces i plotësimit dhe ndryshimit të ligjeve ka bërë që pothuajse secili ligj të jetë i fragmentuar në disa dokumente, gjë që nuk është fare praktike dhe nuk shkon aspak në favor të zbatimit të ligjeve. Është mirë që të

kemi ligje të mira dhe që u përshtaten rrethanave, por ne mendoj se kemi obligim që të bëjmë ligje, të cilat lehtë zbatohen nga ata që duan t'i zbatojnë.

Pyetja është: A ka mundësi që të gjitha ligjet që si pjesë të tyre kanë një ose dy ligje që i plotëson dhe i ndryshon ato të harmonizohen në një dokument të vetëm, e jo ta kemi ligjin të ndarë në disa pjesë. Nëse po, kush duhet ta bëjë këtë, a është e gatshme Ministria e Drejtësisë ta iniciojë një proces të tillë, apo kjo ndoshta është edhe detyrë e Parlamentit. Edhe unë kisha dashur që kjo të jetë pak ushqim për trurin dhe të mendojmë rreth kësaj çështjeje.

Edhe, po e shoh se Qeveria sot ka frikë nga debati, paskan ikur të gjithë. Kisha dashur ta di, kryesues, a të kanë lajmëruar se kah kanë shkuar?! Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Konstatoj që edhe kjo pikë e rendit të ditës është ezauruar. Para se të kalojmë në pjesën e rregullt të miratuar për rendin e ditës, zoti Grabovci e ka një kërkesë lidhur me rendin e ditës dhe e ka kërkuar fjalën që ta arsyetojë kërkesën në emër të grupit parlamentar. Zoti Grabovci, e keni fjalën.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryesues!

Përshëndetje për të gjithë të pranishmit,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e vlerëson shumë lart kërkesën për debat rreth privatizimit, por vlerësojmë se me qëllim që të jemi sa më të përgatitur dhe vërtet të jemi sa më dobiprurës në sqarimet tona për qytetarët e Kosovës, ne si grup parlamentar kërkojmë që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për një seancë tjetër, për shkak se sot mungon një pjesë e madhe e Kabinetit qeverisës, meqë e dini se janë në udhëtime zyrtare, prandaj vlerësojmë se pa pjesëmarrjen e kryeministrit, të ministrave, të paktën atyre përkatës, ky debat nuk do ta ketë rëndësinë që duhet ta ketë.

Prandaj, unë kërkoj me mirëkuptim nga të gjithë kolegët që ta mbështetin kërkesën e grupit parlamentar dhe këtë seancë ta shtyjme për një seancë tjetër, në të cilën do të jenë të pranishëm kryeministri, Kabineti qeverisës, e nëse shihet e udhës e nevojshme edhe përfaqësuesit e AKP-së. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Sipas Rregullores, duhet të konsultohen kryetarët e grupeve parlamentare, mocionin ose kërkesën ta hedhim në votim. Fjalën, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, e ka kërkuar zoti Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës është që pika e paraparë të mbetet në rendin e ditës, përkatësisht debati, dhe konsiderojmë që nuk ka asnjë arsye që të shtyhet. Nuk e di pse nuk i kanë marrë edhe këta dy ministra edhe të shkonin bashkë, se do t'i kishte zënë aeroplani, pasi qenkan në udhëtime zyrtare, LDK-ja konsideron që shtyrja është e panevojshme, debati është i domosdoshëm të mbahet, për këtë ka arsye të shumta. Ndërkaq, arsye shumë të pakta ose fare nuk ka në arsyetimin ose kërkesën e vetë ministrit që e kemi këtu. Bile-bile thotë "ta harmonizojmë agjendën", mundësisht na këqyrim kur është ai këtu. Kjo është qesharake, është absurde. Vetëm lexojeni pjesën e

fundit, të harmonizohet agjenda me të tijën! Shkurt, LDK-ja është që kjo pikë e rendit të ditës të jetë në seancën e sotme dhe të debatohet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, zoti Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Kjo kërkesë që erdhi tash nga Grupi Parlamentar i PDK-së vërtet po më habit shumë, për shkak se këtë pikë e kemi diskutuar së paku dy herë në mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit, asnjëherë nuk ka pas kundërshtime.

Madje-madje, në mbledhjen e fundit të Kryesisë, kur është caktuar për të hënë që të diskutohet kjo pikë, vetë kryetari i Grupit Parlamentar të PDK-së ka thënë që ndoshta është më mirë ta diskutojmë të enjten, e pastaj të gjithë jemi pajtuar që është më mirë ta diskutojmë të hënë. E, tash po thotë që duhet ta shtyjme. Në anën tjetër, është po ashtu absolutisht e paarsyeshme kjo shkresë që e ka sjellë Qeveria të premten. Ne na është dorëzuar të premten, në orën 15:30, ndërsa thotë se do të ishte mirë që të jetë edhe Qeveria këtu, ndërkohë që kjo kërkesë për debat parlamentar për privatizimin, e cila është dorëzuar nga unë, më 8 gusht të vitit 2012, në Kuvend, i ka shkruar një muaj përpara ministrit dhe ai na e ka kthyer një përgjigje shumë të thjeshtë, në dy faqe, Kryesisë së Kuvendit dhe deputetëve, duke thënë që Qeveria nuk ka çfarë të thotë në këtë çështje, për shkak se nuk është çështje e Qeverisë.

Ju kujtohet fort mirë, atë shkresë ne e kemi lexuar në Kryesi. Madje, ka pasur diskutime në Kryesinë e Kuvendit: a ta ftojme AKP-në, apo jo? Kërkesa për debat i është dërguar edhe AKP-së. AKP-ja nuk ka dërguar kurrfarë shkrese sa i përket këtij debati. As informatë, asgjë tjetër. Dhe tash kërkohet të shtyhet me arsyetimin që duhet të jetë këtu Qeveria dhe duhet të jetë këtu AKP-ja. Ndërkohë që të dyja këto kanë refuzuar kategorikisht të marrin pjesë në këtë debat.

E dyta është se mungesa e Qeverisë në këtë debat nuk është e rastësishme. Ata e kanë ditur që debati po bëhet, ky rend dite është vendosur të martën e kaluar. Pra, të gjithë ministrat, përfshirë edhe kryeministrin, kanë qenë të informuar se të hënë, në Kuvendin e Republikës së Kosovës, do të debatohet për privatizimin. Nuk kanë pasur interesim të marrin pjesë në këtë seancë, madje-madje duket se i kanë ikur qëllimisht kësaj seance dhe tash po kërkojnë ta shtyjnë, në mënyrë që të përgatitemi, siç e tha shefi i grupit parlamentar. Prej 8 gushtit kanë pasur kohë të përgatiten. Pse nuk janë përgatitur? Pra, nëse nuk kanë mundur të përgatiten për dy muaj, nuk përgatiten kurrë. E, natyrisht, s’kanë si të përgatiten se s’kanë çfarë të thonë për këtë çështje.

Dhe, çështja e tretë është se, e kemi diskutuar edhe këtë në Kryesinë e Kuvendit, ky është debat parlamentar, ku deputetët do ta debatojnë një temë të caktuar dhe në fund do ta votojnë një mocion të përbashkët, një rezolutë të përbashkët, po që se dakordohen. Kaq! Nuk ka këtu kurrfarë nevojë që të jetë Qeveria. Po që se Qeveria do të marrë pjesë - është e mirëseardhur, mirëpo kjo nuk është interpelancë, e cila e obligon Qeverinë që të jetë e pranishme në këtë debat dhe sa po e shoh unë - ne Qeverinë e kemi të pranishme këtu. I

kemi tre ministra, ishte edhe një zëvendëskryeministër më herët. Pse nuk e kanë marrë këta përsipër ta mbrojnë këtë çështje? Pse duhet domosdoshmërisht vetëm një ministër të flasë për këtë? Ka mundur t'ia bartë dikujt tjetër, nëse nuk paska mund t'i lërë ato obligimet tjera institucionale.

Po them edhe njëherë, Lëvizja “Vetëvendosje” është kategorikisht kundër që të shtyhet kjo pikë. Është shtyrë mjaft. E dini se me Rregullore, çfarëdo mocioni që dorëzohet në Kuvend duhet të votohet përbrenda tri javësh prej momentit të dorëzimit. Ndërkohë, jemi vonuar një muaj e diçka. Domethënë nuk është as procedurale, e as politike që të shtyhet dhe ne e kundërshtojmë këtë kategorikisht. Jemi për atë që sot të mbahet debati, gjithsesi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i AAK-së, kryetari Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Grupi Parlamentar i Aleancës mendon se nuk ka arsye procedurale për t'u shty debati. Konsideron se ministri Beqaj është dashur të jetë këtu. Mendojmë se fakti që askush prej Qeverisë nuk është këtu, do të thotë askush relevantë për temën për të cilën po flasim, e vë në pozitë të keqe Parlamentin, e zbeh debatin deri në një masë të caktuar dhe, fundi i fundit, po tregon se nuk e ka një koordinim çfarë duhet ta ketë një shtet i pavarur dhe sovran ndërmjet dy institucioneve kryesore të shtetit: Kuvendit dhe Qeverisë.

Si do që të jetë, mendojmë se nuk ka arsye praktike për shtyrje të debatit, por konsiderojmë se debati do të jetë seriozisht me më pak vlerë, meqenëse nuk mund të bëhet debat me ata që vendosin për këto tema. Është e vërtetë, është debat parlamentar, unë e kam thënë, mirëpo ky debat parlamentar është dashur të bëhet ndërmjet Kuvendit dhe Qeverisë, e cila merr vendime nganjëherë edhe pa Kuvendin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Koalicioni Kosova e Re, kryetarja e Grupit, Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Përsëritje për ministrat dhe deputetët,

Duke marrë parasysh diskutimet e të gjitha grupeve parlamentare, po shihet se debati për çështjen e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore dhe ndërmarrjeve publike është vendosur, siç u tha, në mbledhjen e Kryesisë të martën, mirëpo prapëseprapë po shihet që Qeveria nuk është këtu dhe vendimet shumë të rëndësishme për privatizimin e ndërmarrjeve publike duhet të jenë të bashkërenduara ndërmjet Kuvendit dhe Qeverisë, duke marrë parasysh se edhe Ligji për ndërmarrjet publike thotë se një vendim për privatizimin e një ndërmarrjeje duhet të merret brenda Kuvendit të Kosovës, ndërsa Qeveria ta implementojë.

Nuk e di sa do të jemi efektivë të diskutojmë për një temë aq të rëndësishme, kur i gjithë debati do të bëhet vetëm brenda nesh, ndërsa këtu i kemi tre ministra të dikastereve, të cilët nuk mund të japin përgjigje adekuate për përgjegjësitë që i ka Qeveria në raport me çështjen e privatizimit të ndërmarrjeve publike.

Unë, prapëseprapë, them që të mbetet çështje e deputetëve si do të votojnë për këtë mocion. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! SLS-ja, deputeti Milosavleviq.

SAŠA MILOSAVLJEVIČ: Hvala gospodine predsedavajući!

SLS se slaže sa predlogom PDK-a. Mi smatramo da treba da se ova tačka odloži za neku od narednih sednica, jer isto mislimo da treba da budu prisutni adekvatni ministri i Premijer. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi “6+”, zonja Shinik.

MYFERA SHINIK: Teşekkür ederim!

PDK-nın teklifi üzere bu günkü gündemin ertelenmesini 6+ Parlamentar grubu olarak da kabul ediyoruz. Çünkü Hükümetin yeterli derecede temsil olmadığından dolayı bu önerinin bizim de destekleyeceğimizi bildiriyoruz. Teşekkür ederim.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar edhe një herë kryetari i Grupit Parlamentar të PDK-së, zoti Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryesues!

Unë vetëm desha të sqaroj edhe një herë. Me qëllim që kjo çështje ta ketë vërtet atë rëndësinë e duhur, jo për sa për të debatuar, por vërtet për të debatuar dhe për të sqaruar rreth këtij procesi, që është shumë i rëndësishëm për perspektivën e vendit, për ne si grup parlamentar, nuk do ta ketë rëndësinë pa praninë e kryeministrit dhe të ministrave përkatës. Edhe më herët, unë, në mbledhjen e Kryesisë, është e vërtetë se e kam kërkuar për ditën e enjte, duke pasur parasysh se mund të jenë ministrat në vend dhe kësaj çështjeje t’i jepet rëndësia e duhur. Vetëm për këtë arsye, ne kërkojmë shtyrjen, se në mënyrë absolute nuk i ikim debatit dhe jemi ithtarë të asaj që ta debatojmë këtë çështje në mënyrë sa më të detajuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ymeri, edhe një herë.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

U detyrova të reagoj përsëri për shkak se në njërën anë po fliten shumë të pavërteta dhe, në anën tjetër, nuk po trajtohet kërkesa e debatit, siç është shtruar.

Ky debat i sotëm, që e kemi futur në rend të ditës, nuk do të thotë që do të jetë debati i fundit për privatizimin dhe do të kemi edhe debate tjera në Kuvend, e natyrisht që duhet të debatohet shumë më shpesh për privatizimin në Kuvend, ku do të jetë e pranishme edhe Qeveria, ose ministrat përkatës dhe kryeministri, po që se duan të marrin pjesë në një çështje të tillë. Pra, nuk do të jetë i fundit dhe nuk duhet ta trajtojmë si të tillë.

Në anën tjetër, prapë po duhet ta përsëris. Ne të gjithë e dimë që Qeveria nuk ka shprehur interesim të marrë pjesë në këtë debat. E ka thënë vetë ministri Beqaj. Unë kam çfarë të them për temën e kërkuar. E kemi lexuar të gjithë shkresën e ministrit Beqaj. Pse tash po

aktrojmë thua se nuk po e dimë! Domethënë, nuk ka kurrfarë baze për t'u shtyrë ky debat dhe çfarëdo shtyrje ose kërkesë për shtyrje të këtij debati është pikërisht ajo që e tha kryetari i Grupit Parlamentar të PDK-së. Është kërkesë për t'i ikur debatit për një çështje të tillë. Unë nuk po e di se për çka po frikësohen këta njerëz për të debatuar për këtë çështje. Tek e fundit, do të debatojmë dhe në fund po që se merremi vesh do ta votojmë një mocion. Kaq!

Dhe, sa i përket asaj se a duhet të jetë Qeveria në Kuvend edhe t'i bashkërendojmë veprimet tona me Qeverinë, mos e harroni një gjë, deputetë të nderuar, që Kuvendi ka të drejtë të marrë vendime me apo pa pëlqimin e Qeverisë, të cilat pastaj Qeveria është e obliguar t'i zbatojë. Nuk është Kuvendi vegël e Qeverisë, që merr vetëm vendime që i shkojnë për shtati Qeverisë. Është pikërisht roli i Kuvendit në mënyrë që për ta kontrolluar dhe për ta drejtuar punën e Qeverisë të marrë vendime pa praninë e Qeverisë nganjëherë dhe në kundërshtim me planin e Qeverisë për interesa të vendit. Kjo është shumë e rëndësishme, por unë nuk po e kuptoj se në çka po bazohen këto thënie që po i dëgjoj këtu se duhet të jetë doemos Qeveria në mënyrë që ta bëjmë debatin. Natyrisht, do të ishte më mirë që Qeveria, përkatësisht ministrat të jenë këtu dhe të përgjigjen në ato që kemi ne për t'i thënë. Do të ishte mirë. Por, nëse ata nuk duan të marrin pjesë, nëse ata i ikin debatit, ne nuk mund ta shtyjmë atë pafundësisht për shkak se ministrat ose Qeveria nuk do të marrë pjesë.

KRYESUESI: Faleminderit! Nënkryetari Hamiti e ka fjalën.

SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti kryesues!

Zotërinj ministra,

Kolegë deputetë,

Ne e kemi një rend dite përpara, që e kemi aprovuar në Kryesinë e Kuvendit pa asnjë kundërshtim dhe pa asnjë abstenim. Atë Kryesi të Kuvendit e bëjnë nënkryetarët e Kryesisë, në krye me kryetarin e Parlamentit dhe me shefat e të gjitha grupeve parlamentare, bile atje është zhvilluar dy herë një diskutim shumë i gjerë, edhe problemor, edhe procedural, edhe është shumë interesante, është mirë të shihen ato diskutime, kush dhe çka ka thënë atje, se letra i ka të gjitha. Ka shkuar deri atje që, meqë Qeveria ka qenë shumë indiferente, për më tepër me letër ka thënë "na lini rehat, se është agjencia, nëse doni merruni me të, mos u merrni me ne". Pra, këta njerëz i kanë tekstet ku thonë, ky është debat parlamentar dhe s'ka kurrfarë arsyeje që të kushtëzohet me një përbërje të plotë jo të plotë të Qeverisë në Kuvend. Kjo është e vërteta rreth tij.

Sa për data, është shtyrë mjaft deri tash, domethënë nuk ka arsye. A ka nevojë të debatohet? Jo Parlamenti, po Kosova ka nevojë të debatojë për këtë problem, sepse është një prej çështjeve më të mëdha, me të cilat Kosova ballafaqohet. Ne kemi disa vite privatizim që ka prodhuar kundër-efekte ekonomike, kurrfarë efektesh, prandaj është koha e reflektimit si të bëhet kjo, si të bëhet ajo që po quhet strukturim i ekonomisë, duke pasur parasysh privatizimin, apo ne do të vazhdojmë me një privatizim, i cili në të vërtetë është ekzekutim, në kuptimin shpërbërje, për të mos thënë anulim të pasurisë nacionale.

Proceduralisht kjo dihet. Ky Kuvend, me një shumicë, këtë sot mund ta shtyjë, veçse unë po them edhe një herë: ekzistojnë edhe normat që quhen politike morale në këtë Parlament të vendosjes. Nëse Kryesia, bashkë me shefat e grupeve dy herë diskuton dhe thotë “shyqyr” dhe është mirë të diskutohet në Parlament dhe është çështje parlamentare dhe heq dorë me atë që quhet diktatura e numrave në një moment, atëherë ne duhet të reflektojmë, sepse do të shkojmë deri në pafundësi të qesim tema në Parlament, e në momentin e duhur të mos i diskutojmë. Atëherë vijmë te diskutimi i famshëm i raportit legjislativ ekzekutiv.

Ju e dini, kjo grindje ekziston edhe në vendet që janë shumë më demokratike se ne. Qeveritë, po të kenë mundësi, sa më pak i përgjigjen Parlamentit dhe Parlamenti po të ketë mundësi s’e lë të bëjë asgjë pa e shikuar. Por, kjo metodë këtu është metodë e keqe ekzekutimi, e unë mendoj që nuk është mirë që përfaqësuesit e grupeve të tërhiqemi për interesat e kujt do qoftë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Mustafa e ka fjalën.

MUHAMET MUSTAFA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Mendoj se më në fund kemi ardhur në një seancë kur duhet ta zhvillojmë një debat tolerant, të argumentuar, me qëllim që të krijohet një atmosferë që në debatet e mëtejme në shoqëri ta arrijmë një konsensus bazik për ecurinë e mëtejme të privatizimit.

Unë pajtohem me disa që ndoshta më mirë do të ishte të jenë këtu anëtarët e Qeverisë, por nuk mund ta justifikoj mungesën e ministrave të asnjërit, ose të ndonjërit. Ne i kemi 2-3 zëvendëskryeministra që merren me ekonomi të njërit prej këtyre këtu. Prandaj, kësaj mungese i vjen era nënçmim i Parlamentit, nënçmim i debatit, për të mos thënë ndoshta edhe tentim që debati të dezavohet dhe të pengohet.

Prandaj, këtë debat duhet ta kuptojmë si një debat që nuk do të vërë pika, por do ta hapë një proces, në të cilin do të ftohen të gjithë aktorët e interesuar, edhe Qeveria, edhe Kuvendi, edhe komisionet e tij, edhe shoqëria civile, që të arrijmë që këtë proces ta vëmë në binar të interesit publik. Prandaj, unë i ftoj të gjithë kolegët tanë që sot ta zhvillojmë debatin në mënyrë tolerante dhe me një intencion, që nga ky debat të mos ketë humbës dhe fitues, por përfitues të jetë interesi publik i Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! E mbyll debatin për çështjen në fjalë lidhur me mocionin. I kemi tejkaluar edhe pak kompetencat dhe mundësitë tona, me qëllim që të merren më shumë mendime lidhur me këtë.

Tani e hedh në votim mocionin e propozuar nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës.

Lus regjinë dhe deputetët të bëhen gati për votim. Votojmë tash! Gjithkush e ka mendimin e vet. Faleminderit!

Miratohet mocioni i Grupit Parlamentar të PDK-së me 44 vota për dhe 41 vota kundër. Debati shtyhet për seancën e ardhshme.

Pika e katërt e rendit të ditës:

4. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Avokatit të Popullit për vitin 2011

Komisioni Funkcional për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione e ka shqyrtuar Raportin vjetor të Avokatit të Popullit për vitin 2011 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Mos ndoshta doni pauzë? Ju lutem, kjo gjendje në Parlamentin e Kosovës nuk është serioze! 30 veta përnjëherë ngrihen në këmbë dhe bëjnë muhabet në Parlament! Kërkoni pauzë, japim pauzë! Nuk është serioze kjo, të bëhet hajgare! E drejta juaj është edhe ta lëshoni seancën, nuk ka ndonjë problem.

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar Raportin vjetor financiar të Avokatit të Popullit për vitin 2011 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Bazuar në nenin 135 të Kushtetutës, me kërkesë të Avokatit të Popullit, Kuvendi ia mundëson që ai t'i drejtohet Kuvendit.

E ftoj Avokatin e Popullit, zotin Kurteshi, që ta marrë fjalën.

AVOKATI I POPULLIT SAMI KURTESHI: I nderuar z. kryesues i seancës,
Të nderuara zonja dhe zotërinj deputetë,
Të nderuar zonja dhe zotërinj anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Bazuar në nenin 135, paragrafi 1 dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe në nenin 27, paragrafi 1 dhe 2, të Ligjit për Avokatin e Popullit, ju paraqes Raportin vjetor, të njëmbëdhjetin me radhë të Institucionit të Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës, që përfshin periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2011.

Duke e kuptuar raportimin vjetor si një obligim kushtetues reciprok të Avokatit të Popullit dhe Kuvendit të Republikës së Kosovës, ju falënderoj për mundësinë e ofruar për paraqitjen e këtij raporti para jush.

Shpërfaqja e punës njëvjeçare të Institucionit të Avokatit të Popullit përfshin të gjitha hallkat vepruese të tij dhe të paraqitura sipas një renditjeje logjike të bazuar në misionin kushtetues të Avokatit të Popullit: mbrojtja, mbikëqyrja dhe promovimi i të drejtave dhe lirive të njeriut. Pra, paraqitja e gjendjes së të drejtave dhe lirive të njeriut në Kosovë dhe kahet e zhvillimeve të kësaj gjendjeje është njëri prej postulateve kryesore që shpërfaq ky raport.

Që në fillim, po e them, mjerisht në Republikën e Kosovës gjendja e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut lë shumë për të dëshiruar.

Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut e përbëjnë bazën e rendit juridik të Republikës së Kosovës. Drejtësia ligjore, e pranueshme dhe e zbatueshme në jetën praktike, për të gjithë individët, pa asnjë dallim, në gjithë territorin e shtetit, e përbën bazën e shtetit ligjor. Fatkeqësisht, në Kosovë, këto shtylla qenësore të shtetit ligjor cenohen në vazhdimësi dhe vazhdojnë të jenë të brishta në secilën fushë të jetës.

Pasojë e drejtpërdrejtë e mosangazhimit të mekanizmave shtetërorë në fushën e zbatimit të drejtësisë është besimi i humbur në shtetin ligjor. Ky mosbesim shtrihet që nga shtresat më të varfra dhe më të pafuqishme të shoqërisë, deri te zyrtarët më të lartë të shtetit. Edhe më tutje, në Republikën e Kosovës, drejtësia e shtetit është përzgjedhëse. Në vend se ta sheshojë, ajo gjithnjë e më tepër po e thellon hendekun ndërmjet qytetarit të pambrojtur dhe shtetit, që për detyrë themelore dhe të vetme e ka ta mbrojë qytetarin.

Humbja e besimit në shtetin ligjor dhe mungesa e angazhimit të mekanizmave shtetërorë për përmirësimin e kësaj gjendjeje dëshmon mungesën e një ndërgjegjësimi për përmirësimin e kësaj gjendjeje. Kjo gjendje i forcon pozitat e kastës shkelëse të të drejtave dhe lirive të njeriut përballë qytetarit gjithnjë e më të pafuqishëm.

Mungesa e ndërgjegjësimit institucional për zbatimin e ligjit dhe për krijimin e shtetit ligjor po shoqërohet me një tronditje që po i prek të gjitha poret e sistemit ligjor në Republikën e Kosovës. Humbja gjithnjë e më e madhe e besimit të qytetarëve në mekanizmat e drejtësisë në Kosovë po shkakton pasojat e tjera shumëfish më të mëdha dhe më të rrezikshme - tentimet gjithnjë e më të shumta të marrjes së ligjit në duar të veta nga qytetarët. Fatkeqësisht, kjo gjendje po shpie në anarki ligjore, e cila po i kaplon të gjitha fushat e shoqërisë sonë. Ndërkaq, si pasojë vërejmë një përkeqësim në rritje të raporteve ndërshoqërore dhe ndërnjerëzore.

Institucioni i Avokatit të Popullit, bazuar në mandatin dhe kompetencat kushtetuese dhe ligjore, në vazhdimësi ka tërhequr vërejtjen për gjendjen e të drejtave dhe të lirive të njeriut në Kosovë, përkatësisht për përmasat e shkeljes së të drejtave dhe të lirive të njeriut nga institucionet shtetërore të Republikës së Kosovës. Avokati i Popullit vazhdimisht ka dhënë dhe jep rekomandime për përmirësimin e lëshimeve dhe të metave të vërejtura. Mirëpo, fatkeqësisht edhe më tutje është evidente mungesa e ndikimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit në organet shtetërore, një pjesë e madhe e të cilave, mjerisht, nuk e bën as përpjekjen më të vogël për ta përmirësuar gjendjen.

Moszbatimi dhe injorimi i këtyre rekomandimeve, pikërisht nga ato organe dhe institucione, të cilat janë të thirrura t'i zbatojnë ligjet dhe t'u krijojnë mundësi qytetarëve për t'i zgjidhur problemet e tyre, është tejet shqetësues.

Institucioni i Avokatit të Popullit, me të gjeturat e shkeljeve të ndryshme dhe rekomandimet për mënjanimin e tyre, me komunikimin e pandërprerë me institucionet përkatëse dhe ndërmjetësimet midis tyre dhe qytetarëve, në vazhdimësi është angazhuar dhe angazhohet në përmirësimin e kësaj gjendjeje. Madje, këtë e ka bërë dhe vazhdon ta bëjë, me gjithë vështirësitë e ndërskamsat që i bëhen, qoftë me neglizhencën e institucioneve për ta krijuar një klimë më të mirë për drejtat dhe liritë e njeriut, qoftë me

injorimin apo moszbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit, apo edhe përpjekjet për dobësimin e tij.

Jashtëzakonisht shqetësuese është tendenca e institucioneve të ndryshme shtetërore për minimizimin e rolit të institucioneve të pavarura kombëtare përgjithësisht: qoftë duke i shpërfillur të gjeturat e tyre, qoftë duke mos i zbatuar rekomandimet e tyre, apo qoftë edhe duke bërë përpjekje kundërligjore për cenimin e pavarësisë së tyre kushtetuese.

Ky fat po e përcjell edhe Institucionin e Avokatit të Popullit, i cili angazhohet për krijimin e një klime në të cilën qytetarët e Republikës së Kosovës do të kishin mundësi t'i zgjidhnin problemet e tyre, bazuar në Kushtetutë dhe në ligj. Por, fatkeqësisht, me gjithë arritjen e disa rezultateve modeste, shumëçka mbetet në sfondin e së dëshiruarës. Prandaj, Avokati i Popullit shpreson që Institucioni i Avokatit të Popullit do ta ketë një përkrahje më të fuqishme nga Kuvendi, Qeveria dhe komunat në aspektin material dhe të ofrimit të infrastrukturës së përshtatshme, me qëllim të ushtrimit të mandatit kushtetues në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut.

Institucioni i Avokatit të Popullit, me gjithë pengesat e shumta, ka bërë hapa të rëndësishëm në drejtim të ofrimit të shërbimit qytetarëve dhe personave të tjerë në nevojë. Përveç mundësisë për paraqitjen e ankesave me të gjitha format e komunikimit, drejtpërdrejt në zyrat e Avokatit të Popullit çdo ditë pune, me postë, me postë elektronike, nëpërmjet familjarëve apo avokatit dhe me telefon, Institucioni i Avokatit të Popullit ka organizuar Ditët e Hapura, duke ofruar takime të drejtpërdrejta një herë në muaj për të gjithë personat në nevojë në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës, kryesisht në ndërtesat e kuvendeve komunale. Po ashtu, me qëllim të rritjes së transparencës ndaj qytetarëve dhe të gjithë ankuesve, Avokati i Popullit çdo kërkesë të drejtuar atij në mënyrë të rregullt, i përgjigjet me shkrim.

Megjithëse të gjitha këto veprime përcillen me një ngarkesë dukshëm më të madhe për bashkëpunëtorët e Institucionit të Avokatit të Popullit dhe rrjedhimisht me nevoja për resurse shtesë materiale dhe njerëzore, të cilat Institucionit të Avokatit të Popullit nuk i janë lejuar, satisfaksion i vetëm për Institucionit të Avokatit të Popullit mbetet rritja e besimit të qytetarëve dhe e disa institucioneve shtetërore në punën e tij.

Gjatë vitit raportues 2011, në Institucionin e Avokatit të Popullit janë regjistruar 1 453 raste të proceduara, ose 220 raste më shumë se në vitin paraprak. Duhet theksuar se përveç rritjes për 15% të numrit të qytetarëve që i janë drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit me parashtrësata e tyre, edhe numri i rasteve të zgjidhura pozitivisht është rritur për herë të parë mbi 50%.

Numri më i madh prej tyre ishin ankesa kundër Gjyqësorit, në të gjitha nivelet. Ankesat kanë të bëjnë zakonisht me zvarritjen e proceseve gjyqësore - vonimit të drejtësisë; moszbatimin e vendimeve të plotfuqishme të gjykatave - dështimi i shtetit për ta vënë drejtësinë, dhe; parashkrimit të mbi 2300 lëndëve gjyqësore - ose thënë më qartë, mohim i drejtësisë. Të gjitha këto përbëjnë shkelje kushtetuese të mbrojtjes gjyqësore të të drejtave.

Fatkeqësisht, një numër i ankesave ka të bëjë edhe me vendimet e padrejta, me elemente të korrupsionit dhe falsifikimeve, që nënkupton padrejtësi nga ata që pritet ta vënë drejtësinë në vend. Me gjithë ndërmarrjen e veprimeve të pakta për luftimin e kësaj dukurie nga vetë Gjyqësori, bazuar në të dhënat e Institucionit të Avokatit të Popullit, në përgjithësi, në këtë drejtim nuk kemi ndonjë përmirësim të dukshëm në krahasim me periudhën e mëparshme raportuese.

Gjatë vitit 2011, Institucioni i Avokatit të Popullit ka regjistruar numër shqetësues të ankesave të qytetarëve që kanë të bëjnë me moszbatimin e vendimeve të plotfuqishme të institucioneve të pavarura shtetërore nga vetë institucionet e shtetërore, apo edhe vendime të paligjshme të institucioneve shtetërore. Ankesat më të shumta në këtë drejtim kanë të bëjnë me shkelje të ligjit në rastet e punësimit, apo edhe në vendin e punës, si në sektorin publik, ashtu edhe në atë privat.

Një numër i konsiderueshëm i ankesave, gjithnjë në rritje, ka të bëjë me mosrregullimin ligjor të pensioneve, të sigurimit shëndetësor, mbrojtjen jo të duhur shëndetësore, mungesën e barnave nga e ashtuquajtura lista esenciale në institucionet publike shëndetësore.

Një fushë e ankesave që përcillet me pasoja serioze për marrëdhëniet ndërnjerëzore, ku vërehet edhe dështimi më serioz i sistemit të drejtësisë, qoftë për shkak të zvarritjeve të mëdha, qoftë për shkak të moszbatimit të vendimeve të plotfuqishme gjyqësore, apo qoftë edhe të falsifikimeve të dëshmuara, është cenimi i të drejtës së pronës. Në këto raste, kur drejtësia shtetërore i mbështet njerëzit për murin e padrejtësisë, ata e marrin drejtësinë në duart e tyre.

Një fushë tjetër ku vërehet një tendencë rritjeje e numrit të ankesave është dështimi i mbrojtjes së mjedisit jetësor. Qoftë për shkak të përkeqësimit të vazhdueshëm të gjendjes në këtë fushë, qoftë për shkak të vetëdijesimit të një numri të madh të qytetarëve për gjendjen e patolerueshme, kemi një reagim gjithnjë e më të shpeshtë të qytetarëve.

Një shqetësim për Avokatin e Popullit mbetet gjendja e sigurisë në Republikën e Kosovës. Një rritje e numrit të rasteve të vrasjeve me armë është e evidente.

Liria e lëvizjes në pjesën veriore të qytetit të Mitrovicës, si dhe në komunat Leposaviq, Zubin-Potok dhe Zvečan është gati tërësisht e kufizuar për qytetarët, sidomos për personat e përkatësisë etnike joserbe, por dhe për autoritetet publike të Republikës së Kosovës, si dhe për institucionet ndërkombëtare. E njëjta gjë vlen edhe për sigurinë fizike.

Një gjendje shumë e rëndë, sa i përket lirisë së lëvizjes, vërehet edhe në trafikun rrugor. Në qendrat urbane, përveç zënies së trotuareve nga parkimi i pandërgjegjshëm i automjeteve, vërehet edhe një papërgjegjësi dhe kaos i patolerueshëm në ngasjen e automjeteve, si në qendrat urbane, ashtu edhe në rrugë të hapura. Përveç rrezikimit të drejtpërdrejtë të jetës së njerëzve nga aksidentet fatale, shpeshherë kufizohet liria e

lëvizjes së këmbësorëve, sidomos e atyre që nuk kanë fuqi, e fëmijëve, e të moshuarve dhe e personave me aftësi të kufizuara.

Gjendja e rëndë ekonomike në vend prek shumicën e qytetarëve të Republikës së Kosovës, duke ndikuar drejtpërdrejt në kualitetin e tyre jetësor. Shqetësuese në këtë drejtim është mungesa e perspektivës për të rinjtë, si dhe gjendja e pensionistëve. Në këtë drejtim, Avokati i Popullit sërish kërkon nga Kuvendi i Republikës së Kosovës miratimin e Ligjit për sigurimin shëndetësor si dhe të Ligjit për sigurimin invalidor e pensional. Po ashtu, ripërsërit kërkesën për përfshirjen e Konventës për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore në kuadër të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si një ndër instrumentet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, të zbatueshme drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës.

Shqetësim të veçantë për Avokatin e Popullit paraqet edhe izolimi strukturor nga jeta publike dhe si pasojë vetizolimi shoqëror i komuniteteve ashkali, egjiptian dhe rom. Përpjekjet e deritanishme të autoriteteve publike në Republikën e Kosovës, përfshirë këtu edhe vetë Institucionin e Avokatit të Popullit, për integrimin e mirëfilltë të këtyre komuniteteve në jetën publike dhe shoqërore, përveç disa përmirësimeve në infrastrukturën e banimit, nuk kanë dhënë rezultate të lakmueshme.

Avokati i Popullit, me qëllim të përmirësimit të gjendjes së të drejtave dhe lirive të njeriut, për të gjitha rastet e veçanta kur ka konstatuar shkelje të drejtave, në raportet e tij vjetore dhe të veçanta, ka bërë rekomandimet e duhura për të gjitha autoritet publike - ministritë, komunat, si dhe agjencitë tjera publike përgjegjëse. Por, fatkeqësisht, në këtë drejtim kemi të bëjmë me një dështim të institucioneve publike. Deri më tani, Avokati i Popullit nuk ka marrë asnjë informatë apo njoftim nga ndonjë institucion, nëse janë zbatuar rekomandimet e tij. Një praktikë e tillë vazhdon të përcillet nga viti në vit dhe si e tillë është mjaft shqetësuese.

Meqenëse zbatimi i ligjit është premisa kryesore për funksionimin e shtetit ligjor në Republikën e Kosovës, me gjithë disa përpjekje modeste, moszbatimi i ligjit është indikator kryesor për humbjen e besimit të qytetarit në institucionet shtetërore, të cilat zbatimin e ligjit e kanë detyrim ligjor dhe kushtetues. Ndërkaq, kjo humbje e besimit shpeshherë e vë Avokatin e Popullit në pozicionin drejt të cilit shtrohen kërkesa për ta vënë drejtësinë në vend. Kjo ndodh pikërisht për shkak të moszbatimit të ligjit në të shumtën e rasteve, e edhe të shkeljes së ligjit në raste të veçanta, nga pjesa dërrmuese e institucioneve shtetërore.

Në këtë drejtim, për përmirësimin e raportit dhe të komunikimit autoritete publike-qytetar, si dhe për rritjen e efektivitetit dhe të efikasitetit të autoriteteve publike, Avokati i Popullit e konsideron si domosdoshmëri nxjerrjen dhe miratimin sa më të shpejtë të një kodi bashkëkohor të qartë dhe të zbatueshëm të procedurës administrative.

Avokati i Popullit do të vazhdojë të evidentojë dhe të nxjerrë në pah veprimet apo mosveprimet e parregullta e të paligjshme të autoriteteve publike, pikërisht për ta luajtur rolin që ka në ndërtimin e një shoqërie të bazuar në parimin se të gjithë janë të barabartë

para ligjit. Por, me gjithë këto veprime dhe përpjekje për përmirësimin e gjendjes së të drejtave dhe të lirive të njeriut, dua të theksoj qartë se Avokati i Popullit nuk ndan drejtësi.

Janë institucionet shtetërore - gjykatat - që e ndajnë dhe e zbatojnë drejtësinë. Janë pikërisht institucionet shtetërore ato të cilat nuk do të duhej të shkelnin mbi parimet e drejtësisë ligjore, sepse po që se shkelin mbi to, atëherë kanë prekur në besimin e domosdoshëm për funksionimin e një shoqërie të lirë dhe demokratike. Kjo nuk guxon të ndodhë dhe nuk duhet lejuar të ndodhë.

Shpresat për një të ardhme më të mirë, edhe pse e nëpërkëmbur, nuk ka humbur. Janë evidente dhe shpresëdhënëse përpjekjet për vendosjen e rendit dhe të ligjit. Prandaj, Avokati i Popullit kërkon më shumë përkushtim dhe përgjegjësi individuale, shoqërore dhe sidomos institucionale të autoriteteve publike për veprimet apo mosveprimet e tyre.

Duke qenë mbikëqyrës i zbatimit kushtetues dhe ligjor i të drejtave dhe lirive të qytetarëve të Republikës së Kosovës, Avokati i Popullit njëkohësisht është edhe ndriçues i rasteve kur qytetarët privohen nga ndonjë e drejtë e tyre, si dhe qortues i institucioneve publike, kur ato shprehen mospërfillëse në zbatimin kushtetues dhe ligjor të të drejtave dhe lirive të tyre.

Avokati i Popullit shpreson, por edhe kërkon me ngulm, që të gjitha autoritetet publike dhe organizatat që ushtrojnë autorizime publike në Republikën e Kosovës të marrin në konsideratë të gjeturat e Avokatit të Popullit dhe zbatimin e rekomandimeve, të bëra qoftë në raportin vjetor, apo edhe në raportet e veçanta, me qëllim të përmirësimit dhe avancimit të të drejtave të njeriut.

Zoti kryesues,

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Duke mbetur në dispozicionin tuaj për sqarime të mëtutjeshme, unë ju falënderoj shumë për vëmendjen!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Avokat i Popullit! Besoj të kemi trajtuar mirë! T'i kemi dhënë 19 minuta në Parlament.

Vazhdojmë me diskutimet. Fjalën e ka kryetarja e Komisionit FunkSIONAL, deputetja Suzan Novobërdaliu, për arsyetimin e raportit me rekomandime. Nuk e di çka duhet arsyetuar, ngase e lexoi vetë avokati. Vazhdojmë me kryetaren e Komisionit për Buxhet dhe Financa, nëse do, nëse jo, mund të vazhdojmë me të tjerët. Zonja Hadërgjonaj e ka fjalën.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar Raportin financiar të Avokatit të Popullit, i cili i është bashkangjitur raportit të përgjithshëm të Avokatit të Popullit dhe gjatë analizave, të cilat i janë bërë, është vërejtur se nuk i ka të gjitha shënimet e

detajuara. Megjithatë, gjatë shqyrtimit të Raportit financiar, Avokati i Popullit në mbledhjen e Komisionit për Buxhet i ka afruar të gjitha shënimet e detajuara për shpenzimet, të cilat janë bërë sipas kategorive ekonomike.

Kështu që Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka vlerësuar pozitivisht raportin dhe njëzëri e ka miratuar.

Buxheti total i Avokatit të Popullit ka qenë në vlerë 613 658 euro dhe ka shpenzuar 535 945 euro, apo 87,34% të mjeteve.

Në kategorinë “paga dhe mëditje”, mjetet janë shpenzuar 86,99%, në kategorinë mallra dhe shërbime 91,7% dhe në kategorinë shpenzime komunale 55,10%.

Meqenëse raporti i ka përmbushur obligimet ligjore që dalin nga Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, Komisioni e ka përkrahur Raportin financiar të Avokatit të Popullit.

Megjithatë, Komisioni për Buxhet dhe Financa, duke e analizuar në tërësi, ka vërejtur se disa çështje, të cilat janë shtruar në Raportin financiar të Avokatit të Popullit nuk qëndrojnë. Për shembull, unë dua të ndalem vetëm në dy çështje.

Çështja e parë, kur thuhet Institucionit të Avokatit të Popullit i është kufizuar dhe vështirësuar përmbushja e obligimeve dhe realizimi i misionit të vet kushtetues dhe ligjor për shkak të vështirësive financiare, unë mendoj që kjo nuk qëndron, meqenëse Avokati i Popullit i ka shpenzuar vetëm 87,34% të mjeteve, kurse nuk dua t’i jap shifrat të cilat i ceka pak më lart.

Në Raportin financiar të Avokatit të Popullit shkruan se buxheti i Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2011 ka qenë i ndarë dhe i miratuar pa dëgjimin e rregullt të kërkesës buxhetore të Institucionit të Avokatit të Popullit nga Ministria e Financave dhe Komisioni Parlamentar për Buxhet dhe Financa të Republikës së Kosovës, për çka gjithashtu mendoj se edhe kjo çështje nuk qëndron.

Gjatë vitit 2011, ju e dini, të nderuar deputetë, që buxheti është miratuar në muajin mars për shkak të vonesës së zgjedhjeve dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka pasur një kohë shumë të shkurtër për t’i shqyrtuar kërkesat buxhetore të agjencive të pavarura dhe të buxhetit, në përgjithësi.

Megjithatë, më 28.3.2011, është ftuar Avokati i Popullit në takim konsultativ për të diskutuar për kërkesën buxhetore të këtij institucioni. Në këtë takim, Avokati i Popullit ishte përfaqësuar nga drejtori ekzekutiv, i cili gjatë bisedës ka informuar se ky institucion nuk e ka dorëzuar fare kërkesën buxhetore në Ministrinë e Financave sipas qarkores buxhetore, për ç’gjë buxheti i aprovuar dhe kërkesa e avokatit ishin në një disproporcion të madh, por direkt në Kuvend dhe nuk ishte kurrfarë njohurie se çfarë është përfshirë nga kërkesat e tyre në Projektligjin për buxhetin për vitin 2011.

Në këtë mënyrë, Institucioni i Avokatit të Popullit nuk e kishte përfillur nenin 20.4 të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, në bazë të të cilit secila organizatë buxhetore është përgjegjëse të përgatisë dhe t'ia dorëzojë ministrit propozim-buxhetin dhe kërkesën e saj për ndarjen buxhetore sipas kërkesës buxhetore të ministrisë dhe të marrin pjesë në dëgjimet buxhetore, të organizuara nga Ministria e Financave, për t'i harmonizuar kërkesat me mundësitë buxhetore.

Agjencitë dhe institucionet e pavarura, përveç ministrisë, ia dërgojnë edhe Kuvendit, përkatësisht Komisionit për Buxhet dhe Financa propozim-buxhetin dhe kërkesat e tyre buxhetore të planifikuara për vitin buxhetor, i cili në rastin e shqyrtimit të Projektligjit për buxhetin vjetor, i shqyrton kërkesat buxhetore dhe nxjerr rekomandime për Kuvendin.

Në mbledhjen e Komisionit për Buxhet dhe Financa, të mbajtur më 28.3.2011, është shqyrtuar propozim-buxheti dhe kërkesa buxhetore e Institucionit të Avokatit të Popullit. Të vetëdijshëm për rëndësinë që ka ky institucion kushtetues dhe duke i pasur parasysh kufizimet buxhetore, Komisioni njëzëri ka rekomanduar të ketë buxhet shtesë për kategori të caktuara të Institucionit të Avokatit të Popullit, kështu që rekomandimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa, i cili është miratuar edhe nga deputetët e Kuvendit, ka qenë që numri i të punësuarve të rritet nga 47 në 48. Domethënë është shtuar një zëvendës/avokat i popullit, sepse me ligjin e ri, nga katër janë bërë pesë zëvendës/avokatë të popullit, me ç'rast është rritur numri i të punësuarve.

Në Institucionin e Avokatit të Popullit, domethënë kategoria “paga dhe mëditje”, shuma e mjeteve është rritur nga 339 848 në 361 080 euro, çka do të thotë për 21 232 euro dhe po ashtu në kategorinë “mallra dhe shërbime”, shuma nga 179 239 euro ndryshohet në 224 239 euro, domethënë ka pasur rritje edhe në këtë kategori, dhe shpenzimet komunale, me kërkesën Avokatit të Popullit, janë zvogëluar nga 54 000 në 44 000 euro.

Në fund të Raportit financiar të Avokatit të Popullit shkruan që dy zëvendës/avokatët e popullit nuk kanë marrë fare pagë për punën e tyre në Institucionin e Avokatit të Popullit, kurse tre zëvendës tjerë të Avokatit të Popullit kanë marrë paga për këta dy muaj si punonjës të shërbimit civil.

Unë mendoj, e ky është edhe mendimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa, se një gjë e tillë, që është theksuar në raport, nuk qëndron, për arsye se pagat e Avokatit të Popullit dhe të pesë zëvendës/avokatëve kanë qenë të definuara qartë, jo aq sa ka bërë kërkesë Institucioni i Avokatit të Popullit, por kanë qenë të precizuara saktësisht sa është paga e Avokatit të Popullit dhe e pesë zëvendësve të tij. Dhe, kështu që paga e Avokatit të Popullit ka qenë e precizuar saktësisht 837 euro, kurse e zëvendësve 720 euro.

Unë nuk e kuptoj pse në muajin nëntor dhe dhjetor nuk është paguar paga e zëvendës/avokatëve të popullit, për arsye se pagat kanë qenë të ndara prej 1 janarit e tutje për avokatin dhe pesë zëvendësit e tij.

Unë mendoj dhe ky është në njëfarë mënyre edhe mendimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa, kemi diskutuar disa herë se paga e avokatit të Popullit nuk ka qenë në nivelin e duhur, mirëpo këtu kemi pasur zbrazëti të ligjore. Disa herë është kërkuar nga Komisioni për Buxhet dhe Financa që të sillet Ligji për pagat e funksionarëve të lartë publikë, sepse me Ligjin për Avokatin e Popullit është e paraparë që paga e tyre të rregullohet me këtë ligj.

Te pagat e institucioneve të pavarura ka një laramani të madhe dhe unë do të kisha dashur që sa më shpejt të vijë në shqyrtim Ligji për pagat e funksionarëve të lartë publikë dhe të ketë një angazhim maksimal të deputetëve që të rregullohet ky ligj dhe vërtet pagat e këtyre institucioneve të pavarura të rregullohen sipas tij.

Është edhe një dukuri te institucionet e pavarura, po e abstraktoj në këtë rast Institucionin e Avokatit të Popullit, sepse në të shumtën e rasteve rezultatet e punës së tyre ato i matin në bazë të asaj se sa e kanë pagën bordet dhe kryetari i atyre bordeve, e jo në bazë të rezultateve të cilat arrihen në punë.

Unë do të doja që Avokati i Popullit të jetë një person larg nga politika dhe shumë i papolitizuar dhe do të doja që raportet të jenë reale. Dhe, nëse të gjithë paraqesin diçka që nuk është realitet, Institucioni i Avokatit të Popullit do të doja ta paraqesë realitetin në raport, të cilin e prezanton para Kuvendit, sepse është një institucion i respektuar nga të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës dhe njëkohësisht pasqyra e një vendit varet edhe nga puna e mirë e Avokatit të Popullit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani radha është e kryetarëve të grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, zoti Kajtazi e ka fjalën.

KURTAN KAJTAZI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Raportin e njëmbëdhjetë vjetor të Avokatit të Popullit.

Ky raport vjetor është hartuar sipas parimeve, kriterëve dhe aspekteve, jo vetëm përmbajtjesore, por edhe formale. Këto parime dhe kriterë paraqesin punën njëvjeçare të Avokatit të Popullit, përfshirë hallkat vepruese të tij, të paraqitura sipas një renditje të bazuar në misionin kushtetues që e ka Avokati i Popullit.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës i ka siguruar Kosovës një bazë solide normative në pajtim të plotë me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Ligji për Avokatin e Popullit ka qenë një mekanizëm ligjor që sanksionon mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe promovimin e lirive dhe të drejtave të njeriut. Kështu, ky ligj, me gjithë mangësitë që ka, zërin e Avokatit të Popullit e ka fuqizuar dhe ka krijuar një urë lidhëse ndërmjet Avokatit të Popullit, institucioneve publike dhe qytetarit.

Raporti përfshin në vete punën e grupeve që veprojnë në kuadër të Institucionit të Avokatit të Popullit, siç janë Grupi Kundër Diskriminimit, Njësia për të Drejtat e Fëmijëve dhe Njësia për Barazi Gjinore, pastaj bashkëpunimin me organizatat ndërkombëtare, institucionet vendore dhe shoqërinë civile, duke përfshirë trajnimet, seminarët, vizitat studimore, si dhe çështjet e personelit, ato financiare dhe përmbledhjet statistikore të ankesave dhe rasteve.

Duke e shqyrtuar këtë raport vërejmë se numri i rasteve të paraqitura tek Avokati i Popullit është rritur, gjë që dëshmon në njëfarë mënyre edhe besueshmërinë që kanë krijuar qytetarët te ky institucion, por krahas kësaj vërejmë se edhe numri i rasteve të zgjidhura, krahasuar me vitin 2010, është më i madh, që dëshmon edhe përkushtimin e institucioneve publike për ta respektuar ligjin dhe kërkesat e Avokatit të Popullit.

Për dallim nga fjala e Avokatit të Popullit për përmasat e shkeljes së të drejtave dhe lirive të njeriut nga institucionet shtetërore, duke mos bërë përpjekje për përmirësim, po të analizohet mirë raporti në brendi, e veçmas si anëtarë të Komisionit për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore, duke monitoruar në vazhdimësi Ligjin për liritë fetare, Ligjin kundër diskriminimit, Ligjin për barazi gjinore, duke i shqyrtuar në vazhdimësi peticionet e qytetarëve në fushën e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe duke qenë në kontakt të vazhdueshëm me Avokatin e Popullit, gjendja sa i përket respektimit të këtyre ligjeve është përmirësuar dukshëm dhe mendoj se rastet e veçuara të shkeljes së lirive dhe të drejtave të njeriut nuk duhet të trajtohen si të përgjithshme dhe të krijohet një opinion i keq te deputetët, te qytetarët dhe te bashkësia ndërkombëtare.

Për ne ligjvënësit dhe për Qeverinë e Kosovës, sfida në të ardhmen është nxjerrja e Ligjit për sigurimin invalidor dhe pensional, si dhe ligjet për sigurimet shëndetësore, që është edhe kërkesë e Avokatit të Popullit, por të gjithë ne duhet t'i kuptojmë drejtë mundësitë buxhetore që ka pasur dhe ka shteti ynë.

Shigjetat e Avokatit të Popullit janë drejtuar nga sistemi gjyqësor dhe prokurorial në Kosovë. Gjyqësori, një prej shtyllave themelore të pushtetit, që reflekton ndjeshmërinë, përkatësisht qëndrueshmërinë e gjithë mekanizmave shtetërorë, vazhdon të jetë i identifikuar me numrin më të madh të ankesave të paraqitura nga qytetarët e Kosovës në Institucionin e Avokatit të Popullit.

Me gjithë përpjekjet për të ndryshuar, duke e rritur numrin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, pastaj ngritjen e pagave, institucioni i Gjyqësorit në Kosovë është shqetësues për Avokatin e Popullit.

Duke qenë mirënjohës dhe duke i ditur sfidat dhe vështirësitë e punës së Institucionit Avokatit të Popullit, ne si grup parlamentar jemi për miratimin e këtij raporti dhe njëherësh u bëjmë thirrje të gjithë deputetëve ta miratojnë raportin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, zonja Hajzeraj e ka fjalën.

RITA HAJZERAJ-BEQAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Së pari, ky raport për Institucionin e Avokatit të Popullit ka ardhur me vonesë në Kuvend dhe ky institucion i ka shkelur afatet ligjore për ta sjellë raportin në fjalë.

Sa i përket raportit dhe përshkrimeve të tij nga Institucioni i Avokatit të Popullit, shihet se në Kosovë mungesa e ndërgjegjësimit për zbatimin e ligjit dhe për krijimin e shtetit ligjor i ka prekur në të gjitha poret e sistemit ligjor në Republikën e Kosovës.

Si pasojë e kësaj, humbja gjithnjë e më e madhe e besimit të qytetarëve në mekanizmat e drejtësisë në Kosovë shkakton pasoja të tjera shumëfish më të mëdha dhe më të rrezikshme, tentime gjithnjë e më të shumta të marrjes së ligjit në duart e tyre nga qytetarët.

Fatkeqësisht, në Kosovë po krijohet një anarki ligjore, e cila i ka kapluar të gjitha poret e shoqërisë sonë dhe kjo gjendje ka bërë që qytetarët e vendit tonë çdo ditë e më shumë po drejtohen në dyert e Institucionit të Avokatit të Popullit që të gjejnë zgjidhje për problemet e tyre.

Në raportin e Institucionit të Avokatit të Popullit thuhet se gjendja në respektimin e të drejtave të njeriut në Kosovë është jashtëzakonisht e keqe. Në raport thuhet se një pjesë e institucioneve të Republikës së Kosovës as që e bëjnë përpjekjen më të vogël për respektimin e të drejtave të njeriut dhe kjo tregohet qartë kur edhe më tutje është evidente mungesa e ndikimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit, që në shumicën e herëve nuk merren parasysh.

Është shumë shqetësuese nëse i shohim ankesat që kanë ardhur në këtë vit në Institucionin e Avokatit të Popullit, kryesisht një numër shumë i madh i tyre janë kundër Gjyqësorit në të gjitha nivelet e tij. Kjo tregon për zvarritjen e proceseve gjyqësore dhe veprimet e drejtësisë. Shumë prej tyre kanë të bëjnë edhe me vendimet e padrejta të Gjyqësorit, me elemente të korrupsionit, të falsifikimeve, e kjo duhet të jetë shumë shqetësuese për vendin tonë, sepse ky raport tregon se këto dukuri po vazhdojnë dhe nuk po përmirësohen në Kosovë. Drejtësia nuk funksionon si duhet në vendin tonë, po ashtu korrupsioni e ka prekur çdo pore të shoqërisë dhe si rezultat i kësaj ne sot nuk mund të mburremi me drejtësi dhe institucionet tona, sepse ankesat e qytetarëve çdo ditë vijnë e shtohen.

Nëse e shohim rolin dhe rëndësinë e Institucionit të Avokatit të Popullit, ky institucion ka nevojë për një përkrahje më të madhe nga Kuvendi dhe institucionet tjera, por Institucioni i Avokatit të Popullit ka mundur të bëjë edhe më shumë. Për shembull, kemi largime të njerëzve nga vendet e punës, largime politike dhe spastrime politike që kanë ndodhur në këtë vit dhe ky institucion asnjëherë nuk e ka marrë mundin që t'i ngrejë këto çështje.

Është mungesë jashtëzakonisht e madhe nga ky institucion ngritja e çështjeve ex officio. Këto që i përmenda më herët do t'i përfshinin këto çështje që të merrte iniciativa vetjake

si institucion i Avokatit të Popullit që t'i ngrejë këto çështje, të cilat janë jashtëzakonisht të rëndësishme.

Nëse hyjmë te Auditori, i cili ka gjetur shkelje te Institucioni i Avokatit të Popullit dhe nëse i shohim ankesat nga ky institucion, atëherë shohim se Institucioni i Avokatit të Popullit ankohet vazhdimisht për buxhet. Nëse i shohim rezultatet e auditorit, atëherë shohim se ky institucion nuk po e përdor, apo nuk po e menaxhon mirë buxhetin e tij.

Nëse kalojmë te donacionet, të cilat shkojnë për Institucionin e Avokatit të Popullit, prapë ky institucion nuk i ka shfrytëzuar këto donacione në të mirë të tij, përderisa ne e dimë se ka nevojë për financim dhe për ngritje të kuadrove në këtë institucion dhe, në anën tjetër, nuk nga ky institucion ka iniciativa për shfrytëzimin sa më të mirë të këtyre donacioneve.

Lidhja Demokratike e Kosovës konsideron se ky raport duhet të përkrahet me qëllimin më të mirë që ky institucion të punojë më mirë, që të ketë përkrahjen e institucioneve tona.

Po ashtu, u bëj thirrje edhe institucioneve qeveritare që të ndikojnë më shumë për sjelljen e Ligjit për pagat e zyrtarëve të lartë publikë në Parlamentin e Kosovës, sepse ka një diskrepancë të madhe nëse e shohim Ligin për Avokatin e Popullit, i cili i përcakton pagat në bazë të këtij ligji, ndërsa ligji nuk ekziston. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, fjalën e ka deputetja Albana Gashi.

ALBANA GASHI: Faleminderit, kryesues!

Raporti i Institucionit të Avokatit të Popullit e ka pasqyruar gjendjen reale, apo të them më saktë - gjendjen kaotike në të cilën ndodhet Kosova sot.

Është shqetësues fakti që nuk ka përmirësim të gjendjes të pasqyruar në këtë raport nga ajo e vitit të kaluar, bile veç sa është përkeqësuar situata në disa raste.

Një tjetër çështje që duhet trajtuar sot është cenimi i pavarësisë së këtij institucioni. Avokati i Popullit na është drejtuar disa herë me shkresa, madje këtë shqetësim e ka trajtuar edhe në këtë raport, mirëpo asnjëherë nuk janë marrë parasysh nga institucionet. Kjo po bëhet në mënyra të ndryshme, duke filluar që nga ndërhyrja e paautorizuar nga Qeveria në buxhetin e tyre, duke e shkurtuar atë për 13 454 euro, e që përbën shkelje flagrante të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Ligjit për Avokatin e Popullit, duke mos bërë sigurimin e objekteve, sepse pothuajse në tërë territorin e Kosovës e ka këtë problem të njëjtë dhe ende vazhdon ta paguajë qiranë, si dhe pavarësia e këtij institucioni po cenohet edhe me kërcënime, siç ka ndodhur në rastin e fundit në Mitrovicë nga zyrtari i ATK-së.

Kjo mbase po ndodh për ta penguar punën e Institucionit të Avokatit të Popullit, pasi është institucioni i vetëm i pavarur, i cili merret me mbrojtjen e të drejtave të njeriut, dhe

është i vetmi institucion që e pasqyron gjendjen reale për dallim nga ajo se çfarë flasin qeveritarët tanë.

Në njëfarë mënyre, Institucioni i Avokatit të Popullit vë në pah të bërat dhe të pabërat e kësaj Qeverie dhe kjo sigurisht që paraqet problem për këta të fundit dhe duan që nëpërmjet këtyre ndërhyrjeve ta bëjnë të varur edhe atë.

Cenimi i të drejtës së fjalës së Avokatit të Popullit, që sapo ndodhi në Kuvend, përderisa zoti Kurteshi po raportonte, është edhe një ndërhyrje më shumë në pavarësinë e tij.

Fjala e Avokatit të Popullit në Kuvend garantohej edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, andaj, zoti kryesues, shkelja e të drejtave të njeriut dhe hallet e qytetarëve nuk maten me minuta.

Por, vazhdojmë te raporti.

KRYESUESI: Jo, po të përgjigjem menjëherë unë.

ALBANA GASHI: Ta përfundoj, zoti kryesues, e mandej përgjigjeni.

KRYESUESI: Në Parlament ai ka të drejtë të flasë 10 minuta, mund ta përgatisë raportin, kurse ai i pati 19,5 minuta. Vazhdoni ju!

ALBANA GASHI: As te Rregullorja, e as te Kushtetuta nuk përcaktohet minutazhi se sa duhet të flasë Avokati i Popullit në Kuvend. Vetëm i garantohej fjala në Kuvend dhe të lutem, më lejo ta përfundoj, e kur ta përfundoj, mund ta komentoni. Ju lutem, keni pak konsideratë!

Profesionalizmi i Institucionit të Avokatit të Popullit i pasqyron drejt, saktë dhe konkretisht të gjitha rekomandimet të cilat ka dhënë për secilin problem që ka trajtuar. Mirëpo, këto rekomandime si çdo herë mbeten vetëm në letër, sepse Qeveria nuk ka vullnet, apo thënë më saktë, nuk i leverdis të them më saktë që t'i zbatojë ato në praktikë, sepse në këtë mënyrë do të duhej të ngrihej kundër vetes.

“Vetëvendosje” do të votojë pro raportit të Institucionit të Avokatit të Popullit dhe rekomandimeve që dalin nga ky raport, madje do të vazhdojë të bëjë presion kundrejt Qeverisë për zbatimin e këtyre rekomandimeve.

KRYESUESI: Shpresoj se Avokati i Popullit nuk do ta denoncojë shkeljen e të drejtave të njeriut, pasi ti e denoncove. Fjalën, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, e ka zonja Kymete Bajraktari.

KYMETE BAJRAKTARI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka shqyrtuar Raportin e punës për vitin 2011 të Institucionit të Avokatit të Popullit. Marrë nga përmbajtja, radhitja e

çështjeve të ngritura në raport përkon plotësisht me përmbajtjen e kapitullit II të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Temat të cilat janë të përfshira në këtë raport janë:

- Zbatimi i ligjit dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut;
- Konsolidimi i sistemit gjyqësor dhe Prokurorisë, si dhe
- Luftimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Raporti i 11-të vjetor i Avokatit të Popullit paraqet gjendjen reale të të drejtave dhe lirive të njeriut në Kosovë, përmban rekomandimet e bëra institucioneve qeveritare, gjyqësorëve dhe të gjitha institucioneve, të cilat nuk e kanë respektuar Ligjin për të drejtat dhe liritë e njeriut.

Në raport është paraqitur mënyra se si janë bërë shkeljet në respektimin e ligjit dhe mosrealizimin e këtyre të drejtave, si dhe angazhimin e Institucionit të Avokatit të Popullit për mbrojtjen e këtyre të drejtave dhe sensibilizimin e opinionit.

Raporti është i strukturuar me këtë renditje.

E para, i përfshin të drejtat dhe liritë në Kosovë, të cilat gjenden në kapitullin II të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

E dyta, paraqet aktivitetet e Avokatit të Popullit me grupet për barazi gjinore, të drejtat e fëmijëve dhe grupit për mosdiskriminim;

E treta, bashkëpunimin e Institucionit të Avokatit të Popullit me institucionet vendore, shoqërinë civile dhe me organizatat ndërkombëtare;

E katërta, paraqitja e buxhetit të Institucionit të Avokatit të Popullit, në të cilin është paraqitur shqetësimi i Avokatit të Popullit për ndërhyrje të paautorizuar dhe arbitrare, pa paralajmërim, në buxhetin e Avokatit të Popullit nga Qeveria, me çka edhe është cenuar pavarësia financiare dhe institucionale;

E pesta, është paraqitur një pasqyrë e statistikave të ankesave dhe rasteve për vitin 2011.

Kur argumenti i forcës është mbi forcën e argumentit, kur ata të cilët duhet të jenë në mbrojtje të argumentit janë të korruptuar, patjetër që jeta e qytetarit, e sidomos e shtresës me gjendje të vështirë ekonomike, e pasqyron gjendjen e mjerë, se argumenti është në anën e të fortit.

Në këto rrethana, sundimi i ligjit është sfidë për institucionet, Gjyqësorin, Prokurorinë dhe ligjvënësit. Shkelet e drejta e lëvizjes, e pronës, e jetës dhe qytetari i Kosovës nuk mund të mos jetë i dëshpëruar dhe i zhgënjyer, sepse asnjëherë nuk kishte shpresuar se do të jetonte në një Kosovë, ku krimi është i veshur me petkun e politikës dhe korrupsioni, i cili fatkeqësisht ka përfshirë dhe është bërë pjesë e këtij sistemi, po e thellon edhe më tej ndarjen ndërmjet shtresave të popullit, në të varfër dhe të pasur, të atyre që u shkelet e drejta në mënyrë arbitrare dhe profiterëve.

Institucioni i Avokatit të Popullit, nëpërmjet këtij raporti, e ilustron gjendjen faktike të qytetarit të Kosovës.

Ky raport do të ishte edhe më i kompletuar nëse në përmbajtjen e tij do të kishte paraqitur një pasqyrë të statistikave, se cilat rekomandime nga Institucioni i Avokatit të Popullit bërë institucioneve të Kosovës janë realizuar, sa kanë mbetur pa u realizuar dhe nga cilat institucione.

Te kapitulli për të drejtat e fëmijëve, vërehet mungesë e raportimit sa i përket dukurisë së trafikimit me fëmijë, ku në raportin e Ministrisë së Punëve të Brendshme, dorëzuar Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione situata është shqetësuese, sepse numri i fëmijëve të trafikuar është rritur dukshëm në vitet e fundit. Sipas raportit në vitin 2009, numri i fëmijëve të trafikuar ka qenë 7, ndërsa në vitin 2011 ky numër ka arritur në 17, që mendoj se duhet trajtuar nga Institucioni i Avokatit të Popullit, si rast ex officio ose zyrtar.

Raportin e Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2011, Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës do ta votojë dhe njëherësh kërkon nga Qeveria që të mos e cenojë pavarësinë e institucioneve të pavarura, në këtë rast të Avokatit të Popullit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, zoti Ahmeti e ka fjalën.

AMIR AHMETI: Faleminderit!

I nderuar kryesues,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Qytetarë të Kosovës,

Flas në emër të Grupit të Koalicionit Kosova e Re. Për ne, ky raport i Avokatit të Popullit është shumë shqetësues, kur para deputetëve, para ligjvënësve të Kosovës, ai na bën me dije se ne jemi afër një kolapsi të sistemit të drejtësisë. Për më tepër, thotë se të drejtat dhe liritë e njeriut në Republikën e Kosovës janë në gjendje alarmante.

Gati në asnjë paragraf, Avokati i Popullit nuk na la të kuptojmë se kemi ndonjë plus diku në ndonjë hallkë të sistemit të drejtësisë, përveç se mbetet për t'u dëshiruar, gjë që nuk është e mirë për ne.

Të drejtat dhe liritë e njeriut kanë qenë bazë e ndërtimit të shteteve demokratike në botë, ndërsa ne, si shtet i ri, nuk po bëjmë sa duhet në ndërtimin e demokracisë në vendin tonë, duke e forcuar Gjyqësorin dhe tërë sistemin e drejtësisë.

Edhe më shqetësuese është kur ne lexojmë në raportin e Avokatit të Popullit se ata që duhet të mbajnë dhe të ndajnë drejtësi, ata ndajnë padrejtësi, madje edhe korruptohen shumë lehtë.

Në raportin e Avokatit të Popullit përshkruhen shumë shkelje të ndryshme, si të drejtat e njeriut në punësim, ku politika e ka fjalën e fundit, shkelja e drejtës së lëvizjes, madje shkelja edhe e besimit, e fesë, në mungesë të një ligji të mirëfilltë për liritë fetare dhe statusin e tyre juridik, vërejtje kjo që është dhënë edhe në Raportin e Progresit.

Si mungesë e një ligji të mirëfilltë për liritë fetare, ne kemi raste kur drejtorët e shkollave bëhen gjyqtarë dhe ekzekutues të së drejtës dhe i përjashtojnë vajzat nga shkolla vetëm për shkak se mbajnë shami në kokë.

Është shqetësuese shumë kur tani i vetmi institucion që ngre zërin dhe ndriçon parregullsitë në sistemin e drejtësisë dhe për shkelje të të drejtave të njeriut që po bëhen në Kosovë, ky institucion pengohet në mënyra të ndryshme, ndërsa mendimi ynë i fundit është se zgjidhja e tërë këtij kaosi në drejtësinë dhe gjyqësinë kosovare, nuk zgjidhet ndryshe, përveç kur politika t'i largojë duart nga emërimet politike në të gjitha dikasteret, e sidomos në ato të drejtësisë.

Pa një gjyqësor të pavarur dhe pa emëime të pavarura, raporti i Avokatit të Popullit për vitin e ardhshëm do të jetë edhe më shqetësues. Ne këtë raport do ta votojmë, sepse në këtë raport pasqyrohen shumë shkelje dhe duhet një vetëdijësim për ne dhe për raportet që do të jenë në të ardhmen. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga SLS, zoti Goran Marinković e ka fjalën.

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala, predsedavajući!

Poslanička grupa Samostalne liberalne stranke je razmatrala Izveštaj o Narodnom advokatu. Dolazimo do zaključka da je kršenje ljudskih prava na najvišoj mogućoj tački danas na Kosovu, što dodatno i veoma zabrinjava našu zajednicu.

Po izveštaju vidimo da imamo dosta nerešenih sudskih sporova, da je zakonodavstvo na najnižoj tački, ali posebno zabrinjava što pojedinci u određenom momentu uzimaju zakon u svoje ruke.

Ljudska prava i slobode su teme demokratije društva danas u svetu, i mislim da je krajnji slučaj da svi mi budemo svesni u izgrađivanju svog društva danas na Kosovu.

Mislim da izveštaj daje realnu sliku stanja na Kosovu danas. I Poslanička grupa Samostalne liberalne stranke podržace izveštaj Narodnog advokata. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin “6+”, zoti Albert Kinolli.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar “6+” e ka shqyrtuar Raportin vjetor të punës për vitin 2011 të Avokatit të Popullit dhe raportin financiar, dhe Grupi Parlamentar “6+” do të votojë për këtë raport. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e deputetëve. Zoti Arsim Bajrami e ka fjalën.

ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Ministër Mujota,

Ministër Hamza,

Të nderuar deputetë,

Pa dyshim se diskutimi për Raportin e punës së Avokatit të Popullit është një moment i rëndësishëm për Kuvendin e Kosovës, sepse po diskutojmë për punën e një institucioni shumë të rëndësishëm kushtetues, që e ka një mision kushtetues: të mbrojë, të monitorojë respektimin e lirive dhe të drejtave të qytetarëve.

Siç dihet, Kosova nuk qëndron keq sa u përket aspekteve kushtetuese dhe aspekteve ligjore dhe lirive dhe drejtave të njeriut dhe pa dilemë mund të themi se ne kemi aplikuar brenda legjislacionit tonë standardet më të larta evropiane, jo vetëm në Kushtetutë, por edhe në legjislacion. Njëjtë sikur kur është fjala për të drejtat individuale, ashtu edhe kur është fjala për të drejtat individuale, ashtu edhe kur është fjala për të drejtat e pakicave, trajtimi ligjor dhe kushtetues është në nivel.

Mirëpo, misioni i Avokatit të Popullit është krejt tjetër, jo të analizojë se si ne i mbrojmë liritë dhe të drejtat në legjislacion dhe Kushtetutë, po sa i realizojmë në praktikë dhe problemi i realizimit praktik të lirive dhe të drejtave të njeriut është një problem me të cilin ballafaqohen të gjitha shtetet, madje edhe ato shtetet që janë anëtare të Bashkimit Evropian.

Është jashtëzakonisht e drejtë qasja që ka bërë Avokatit të Popullit, duke identifikuar problemet reale në realizimin e lirive dhe të drejtave individualisht, duke përmendur një nga një, dhe fakti që Avokati ka dalë me rekomandime konkrete për institucionin.

Por, ajo që mua më shtyri të diskutoj, është fjalimi i Avokatit të Popullit dhe shqetësimi që unë kam personalisht, do të thotë është një konstatim i Avokatit që unë nuk e kontestoj, që përpos qytetarëve nuk ka përkrahje institucionale sa u përket gjetjeve të Avokatit të Popullit dhe kjo është shqetësuese, për shkak se Avokati i Popullit është institucion kushtetues i Republikës së Kosovës dhe ai ka për detyrë që ta ushtrojë funksionin e vet kushtetues dhe ajo çfarë unë do të kërkoja, do të kërkoja që Avokati i Popullit të jetë shumë më transparent, t'i përmendë emrat e institucioneve që nuk i marrin parasysh gjetjet dhe rekomandimet, sepse duhet pranuar, këto raporte të Avokatit të Popullit dhe raportet tjera janë jashtëzakonisht të rëndësishme për progresin e Kosovës në agjendën evropiane dhe ne do të donim që në Kuvend, si Kuvend që i diskuton këto raporte, të dimë se cili është ai institucion i nivelit qendror, i nivelit lokal, i cili i injoron gjetjet e Avokatit të Popullit.

Nuk dëshirojmë që në çdo diskutim, çdo vit kur pranojmë diskutime të Avokatit të Popullit, ne të kemi gjithmonë konstatime se institucionet nuk veprojnë karshi gjetjeve të Avokatit të Popullit. Dëshirojmë që si Kuvend të dimë, qoftë edhe në formë tabelore se cilat janë institucionet që i injorojnë gjetjet dhe kërkesat e Avokatit të Popullit.

U përmend sektori i gjyqësisë. Të gjithë e dimë problemin e zbatimit të vendimeve gjyqësore dhe është një problem për të cilin po flitet dhe është realitet, por në Raportin e Avokatit të Popullit ka vërejtje edhe sa u përket institucioneve tjera, edhe sa u përket mekanizmave tjerë kushtetues dhe do të ishte mirë që raporti të shfletojë listën e institucioneve që nuk kanë vepruar prej vitit në vit, sepse këto konstatime të Avokatit të Popullit po përsëriten prej viti në vit dhe krahas debatit, ne për miratimin e Raportit të Avokatit të Popullit duhet të debatojmë edhe për përgjegjësinë e institucioneve kushtetuese për mosmarrjen parasysh të gjetjeve të Avokatit të Popullit.

Sepse, detyra e Avokatit të Popullit kudo është pikërisht që të bëjë kritikë, pikërisht natyra, misioni kushtetues i Avokatit të Popullit është që të jetë një oponencë sa i përket gjendjes së lirive të drejtave të njeriut, por oponencë në kuptimin pozitiv, që duke dhënë gjetjet të përmirësojë në ndërtimin dhe ngritjen e standardeve sa u përket lirive dhe të drejtave të njeriut, sepse ne nuk mund të krenohemi vetëm me legjislacion të mirë, vetëm me Kushtetutë të mirë për liritë dhe të drejtat e njeriut, por me praktikë të mirë dhe progresi ynë, shkalla e demokratizimit të vendit tonë, kultura e sundimit të ligjit, pa dyshim se do të matet edhe me praktikën e realizimit konkret të lirive dhe të drejtave të njeriut.

Dhe, unë uroj që këto gjetje të Avokatit të Popullit të implementohen dhe mbështes Institucionin e Avokatit të Popullit që ai të jetë edhe më i guximshëm, duke cekur me fakte konkrete institucionet, organet, por edhe individët pse jo, të cilët bëhen pengesë e implementimit dhe realizimit të plotë të gjetjeve apo të rasteve të shkeljeve të lirive dhe të drejtave të njeriut. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Donika Kadaj-Bujupi.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ministra,

Mungesa e shtetit ligjor, humbja e besimit të qytetarëve në institucionet e vendit, sidomos në organet e drejtësisë, nga shtresat dhe grupet më të varfra të shoqërisë, drejtësia e shtetit, e bazuar në ligje përzgjedhëse, anarkia ligjore, tentimet gjithnjë më të shumta të marrjes së ligjit në duart e veta nga qytetarët është pasojë e mosfunksionimit në rritje e shtetit ligjor. Të nderuar kolegë, këto janë disa nga fjalët kyçe që Avokati i Popullit i përshkruan në raportin e tij.

Më lejoni që ta përgëzoj për saktësinë me të cilën e ka përshkruar gjendjen reale në vend dhe në shoqëri dhe konsideroj se këto rekomandime janë alarmante dhe duhet të trokasim në ndërgjegjen e të gjitha institucioneve, por në rend të parë të Qeverisë që të angazhohet për sanimin e kësaj gjendjeje, e cila për çdo ditë po e sforcon kastën e shkelësve të ligjit dhe të drejtave të njeriut përballë qytetarëve.

Ndërkaq sot, kur ne si Kuvend po e shqyrtojmë këtë raport dhe po vazhdojmë t'i diskutojmë rekomandimet e dala nga ai, Kabineti që kaq shtrenjtë po u kushton qytetarëve të Kosovës, po mungon.

I kemi veç dy ministra, të cilët nuk janë relevantë për temat që janë nxjerrë këtu, ndërkaq pjesa tjetër që është përgjegjëse dhe sidomos ata të cilët lidhen me sferën e sundimit të ligjit, ku të gjithë deputetët të cilët e kanë lexuar raportin e shohin se Avokati i Popullit, bazuar në gjetjet e tij, bënë thirrje alarmante që institucionet përkatëse të fillojnë të zbatojnë ligjin në mënyrë që të mos kemi këtë anarki, mungojnë.

Po ashtu, janë edhe rekomandime të rëndësishme për Kuvendin që lidhen me diskriminimin apo raporti ka përshkruar shumë saktë ligjet e zbatueshme me nenet diskriminuese, por fatkeqësisht edhe një numër i madh i kolegëve deputetë, sidomos nga pozita, po mungojnë.

Më lejoni që të përmend Ligjin për skemën sociale, neni 4, i cili e kufizon familjen të jetë përfituese e ndihmës sociale për fëmijët mbi 5 vjeç. Është në kundërshtim me nenin 1 për të drejtat e fëmijës të Konventës Ndërkombëtare, por është edhe e palogjikshme. Një fëmijë 5-vjeçar, në momentin që i mbush 5 vjet, nuk mund të kujdeset për vete dhe familja është në gjendjen e njëjtë sociale. Është një rekomandim që vazhdon të përcillet nga një raport në tjetrin, por asnjëherë nuk kemi ndërmarrë veprim për ta ndryshuar.

Pastaj, Ligji për pensionet, edhe pse në vitin 2005, Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale e ka përgatitur Projektligjin për sigurimin pensional dhe invalidor. I njëjti nuk është proceduar asnjëherë në Kuvendin e Kosovës dhe sot është i zbatueshëm vetëm Ligji për pensionet bazë dhe e dimë se si vazhdon të jetë gjendja e pensionistëve si pasojë.

Përsëri të diskriminimi, në sferën e shëndetësisë është një mungesë e Ligjit për shërbimet shëndetësore. E dimë që gjatë fushatës shumë njerëz kanë ardhur në pushtet dhe kanë marrë poste me premtimin që ky ligj brenda një afati shumë të shkurtër kohor do të jetësohet dhe qytetarët e Kosovës, të cilët janë shumë të varfër, do të kenë mundësi që t'u qasen shërbimeve mjekësore.

Diskriminimi i Gjqësorit dhe nga Gjqësori. Ministri i Drejtësisë nuk është këtu, por, sipas raportit, me gjithë përmirësimin e infrastrukturës dhe të bazës materiale nuk vërehet ndonjë shtim i efikasitetit apo përmirësim sa i përket vënies së drejtësisë në vend.

Mendoj se është momenti i fundit kur Kosova duhet të reflektojë dhe institucionet e saj duhet të reflektojnë ndryshe.

Një veprim shumë diskriminues, i cili është nxjerrë në këtë raport, është vërejtur te punësimi i grave, sidomos atyre shtatzënave dhe në sferën e arsimit. Besoni ose jo, në komunat e Kosovës, bazuar në statistikat dhe gjetjet, një numër shumë i madh i grave janë larguar nga puna dhe atyre nuk u janë vazhduar kontratat, sepse kanë qenë shtatzëna. Është absurditet në vete, nuk di kujt i ka penguar gjendja e tyre, e sidomos në sektorin e arsimit, ato kanë mbetur pa punë.

Pastaj, te barazia gjinore, vendimmarrja dhe e drejta në punë, po ashtu janë sfera ku raporti ka gjetur diskriminim të grave dhe me theks të veçantë gjendja është shumë serioze, do të thotë, sipas raportit, është tek e drejta e trashëgimisë dhe pronës, ku gratë

në të shumtën e rasteve nuk lejohen, nëpërmjet dhunës fizike apo psikike, ta shfrytëzojnë të drejtën e pronës të garantuar me ligj.

Dhe unë do ta përmend vetëm një statistikë, e cila nuk është përmendur në këtë raport. 98% e pronës në Kosovë i takon një gjinie, dhe mund ta merrni me mend, cilës. Do të thotë, vetëm 2% e grave e shfrytëzojnë të drejtën në qasje të pronës.

Në raport është dhënë shembulli i një vajze, e cila pas vdekjes së babait është hedhur nga xhaxhai në rrugë bashkë me të ëmën. Peripecitë që i ka shkaktuar gjykata, kanë qenë të natyrës së zvarritjes së vendimit dhe neglizhencës për të vendosur drejt. Dhe, vetëm pas intervenimit nga Institucioni i Avokatit të Popullit, procedura është kryer në favor të vajzës, bazuar në ligj.

Dua ta përgëzoj Institucionin e Avokatit të Popullit për një iniciativë të tillë, mirëpo mendoj se duhet inkurajuar dhe të kërkon fuqishëm nga institucionet e tjera që të ndërmarrin veprime, të cilat do të fillojnë zbatimin e ligjit dhe barazinë ndërnjerëzore në Kosovë.

Edhe një herë, mendoj që Avokati i Popullit është inkurajues dhe shembull, mirëpo mosmarrja parasysh e rekomandimeve të dala nga raporti dhe jo vetëm këtij raporti nga organet shtetërore, flet dhe e konfirmon edhe një herë mungesën e vullnetit politik që të zbatohet ligji në Kosovë dhe qytetarëve t'u krijohet mundësia për t'i zgjedhur problemet e tyre.

Në vazhden e këtyre mosangazhimeve për zbatimin e ligjit, Kuvendi me theks të veçantë duhet të insistojë në zbatimin e vendimeve të plotfuqishme dhe ekzekutive të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Politizimi i skajshëm i shërbyesve civilë, largimi nga puna në baza partiake, është diçka që po vazhdon që qytetarët e Kosovës t'i mbajë peng të të drejtave të tyre. Mendoj që janë shumë raste, sidomos nëpër komuna, të cilat janë proceduar dhe janë marrë vendime, mirëpo kryetarët hezitojnë që t'i zbatojnë. Dhe, është punë e Kuvendit që të insistojë, do të thotë që ky politizim dhe këto shkelje të vazhdueshme, jo vetëm të ndërpriten, por ata të cilët janë dëmtuar në dy-tre vjetët e fundit të kthehen në vendet e tyre të punës dhe t'u jepet e drejta e qytetarit.

Kjo është do të thotë një përmbledhje, për të cilën Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës edhe një herë konsideron që janë një mori rekomandimesh, është një thirrje alarmuese e Institucionit të Avokatit të Popullit që ky vend të fillojë të vendosë drejtësi dhe mendoj që nga ky Kuvend duhet këto rekomandime të fillojnë të mbikëqyren dhe të fillojë zbatimin e tyre, nëse s'duam të shkojmë në kolaps edhe si shtet, edhe si vend. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Hykmete Bajrami e ka fjalën.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryesues!

Po diskutojmë për Institucionin e Avokatit të Popullit. I nderuari raportoi se si qytetarëve të Kosovës u shkelen të drejtat e tyre.

Unë po e shfrytëzoj rastin në këtë pikë, të tregoj se pak minuta më parë, pikërisht nga ju mua m'u shkelën të drejtat. Derisa po diskutonim për shtyrjen e mocionit për debatin parlamentar për privatizim, ju nuk ma dhatë fjalën, edhe pse unë e kërkoja vazhdimisht. Meqenëse nuk mund të flas në pikën respektive, unë po e shfrytëzoj rastin të flas tani.

Të nderuar qytetarë,
Të nderuar deputetë,

KRYESUESI: Jo, unë ta marr fjalën! Është kryer ajo pikë e rendit të ditës!

HYKMETE BAJRAMI: Të nderuar qytetarë,
Të nderuar deputetë,
Qëllimi i vetëm i shtyrjes së debatit parlamentar, ishte blerja e kohës nga Qeveria, sepse më 20 shtator....

KRYESUESI: Regjia, ia ndërprit fjalën! Fjalën e ka deputetja Vjollca Krasniqi.

(Deputetja Hykmete Bajrami vazhdon të diskutojë pa mikrofon.)

KRYESUESI: Rregullorja e Kuvendit të Kosovës, për mocione ua jep fjalën vetëm kryetarëve të grupeve parlamentare dhe unë ua dhashë më shumë se aq. Nuk ishte debat për mocion, dhe nuk bëhet debat asnjëherë.

(Reagon deputetja Hykmete Bajrami)

KRYESUESI: Dy deputetë kanë diskutuar. Në fakt, ka diskutuar kryetari i Grupit Parlamentar të LDK-së, ka diskutuar nënkryetari i Parlamentit të Kosovës, që vjen po nga LDK-ja dhe ua kam dhënë dy herë fjalën zotit Adem Grabovci dhe zotit Visar Ymeri, meqenëse kërkesat kanë qenë të Visarit dhe kërkesa Ademit. Ua kam dhënë fjalën që të ballafaqohen. Nuk ka qenë e qëllimshme t'ua marr juve fjalën, besoni, s'ka qenë. Ke qenë në radhë, por Rregullorja e thekson shumë mirë që për mocion deklarohen kryetarët e grupeve parlamentare dhe hidhet në votim. Nuk ka asnjë qëllim, më besoni!

(Ndërhyrje)

Unë me gjithë qejf ua kisha dhënë fjalën, por meqë deshët...

(Ndërhyrje)

Fjalën e ka zonja Krasniqi, nëse e do fjalën.

(Ndërhyrje - reagim i deputetes Hykmete Bajrami)

KRYESUESI: Unë isha shumë korrekt. Unë nuk e kam asnjë qëllim ndaj jush, më besoni. Zonja Krasniqi e ka fjalën.

VJOLLCA KRASNIQI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Ju, zoti kryesues, pak më herët thatë që të jeni më të disiplinuar, apo të jetë një Parlament më serioz. Nuk di se kujt i jeni drejtuar? Thuaja se 3-4 deputetë janë të pozitës, shumica e ministrave nuk janë këtu, gjynah për pagat që marrin nga taksapaguesit e qytetarëve tanë.

Ky raport ngërthen në vete segmente të shumta të promovimit të lirisë e të të drejtave të njeriut, por edhe shkelje drastike të tyre, numër të madh të ankesave drejtuar këtij institucioni në sfera të ndryshme.

Sa i përket raportit, kemi çka të flasim shumë, mirëpo unë do të doja të ndalesha vetëm në dy-tri çështje, në çështjet që ndoshta edhe u përmendën fillimisht nga parafolësit, se kemi telashe e probleme dhe joefikasitet në sistemin gjyqësor, kemi të dhëna të shumta edhe në këtë raport.

Nga analiza e natyrës së ankesave të hetuara të qytetarëve konstatohet se shumica e ankesave ka të bëjë me zvarritje herë-herë edhe disavjeçare të procedurave gjyqësore. Me gjendjen e tillë në Gjyqësor nuk pajtohet as Avokati i Popullit dhe nuk gjen arsyetim për zvarritje të procedurave që kanë të bëjnë me konteste, sidomos konteste pronësore, kur qytetarët janë të detyruar të presin me vite të tëra. Këtë gjendje të Gjyqësorit, lidhur me vonesat dhe zvarritjet në shqyrtimin e lëndëve e kanë konstatuar edhe organizatat ndërkombëtare që e monitorojnë Gjyqësorin.

Një çështje tjetër që do të doja ta theksoj ka të bëjë pikërisht me temën, e cila nuk u lejua të debatohet në fillim të seancës, lidhur me privatizimin gjegjësisht me këtë proces të degraduar.

Në këtë raport thuhet që Gjykata Komunale në Ferizaj, kundër Agjencisë Kosovare të Pronës ka bërë padi për kompensimin e rrogave të papaguara të 572 punonjësve në ndërmarrjen e çelikut, IMT. Edhe pse u bë i plotfuqishëm aktgjykimi, ai asnjëherë nuk u përmba.

Pas përfundimit të procedurave gjyqësore në Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme dhe shterjes së të gjitha mjeteve juridike, Sindikata e Pavarur e kësaj ndërmarrjeje i parashtrroi kërkesë Gjykatës Kushtetuese, e cila konsideron që vendimi final dhe i detyrueshëm i Gjykatës Komunale në Ferizaj duhet të ekzekutohet nga autoritetet kompetente nga Qeveria dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit.

Ky aktgjykim, deri në ditët e sotme, ende nuk është zbatuar nga autoritetet e obliguara sipas aktgjykimit. Prandaj, kemi shkelje të rënda të të drejtave të punëtorëve. Ky proces ka prodhuar vetëm grumbuj letrash të pavlerë, humbje të besimit në institucionet shtetërore dhe shpresa se një ditë do të triumfojë drejtësia.

Këtu e kemi edhe një ministër relevant, që ka të bëjë me këtë raport, është zoti ministri i Financave. E kemi në faqen 135 ndërhyrjen e Qeverisë së Kosovës në buxhetin e Avokatit të Popullit.

Zoti ministër,

Këtu Avokati i Popullit nuk pajtohet me interferimin tuaj dhe ndërhyrjen arbitrare apo kundër-kushtetuese në mjetet buxhetore, ku kemi ngrirje të një pjese të buxheti të tyre në vlerë prej 13 000 euro, edhe pse Institucioni i Avokatit të Popullit ka bërë ankesë dhe e ka njoftuar edhe kryetarin e Kuvendit, këto mjete nuk i janë kthyer dhe meqenëse jeni këtu, sigurisht se do të jepni një përgjigje, sepse unë saktësisht nuk do të mund ta di a ka të drejtë Avokati apo jo.

Sa i përket Institucionit të Avokatit të Popullit për donacionet që i ka marrë dhe e ka marrë një shumë bukur të madhe, nuk haset në asnjë faqe se ku janë shpenzuar këto donacione, apo se a janë shpenzuar për dedikimin që janë dhënë. Nuk ka trajnime të punëtorëve dhe besoj se ky institucion do të ishte më profesional nëse do t'i trajtonte profesionalisht punëtorët e vet.

Përndryshe, unë do ta përkrah dhe e votoj këtë raport. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit!

I nderuar nënkryetar!

Deputetë të nderuar,

E nderuara deputete,

Është mirë që këtu është edhe Avokati i Popullit dhe po përkufizohen vetëm në këtë aspektin financiar.

Sa u përket çështjeve financiare, me përgjegjësi po e them, është mirë të mbrohet Raporti i Avokatit të Popullit aty ku ka të drejtë. Po është mirë të kërkohet llogari, dhe Avokati i Popullit të japë llogari para Kuvendit në segmente të caktuara. Po flas, si institucion.

Sa u përket çështjeve financiare, dihet se disa veprime që kanë ndodhur, disa punësime brenda Institucionit të Avokatit të Popullit kanë ndodhur pasi kanë përfunduar procedurat buxhetore. Të gjitha kërkesat e arsyeshme të Avokatit të Popullit janë marrë në konsideratë dhe janë plotësuar. Ministria e Financave nuk hyn në atë se a është e madhe apo e vogël rroga e Avokatit të Popullit, dhe zëvendësve të tij, sepse është dikush tjetër që e cakton. Ne e kemi buxhetuar. Ka pasur pengesa për shkak se shumë vende janë plotësuar pas përfundimit të procedurave buxhetore, mirëpo, nëse ka segment ku ka diskriminim pozitiv, një prej tyre është Institucioni i Avokatit të Popullit.

Deputete e nderuar,

Të lutem, merre listën e pagave të punëtorëve që punojnë brenda Institucionit të Avokatit të Popullit. Një drejtor financiar, po e marr si shembull, i cili e menaxhon një buxhet përafërsisht 1 milion, e ka pagën më të lartë se sa drejtorë të buxheteve në nivel të

komunave, në nivel të ministrive, që ndoshta e kanë përgjegjësi dhe kanë menaxhim buxhete milionëshe. Prandaj, të gjithë të punësuarit brenda Institucionit të Avokatit të Popullit nuk e di a kanë të drejtë, a s'kanë të drejtë. Le ta thonë ata, a kanë të drejtë a s'kanë të drejtë, realizojnë paga më të larta se sa pagat ekuivalente të njerëzve të punësuar nëpër institucionet tjera. Kur i konvenon, e trajtojnë veten si shërbyes civilë, kur s'u konvenon, thonë - ne nuk jemi shërbyes civilë.

Dhe, përfundimisht, me rishikimin e buxhetit, është rregulluar kjo çështje. Sikur të gjitha institucionet tjera, edhe Institucioni i Avokatit të Popullit duhet ta ketë në konsideratë Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi, se kur kemi të bëjmë me financa publike dhe përgjegjësi, ky ligj në një mënyrë i mbizotëron të gjitha ligjet tjera.

Prandaj, kërkesat e Institucionit të Avokatit të Popullit duhet të vijnë nëpërmjet Ministrisë së Financave. Institucioni i Avokati të Popullit duhet të vijë në dëgjime në Ministrinë e Financave, do t'i arsyetojë kërkesat e veta dhe sigurisht ne nuk e shohim ndonjë problem që kërkesat e arsyeshme të institucionit të Avokatit të Popullit t'i marrim në konsideratë dhe t'i mbulojmë ashtu qysh e rregullon ligji.

Edhe një çështje tjetër, u shtrua nga një deputete e nderuar, çështja e vendosjes së Institucionit të Avokatit të Popullit brenda Administratës Tatimore të Kosovës, në Mitrovicë. Është konflikt interesi. Edhe nëse nuk e di hierarkia e Institucionit të Avokatit të Popullit që ky është konflikt interesi, unë sot po ju them, le ta hulumtojnë se është konflikt interesi.

Ne jemi të gatshëm si Ministri e Financave të ndajmë mjete të mjaftueshme që të sigurohen hapësira të mjaftueshme, apo do të jenë në objektet e Kuvendit komunal të Mitrovicës, apo do të jenë me qira, ne do të ndajmë fonde të mjaftueshme.

Mirëpo, nuk mund të lejojmë konflikt interesi brenda atij institucioni. Unë e shoh që nga pak Avokati i Popullit bën me dorë. E vlerësoj krejt atë çka ka punuar mirë, çka ka punuar mbarë. Po, sinqerisht, pjesën më të madhe e kam parë se ka folur për kushte të punës, për rroga, për punësime dhe këtu është sjellë puna. Prandaj, me përgjegjësi e them dhe ju lus, mos e merrni fjalën time çka e thashë. Merrini raportet e pagave të Institucionit të Avokatit të Popullit dhe pozitat ekuivalente janë të diskriminuara, por janë të diskriminuara pozitivisht. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Kelmendi.

GËZIM KELMENDI: Faleminderit!

I nderuar kryesues,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Fillimisht dëshiroj ta përshëndes punën e Institucionit të Avokatit të Popullit për një raport, të cilin e ka paraqitur këtu para nesh. Dhe, megjithatë, është bërë paraqitje e shumë fushave, e shumë sektorëve nga Avokati i Popullit dhe për të gjitha këto që shumica nga ne u pajtuam, është se në Kosovë po ballafaqohemi me një situatë të rëndë

të moszbatimit të ligjeve, të cilat i kemi miratuar ne si Kuvend dhe moszbatimin e Kushtetutës në shumë nene të caktuara. Dhe, në anën tjetër, aty ku kemi mungesë të ligjeve na dalin udhëzimet mbi ligje dhe mbi Kushtetutën.

Është për të cekur situatën mjaft të rëndë në sistemin e Gjyqësorit, ku mungesa e shumë rasteve dhe prolongimi ka çuar në moszgjidhjen e shumë problemeve nga sektori civil. Gjithashtu, edhe në fushën penale, ku ne jemi shumë të vetëdijshëm për mungesën e këtyre gjykimeve dhe konkretisht të një keqpërdorimi nga vetë ata që e udhëheqin drejtësinë, konkretisht bashkëpunimin apo zinxhiri si urë lidhëse ndërmjet avokatit - gjyqtarit dhe e fundit prokurorit, kemi mosshprehje të dënimit të merituar ndaj personave me vepra penale. Jemi dëshmitarë se nëpër rrugët e vendit tonë sillen shumë njerëz të cilët nuk e meritojnë të jenë të lirë, por prapa grilave, ndërsa në anën tjetër, gjithashtu mungesë e këtij sistemi të Gjyqësorit kemi edhe rritjen e hakmarrjes në një shkallë shumë të madhe në vendin tonë.

Gjithashtu, është për t'u përmendur edhe vlerësimi që është bërë sa i përket diskriminimit në aspektin e të punësuarve. Është elaboruar në shumë pika çështja e diskriminimit në punësim, por unë e kisha shtuar edhe çështjen e punësimit dhe shkallën e lartë të korrupsionit. Jemi koshientë se në shumë fusha të punësimit në institucionet publike është shfaqur një dukuri mjaft e rëndë, e cila ka të bëjë me paradhënien për një vend të punës, ku shumë drejtorë apo udhëheqës të atij institucioni pranojnë para për ta punësuar një punëmarrës të ri. Kjo është një dukuri e cila ka zënë fill në shumë fusha tona dhe duhet luftuar.

Gjithashtu, kemi edhe diskriminimin gjinor sa i përket punësimit, ku shihet se femra kosovare është e diskriminuar në aspektin e punësimit, e gjithashtu e diskriminuar edhe sa i përket pushimit të lehonisë, ku në shumë fusha i ndërpritet kontrata e punës për shkak të lehonisë që ka. Femra kosovare është e diskriminuar edhe në shumë fusha, e këtui në Raportin e Avokatit të Popullit është cekur kryesisht te komuniteti ashkali, rom, egjiptian, por unë kisha shtuar se është e diskriminuar edhe te komunitetet tjera, edhe te komuniteti shqiptar. Përparësi në punësimin e femrës nuk ka përvoja apo kualifikimi i saj intelektual, por, me keqardhje mund të them, dukja dhe ekstravaganca e saj.

Gjithashtu, është për t'u përmendur edhe diskriminimi i qytetarëve të Kosovës sa i përket korporatës së KEK-ut, meqë kategorizimi ABC është dëshmuar se është diskriminues. Shumë qytetarë që janë pagues të rregullt të KEK-ut diskriminohen për fajin e atyre që nuk janë pagues të rregullt, vetëm e vetëm për shkak të diskriminimeve të këtij kategorizimi diskriminues, A, B dhe C. Gjithashtu, vlen të përmenden, edhe te Avokati i Popullit është cekur këtui, edhe dukuritë, të cilat janë shqetësuese për shoqërinë kosovare, por unë do të shtoja se mungojnë edhe disa dukuri që janë mjaft shqetësuese për shoqërinë kosovare. Është çështja e fajdexhinjve, që është mjaft e aktualizuar në Kosovë. Çështja e atyre që marrin haraç apo reket, që e pengojnë zhvillimin e mirëfilltë të bizneseve të vogla apo të mëdha kosovare, pastaj rrëmbimet, kidnapimet dhe dhunimet e ndryshme, që ndodhin në Kosovë.

Gjithashtu, është për t'u përmendur se ne po ballafaqohemi me këtë rast si mungesë zbatimit të ligjeve në fuqi. Kemi shumë ligje që nuk zbatohen, por në raste tjera kur nuk kemi ligje apo kemi nene të Kushtetutës së Kosovës, në këtë rast kur udhëzimet administrative i tejkalojnë kompetencat e ligjeve dhe të Kushtetutës. Rastin e fundit e kemi kur në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, konkretisht neni 38, paragrafi 3 shkruan se asnjë qytetari nuk ka të drejtë t'i mohohet manifestimi publik i bindjeve të tij fetare.

Gjithashtu, edhe Ligji për arsimin parauniversitar, neni 3 paragrafi 3, thotë se arsimimi është i obligueshëm për të gjithë qytetarët e Kosovës dhe askush nuk guxon të privohet nga arsimi, pa dallim race, feje, etnie, ndërsa, ne jemi dëshmitarë, në vitet e fundit, kryesisht nga viti 2010, kemi një udhëzim administrativ, i cili e tejkalon edhe Kushtetutën edhe Ligjin për arsimin universitar dhe ky udhëzim ka shkaktuar shumë probleme në këto institucionet e shkollës, kryesisht në shkollat fillore dhe të mesme, të cilat janë obligative dhe me këtë çështje kemi gjithashtu edhe raportin nga Avokati i Popullit, kur shumë vajza në Republikën e Kosovës janë të larguara nga shkolla për shkak të mbulesës së tyre.

Kjo bie ndesh, në radhë të parë, me liritë dhe të drejtat individuale të njeriut, bie ndesh me nenin 38 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me nenin 3 të Ligjit për arsimin parauniversitar dhe në këtë rast shumë prindër janë detyruar që të gjejnë zgjidhje apo t'i izolojnë vajzat e tyre në shtëpi. Në këtë rast ne po luftojmë kundër të drejtave të njeriut, po luftojmë kundër lirive fetare dhe po e rritim analfabetizmin në Kosovë.

Andaj, unë e përshëndes raportin e Avokatit të Popullit, me shpresë që institucionet kosovare në të ardhmen do të vetëdijesohen, do t'i zbatojmë ligjet aty ku kemi miratuar ligje, ndërsa aty ku kemi mungesë të ligjeve, të miratojmë ligje të mirëfillta. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Limaj e ka fjalën.

FATMIR LIMAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar Avokat i Popullit,

Besoj që nganjëherë çështjen e raportimit të agjencive të ndryshme në Parlamentin e Kosovës ne po e shfrytëzojmë dhe po mbetemi vetëm në debatet e deputetëve dhe asgjë më tepër. Thjesht, raportet po i shfrytëzojmë për ta zhvilluar një debat të kufizuar, sikur që jemi ne sot këtu, dhe nga kjo këtu mbyllet çdo gjë, mbyllet edhe raporti, mbyllet edhe rekomandimet dhe çështjet nuk ndiqen më tutje.

Mendoj që është një moment i mirë, shembull i mirë nga ky raport i Avokatit të Popullit, që Parlamenti i Republikës së Kosovës t'i kryejë obligimet e tij në raport me qytetarët e Kosovës, në kuadër të kompetencave të veta. Pse e them këtë? Për shembull, u konstatuan edhe nga raporti, por edhe nga fjalët e kolegëve deputetë, u ritheksuan, u spikatën ato shkeljet më të mëdha, më të veçanta, që kanë ndodhur për një vit në shkeljen e të drejtave të njeriut.

Avokati në mënyrë taksative na i ka paraqitur fushat e shkeljes së të drejtave të qytetarëve. Cila është detyra jonë? Detyra jonë është që secili komision përkatës, u tha që këtu ka pasur shkelje të drejtave të grave, u tha që këtu ka pasur shkelje të drejtave të fëmijëve, u tha që ka pasur probleme në Gjyqësor, u tha që ka pasur probleme në privatizim dhe kudo tjetër, është detyrë jona si deputetë, tani në komisionet përkatëse t'i ndjekim këto çështje deri në vitin e ardhshëm, për të parë, për ta ndihmuar Avokatin e Popullit për ta ndryshuar gjendjen në sektorë, në të cilët është konstatuar që ka shkelje të ligjit dhe shkelje të drejtave të njeriut.

Në qoftë se ne si deputetë mendojmë se me një raport i Avokatit të Popullit dhe një diskutim yni në Parlament do të duhej të përfundojë çështja, atëherë të nderuar kolegë besoj që ne jo vetëm që nuk e kemi kryer punën tonë, por në një mënyrë apo një tjetër pajtohemi në mënyrë të heshtur me këto dukuri negative që po ndodhin në shoqërinë tonë.

Nuk ka institucion më të rëndësishëm sot, jashtë këtij Parlamenti, për këtë lëmi sesa Avokati i Popullit. Gati thuaja është një konsensus kështu në zhargonin tonë të përditshëm, flasim për shkelje, për probleme, të cilat vazhdimisht Parlamenti i thekson, po dhe ka shqetësime jashtë Parlamentit. Mirëpo, në momentin kur juve ju vjen një konstatim nga një institucion i specializuar, i cili merret drejtpërdrejt me këtë çështje dhe konstaton gjithë këto shkelje, për të cilat foli Avokati i Popullit dhe janë të shkruara në raport, atëherë mendoj që gjendja është alarmante, për të cilën duhet ne të gjithë së bashku në komisionet tona përkatëse të angazhohemi për ta përmirësuar gjendjen.

Unë dua, që në mënyrë të veçantë ta përhëndes dhe ta vlerësoj punën e këtij institucioni të rëndësishëm. Institucioni i Avokatit të Popullit është shembull e shpresë, që tregon shembull për ato të ashtuquajtura institucione të pavarura, se në Kosovë, në qoftë se jeni përkushtuar për të kryer punën tuaj brenda ligjit, ka institucione e ka njerëz, që pavarësisht presioneve të jashtme dhe të brendshme, pavarësisht problemeve teknike e njerëzore, ka në Kosovë, shpresë se mund të ngrihen institucione të pavarura, që i shërbejnë zërit të qytetarit dhe mbi të gjitha ne mbrojtje të Kushtetutës dhe ligjeve të këtij vendi. Dhe, shembulli më i mirë për këtë është Avokati i Popullit dhe puna e tyre deri më tani, për të cilën i përgëzoj.

Le të shërbejë kjo dhe le të tregojë edhe një herë se në Kosovë, të ashtuquajturat institucione të pavarura duhet të nënkuptohen, sepse shumë shpesh e keqkuptojmë këtë çështjen e institucioneve të pavarura. Asnjë institucion në Kosovë nuk është i pavarur. Të gjithë janë të varur nga ligji. Kushdo që e respekton ligjin dhe punon në kuadër të ligjit, ai institucion pastaj e ka pavarësinë e veprimit të vet, në kuadër të kornizave ligjore. Se nganjëherë, këtu te ne me institucion të pavarur nënkuptohet të bëjë çka dëshiron, në mënyrë të pavarur, të shkëputur, jashtë sistemit kushtetues juridik, sikur që ndodh shpesh në agjenci të caktuara. Le të shërbejë edhe ky institucion i pavarur, që e respekton ligjin dhe shqetësimin e qytetarëve dhe mbi të gjitha e respekton Kushtetutën e Kosovës, le të shërbejë për gjykatën. Kush thotë që gjykatat e Kosovës nuk kanë mundësi dhe hapësirë pune për ta bërë punën që e kanë me ligjin. Pse po mund Avokati i Popullit?

Për ta bërë këtë, secili duhet të orientohet, të drejtohet dhe të vendosë që ta respektojë sistemin kushtetues të këtij vendi, duke filluar nga Gjykata Kushtetuese e poshtë.

Kjo situatë alarmante, e cila përshkruhet në raport është si rezultat i vartësisë, i ndikimeve politike, që bëhet në sistemin tonë gjyqësor dhe kjo, besoj unë, e ju do ta shihni në të ardhmen, se kjo po e rrënon, e ka rrënuar, po e rrënon dhe do të vazhdojë ta rrënojë sistemin juridiko-politik të këtij vendi. Po, fatkeqësisht, ne si çdo qytetar, në këtë rast ne që kemi përgjegjësinë kryesore, reagojmë vetëm kur të kemi probleme personale.

Ajo që unë dua të kërkoj nga Avokati i Popullit, që të jetë më aktiv në publik. Ka shumë pak dalje për t'i treguar rezultatet e punës, por edhe për të kritikuar se çka po ndodh në këtë vend, po edhe për të dhënë shpresë, për t'iu treguar të ashtuquajturave agjencive të pavarura, se si mbrohet, të respektohet ligji, Kushtetua dhe mbrohen të drejtat e qytetarëve dhe të tregojmë që në Kosovë, pavarësisht a je mik me Qeverinë, apo s'je mik me Qeverinë, pavarësisht a je mik me një mision, apo s'je mik me një mision, kur e mbron ligjin, për të cilin e ke obligim, atëherë je me të drejtën e qytetarëve dhe domosdo do ta kesh edhe mbështetjen e qytetarëve. Sot, zyra e Avokatit të Popullit është bërë sikur përpara zyra e Nënë Terezës për ndihma. Ju e dini në vitet e '90-ta, i vetmi shpëtim i atij populli ka qenë shoqata "Nëna Terezë" e viteve të '90-ta. Sot është Zyra e Avokatit, sepse këto shkelje masive të t; drejtave të njeriut, të qytetarëve, të vjedhjes së pronës, të shumë problemeve që po ndodhin në Kosovë, nuk ka më adresë ku të trokitet, përveç te Avokati i Popullit. Unë e di që dikush këqyr t'i rrënojë këtë institucione, sepse në Kosovë nuk mund të pranojnë që mund të ketë një institucion, që e ka unin e vet dhe që punon brenda ligjit. Një institucion është i mirë kur i dëgjon të tjerët. Në Kosovë veç duhet t'i dëgjojë, sikur Gjykata Kushtetuese, kur i dëgjon sipas qejfit... Ajo është çdo minutë, çdo ditë i ka vlerësimet 'haj-haj' nga të gjithë, kushdo që flet, shembull konkret, sepse u shërben të tjerëve.

Ju ftoj të gjithë punëtorët e zyrës suaj të jeni në shërbim të qytetarëve. Nuk do ta keni lehtë, do të keni presione, por ju siguroj që do ta nderoni veten me punën që keni bërë deri më tani dhe do të vazhdoni të bëni, në funksion të mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve të këtij vendi, sepse unë jam i bindur që kjo gjendje do të ndryshojë. Unë jam shumë i bindur që e mira do ta mundë të keqen. Unë jam shumë i bindur, ky ngërç juridiko-politik, që e ka kapur këtë sistem të Kosovës, sepse në Kosovë sot më shumë se çdo herë përpara, dominon frika në institucionet e Kosovës. Sot deputeti frikohet të flasë, sot gjyqtari frikohet të gjykojë, sot prokurori frikohet të ndjekë, sot punëtori i sindikatës nuk guxon të dalë të protestojë. Këtë frikë do ta mundim së bashku, duke fituar e mira mbi të keqen. Jo pse kjo do të ndodhë në Kosovë, por kjo ka ndodhë gjithkund në botë. Nuk ka mundësi që e keqja ta mundë të mirën. E mira do të jetë fituese dhe në këtë rast jam i bindur që ju jeni shpresa e atyre të pambrojturve, e atyre që u shkelen vazhdimisht të drejtat e qytetarëve, të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Kushtetutë të cilën e kemi bërë paçavër sipas interesave dhe nevojave që e kërkon politika. Prandaj, ju ftoj zoti avokat që të jeni sa më shumë të pranishëm, për punën, për shqetësimet dhe problemet e qytetarëve, t'i vizitoni komunat, t'i vizitoni qytetarët dhe ato të bëhen publike, në qoftë se normalisht ju prezantojnë mediet.

Dhe, në fund, dua t'ju them, pavarësisht problemeve financiare dhe teknike. Interesant është, veç Avokati i Popullit ka problem me financa. E keni parë se çka po bëhet në RTK. I keni parë sot mediet? Veç Avokati i Popullit ka problem me financa, sepse po bën telashe. Po, unë e di që edhe në këto kushte të vështira, në të cilat ju punoni, ju inkurajojmë të vazhdoni, të vazhdoni për angazhimet tuaja, sepse thashë, ju jeni shpresa, e cila do të ndihmojë, që me të vërtetë në këtë vend të fitojë e drejta e qytetarëve, me të vërtetë në këtë vend të fillojë të mbrohet e drejta e qytetarëve. Dhe, ata drejtues të institucioneve, do të vijë një moment, ose do të dalin publikisht, po flas të ashtuquajturat agjenci të pavarura, për të treguar çka po ndodh në këtë vend në sistemin e drejtësisë, e jo të mbyllen zyrtarë e tyre për të marrë benificione dhe privilegje, ndërsa kur është për përgjegjësi, shmangen nga deklaratimet dhe gjendja, e cila po ndodh në këtë vend. Po e përmbyll, duke thënë që ju në institucionet shtetërore dhe një institucion tjetër joqeveritar, jeni dy institucione, për të cilat shpresoj që do të vazhdoni në këtë rrugë. Është fjala për Këshillin për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, e të cilët nuk e keni lehtë, por jam i bindur që me ju do të fitojë e mira.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Haki Demolli e ka fjalën.

HAKI DEMOLLI: Faleminderit, i nderuari kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës.

Analizimi i Raportit të Avokatit të Popullit për vitin 2011 nxjerr në sipërfaqe ndërhyrjen e Qeverisë së Kosovës në buxhetin e këtij institucioni. Konkretisht, në faqen 135 të raportit, të cilin e theksoi edhe kolegja Vjollca Krasniqi, thuhet: “Ministria e Financave ka bërë ndërhyrje të paautorizuara dhe arbitrare në buxhetin e Institucionit të Avokatit të Popullit, pa paralajmërim dhe konsultim me Avokatin e Popullit”. Me gjithë pranimin e gabimit dhe premtimin për kthimin e buxhetit “të ngrirë” nga Ministria e Financave, kthimi i mjeteve “të ngrira” nuk është bërë. Madje, kjo nuk është bërë as pas kërkesës me shkrim në dhjetor të vitit 2011.

Në raport vlerësohet se një veprim i tillë dëshmon për ndërhyrjen arbitrare, kundërkushtetuese dhe të kundërligjshme të Ministrisë së Financave në buxhetin e Institucionit të Avokatit të Popullit.

E veçova këtë moment, sepse kemi një ndërhyrje arbitrare të Qeverisë në buxhetin e Institucionit të Avokatit të Popullit, i cili institucion mision të vetin kushtetues e ka mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të personave fizikë dhe juridikë nga veprimet apo mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike në Republikën e Kosovës.

Veprimi i këtillë i Qeverisë shtron vetvetiu këto dy dilema:

1. Se nëse kjo Qeveri ndërhyr në mënyrë arbitrare ndaj institucionit, që duhet t'i mbrojë të drejtat dhe liritë themelore të të tjerëve, atëherë si vepron ndaj individëve dhe institucioneve që nuk kanë kompetenca të tilla, dhe

2. Dilema tjetër është se nëse nga veprimet arbitrare të kësaj Qeverie nuk mund të mbrohet Avokati i Popullit, atëherë si mund të mbrohen qytetarët, shoqëria civile, e besa edhe partitë politike opozitare, të cilat nuk disponojnë me mekanizma mbrojtës, të cilat, sipas Kushtetutës, i gëzon Avokati i Popullit.

Çështja tjetër, që do ta theksoja nga ky raport, janë shpenzimet komunale të Institucionit të Avokatit të Popullit. Nga raporti shihet se ky institucion, në vitin 2011, në emër të shpenzimeve komunale, në të cilat përfshihen: shpenzimet për rrymë elektrike, telefonua fikse dhe shërbimet për mbeturina, ka harxhuar gjithsej 12 525 euro, që në krahasim me vitin 2009, kur shpenzimet ishin 23 971 euro, është për afro 90% më e vogël.

Sipas raportit, kjo rënie e shpenzimeve komunale është pasojë e procesit të kursimit të rrymës dhe politikave të Institucionit të Avokatit të Popullit për kufizimin e komunikimit nëpërmjet rrjetit të telefonisë fikse, duke u dhënë përparësi formave të komunikimit më të lirë.

Për mua, një veprim i këtillë praktik, me të cilin kursehen shpenzimet e të hollave buxhetore është befasesh, por është edhe inkurajues. Andaj, e shfrytëzoj rastin që të kërkoj prej Kabinetit qeveritar, konkretisht ministrave, që t'i analizojnë shpenzimet komunale në ministritë e tyre dhe të gjejnë mekanizma, përkatësisht të zbatojnë politika më të përshtatshme për zvogëlimin e shpenzimeve në përgjithësi dhe të atyre komunale, në veçanti. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Osmani.

VJOSA OSMANI: Faleminderit, kryesues!

Unë sot lidhur me këtë raport nuk do të flas për buxhetin, apo për çështje të organizimit, apo të ndërtesës, me gjithë shqetësimet që i paraqitën kolegët, që besoj janë të drejta dhe po ashtu u përmendën edhe nga vetë Ombudspersoni. Do të ndalem te mesazhi alarmues, që e dha vetë këtu Avokati i Popullit lidhur me shkeljen drastike të të drejtave të njeriut dhe rastet kur qytetarët e marrin drejtësinë në duart e veta, çdo ditë e më shumë, sepse besoj që një praktikë e tillë që po bëhet për faj të institucioneve, që do të duhej ta zbatonin ligjin, po na kthen prapa si shoqëri dhe në vend se të aplikohen normat më përparimtare të demokracisë dhe standardet evropiane për të drejtat e njeriut, ne po kthehemi në kohë të kanuneve e të rregullave, që kanë ekzistuar kur nuk ka pasur institucione.

Ajo që duhet ta shqetësojë edhe këtë Kuvend dhe Kosovën, në përgjithësi, është dallimi ndërmjet të fjalëve, që i tha sot Avokati i Popullit, sa i përket gjendjes së të drejtave të njeriut dhe raporteve, që i kanë përgatitur ministritë e caktuara lidhur me po gjendjen e të drejtave të njeriut, që janë dërguar në Bruksel lidhur me studimin e fizibilitetit. Sot, Avokati i Popullit na paraqiti një gjendje alarmante në të gjitha fushat, që lidhet jo vetëm me të drejtat e njeriut, që bien në kategorinë e standardeve evropiane, por lidhen edhe me kriteret politike, edhe me kriteret ekonomike.

Pra, çdo kriter do të vlerësohet në studimin e fizibilitetit. Moszbatimi apo injorimi i vendimeve nga institucionet përkatëse, që nga vetë Avokati i Popullit, edhe në takimin, që e kemi pasur si Komision për Integritet Evropian, e ka vërtetuar, janë gjykatat nën 1 dhe Qeveria e Kosovës nën 2, paraqet alarmin kryesor për këtë Kuvend, sepse derisa Gjyqësori nuk e kryen punën e vet, ne do të kemi raste kur njerëzit vriten në rrugë. Mos ta harrojmë askush dhe në qoftë se të tjerët e harrojnë, ne si Kuvend nuk duhet ta harrojmë rastin e Diana Kastratit, që është dështim total i Gjyqësorit kosovar dhe dështim total i institucioneve, në përgjithësi. Me gjithë të drejtat ligjore që u jepen qytetarëve, ato nuk u zbatuan dhe me gjithë thirrjet e një vajze, së cilës i shkeleshin të drejtat çdo ditë, ajo përfundoi e vrarë nga burri i saj, pikërisht për fajin e Gjyqësorit.

Raporti i Progresit thekson që zbatimi i këtyre vendimeve kërkon përkrahjen e drejtpërdrejtë të Zyrës së Kryeministrit. Pra, në qoftë se dikush pyet se kush e ka fajin që këto vendime nuk po zbatohen, Raporti i Progresit i vitit 2011 shumë qartë tregon që moszbatimi i tyre është për shkak të mungesës së përkrahjes së Zyrës së Kryeministrit.

Ne shpresojmë shumë që ngritja e zërit e Avokatit të Popullit nuk do të bëhet vetëm një herë në vit. Unë nuk dua ta fajësoj këtu këtë institucion, sepse ndodh që ka qenë për shkak të mospranisë në publik, mirëpo një thirrje shumë qëllimshme natyrisht dua t'ua bëj edhe medie, që çdoherë kur ky institucion flet për shkelje të lirive dhe të të drejtave të njeriut, ajo të pasqyrohet në mënyrën sa më të mirë të mundshme.

Kemi pasur raste të shumta, siç u tha, të largimeve nga puna për motive politike, pastaj konkurse që zgjasin më gjatë se një vit, ku kemi rreth 600 veta që kanë konkurruar, për shembull, në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe kjo është shumë e qartë. Edhe sipas dispozitave të ligjeve në fuqi, konsiderohet shkelje e të drejtave të njeriut. Kemi raste të dhunës në familje, kur shumë rrallë i dëgjojmë institucionet duke folur. Kemi raste të shkeljes së të drejtave elementare të qytetarëve në veri.

Dhe, kjo është thirrja kryesore që unë dua t'ia bëj këtij institucioni, sepse përderisa qytetarët e vendeve të tjera kanë mundësi të shkojnë dhe të ankohen te Avokati i Popullit, janë qytetarët shqiptarë në veri, që as nuk mund ta bëjnë këtë, që përderisa të drejtat e tyre shkelen para syve tanë, ne nuk mund të shkojmë dhe t'u ndihmojmë atyre. Është institucioni i Avokatit të Popullit si shpresa e fundit, që duhet të flasë sa më shumë në emër të këtyre qytetarëve, që çdo ditë u shkelet liria e lëvizjes, e drejta në shkollë, madje edhe e drejta në jetë.

Prandaj, duke pasur parasysh gjithë këtë mesazh alarmues, është shumë me rëndësi, në mënyrë që studimi i fizibilitetit, që do të publikohet në tetor, të jetë pozitiv për Kosovën, mirëpo jo duke paraqitur përgjigje të ministrave, të cilat thonë që gjendja e lirive dhe të drejtave të njeriut po lulëzon në Kosovë dhe ka përparime, por gjithnjë duke e paraqitur realitetin, ashtu siç e tha sot Avokati i Popullit.

Përderisa e kemi një gjendje të tillë, siç e dëgjuam sot në Kuvendin e Kosovës, kam frikë se ne absolutisht nuk do të ecim përpara në rrugën tonë evropiane, por do të shkojmë vetëm prapa. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Lama e ka fjalën.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryetar!

Nuk do të them shumë gjëra të reja në lidhje me çështjen e Avokatit të Popullit, që siç e dini edhe një vit më parë kemi diskutuar për të njëjtat gjëra.

Vazhdon të mbetet në gjendje shumë alarmante ky institucion, që do të duhej të ishte i pavarur dhe të kujdesej për respektimin e të drejtave të njeriut.

Natyrisht, që unë nuk do të bëj avokatin e Avokatit të Popullit këtu, sepse avokatinë ky institucion duhet ta bëjë vetë dhe presupozohet që ta bëjë edhe avokatinë e qytetarëve të Kosovës, por ajo që dua të them është që tendenca për ta neutralizuar këtë institucion, për ta disiplinuar, është një tendencë shumë e qartë e politikës në Kosovë për ta disiplinuar vetë shoqërinë, në mënyrë që pushteti ta ekzekutojë fuqinë e tij në mënyrë sa më të lehtë.

Duke i neutralizuar ose dobësuar institucionet e pavarura, jo ne, po Qeveria po mundohet ta prodhojë një politikë robotike, ku deputetët vetëm duhet të ngrenë dorën dhe të votojnë, ku askush nuk duhet të mendojë ndryshe nga ata, ku propaganda dhe makineria e propagandës të bëjë shpëlarje të trurit dhe ku vetë shoqëria të kthehet në të tillë, robotike, dhe të reagojë atëherë kur i duhet Qeverisë të reagojë. Dhe, në këtë aspekt e shoh edhe vetë Institucionin e Avokatit të Popullit dhe tentativën për ta vënë nën kontroll.

Mekanizmat, me të cilat vihet nën kontroll është çështja e pagave, për shembull, që u shtrua këtu. Si ka mundësi që ky problem nuk ka gjetur zgjidhje? Ju e dini që këtu i kemi 19 ministri, ministra të cilët kanë rreth 34 a 44 zëvendësministra, të gjithë kanë edhe këshilltarë, edhe shoferë e tjerë, e tjerë. Për të gjitha këto poste, Buxheti i Kosovës ka pasur mundësi të gjejë zgjidhje, ndërkohë për institucionin e Avokatit të Popullit jo. Si shpjegohet kjo? Përgjigja është fare e qartë.

Një çështje tjetër shumë e rëndësishme është jo vetëm pagat, po punonjësit e Institucionit të Avokatit të Popullit nuk kanë asnjë lloj imuniteti për të shkuar në institucione dhe për ta kryer punën e tyre. Ata nuk kanë autoritet për të depërtuar në institucione. Pra, nuk respektohet posti, për të cilin ata paguhen për ta bërë punën e tyre. Dhe, natyrisht që rezultati i punës së tyre nuk mund të jetë konstatim i çështjes së të drejtave të njeriut. Pra, shkelen apo nuk shkelen? Në fakt, Institucioni i Avokatit të Popullit është një institucion, të cilit i shkelen të drejtat e njeriut.

Dua t'ju kujtoj që në Raportin e vjetshëm të Progresit ka pasur vërejtje themelore në lidhje me këtë institucion. Në ndërkohë që notë negative, të jeni absolutisht të bindur, do të marrë Kosova në lidhje me këtë në studimin e fizibiliteti, që pritet të bëhet së shpejti për Kosovën.

Prandaj, vetëm me një debat, siç mund të jetë ky i sotmi, nuk mendoj se zgjidhen këto probleme. Është mirë që të debatohet, mirëpo është mirë që Kuvendi, i cili e ka themeluar këtë institucion të merret seriozisht. Ne e kemi ngrehur disa herë zërin këtu në Kuvend, në lidhje me këtë institucion, mirëpo Kuvendi i Kosovës, realisht, deri më sot nuk ka

marrë asnjë vendim, asnjë masë në mënyrë që ta përmirësojë gjendjen, në të cilën ndodhet Institucioni i Avokatit të Popullit.

Sigurisht që ky institucion duhet të jetë vetë edhe më i zëshëm, edhe më i fuqishëm dhe të mos pranojë të bëhet pre e këtij lloji disiplinimi, për të cilin fola në fillim, sepse në këtë mënyrë po e prodhojmë një shoqëri të tipit të disa vendeve të ndonjë kontinenti tjetër, ku njerëzit kanë frikë edhe të flasin. Nuk besoj që kjo është ambicia e kësaj shoqërie. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kryeziu e ka fjalën.

EQREM KRYEZIU: Faleminderit, zoti kryesues dhe me lejen tuaj do t'i përshëndetja dhe dy ministrat, që e kanë respektin tim, jo vetëm që janë këtu të pranishëm, po edhe për veprimtarinë e tyre.

Unë personalisht e kam një admirim të veçantë, për si të them - ligjërimin drejtvizor, por, për fat të keq, ligjërimi im shpeshherë nuk mund të jetë i tillë, edhe pse kam simpati të madhe për këtë lloj ligjërimi, kështu që, edhe me rastin e Avokatit të Popullit, unë do të polemizoj larg e larg, jo shumë rreptë me zotëriun e nderuar, profesorin Arsim Bajrami. Ai u ankua pak a shumë që institucionet nuk e përfillin Avokatin e Popullit. Unë nuk po dua të hyj në natyrën e veprimtarisë së Avokatit të Popullit, por të institucioneve legale shtetërore. Do të ishin debate instruktive besoj, kush di, kush di më mirë se unë të flasë për këto gjëra, por, sidoqoftë, e kam një respekt të veçantë për Institucionin e Avokatit të Popullit dhe e pasuron domosdoshmërisht jetën demokratike të secilit vend.

Ndërkaq, në vërejtjen e zotëri Bajramit se nuk përfilllet shumë Avokati i Popullit, unë nuk do të pajtohesha me këtë, sepse nuk po di, do të duhej që të paktën ky Parlament ta ketë memorien që Avokati i Popullit u ankua kundër Ligjit për deputetët dhe Gjykata Kushtetuese e përfilli menjëherë. E tash, shikoni, në qoftë se ne e harrojmë një gjë të tillë, unë me të vërtetë s'po di çfarë po ndodh, ose, unë s'jam normal, ose diçka s'është në rregull. Me të vërtetë, ajo nismë, jo vetëm e Avokatit të Popullit, për të cilin kam respekt personal, dukej e virgjër, e qashtë, e papërlyer, e pafajshme. "Ç"janë, tha, këta deputetë që lypin hala", por cilat janë pasojat e kësaj, zoti kryesues?

Pasojat e kësaj janë se njerëzit e zgjedhur të popullit, duke mos pasur ligj për vete dhe duke mos pasur siguri për bukën e gojës, si njerëz të zgjedhur, ata janë detyruar ta pranojnë dominimin, për të cilin foli zonja Lama. Jo veç të tjerët, por edhe ne këtu, të liderëve tanë politikë, po edhe të korrupsionit. A mund dikush të më thotë, sa për qind e njerëzve që janë në politikë durohen dhe nuk hyjnë në inkriminime për ta siguruar bukën e gojës, që ky Parlament dhe kjo shoqëri i lë të pasigurt njerëzit e zgjedhur të këtij populli.

Dhe, në këtë aspekt, unë qysh e shoh, natyrisht unë s'mund të flas në emër të Avokatit të Popullit, por po të isha unë, larg qoftë Avokat i Popullit, unë do të luftoja patjetër që ky vend ta ketë Ligjin për deputetët, në mënyrë që të mos jenë këta njerëz të korruptuar. Të mos bëjnë kumbari me krimin e organizuar për bukën e gojës, të mos e shesin votën e

vet. Shikoni, pra, pasojat sa dramatike janë. Prej një ideje, që dukej shumë e qashtë, shumë e papërlýere, shumë e pafajshme, bile-bile egalitare.

Unë nuk di a ka në botë ndonjë Parlament, si ky i Kosovës, që nuk ka ligj për deputetë. Në qoftë se ju do të më thoni se ndoshta Sudani Jugor ende nuk e ka, unë nuk e di a ka pasur, se Sudani Jugor tash frik është pavarësuar i gjori, por unë do të pajtohesha me ju që nuk e paska, veç atëherë do të konkludojmë se ne jemi vendi i parafundit afrikan i Evropës, që nuk e ka një ligj të tillë.

Sa i përket raportit të ligjit dhe sundimit të ligjit, unë po e shoh brengën e të gjithë njerëzve të vullnetit të mirë, madje edhe në Parlament, por a e shihni se si ngatërrohen punët, ku faktikisht kjo shoqëri kënaqet që Parlamenti nuk e ka ligjin e vet për deputetët. Në këtë mënyrë, ne po e përsëritim të vërtetën, për ne absolute, që 400 vjet më parë Frensis Bejk e tha. Ligji, tha ai, është si rrjeti i merimangës, i ndal mushkonjat, por jo zoçkat e mëdha, që fluturojnë dhe e shkatërrojnë rrjetin e merimangës.

Duke mos e pasur këtë ligj, zonja të nderuara dhe zotërinj, domosdo që ne kemi për ta përsëritur dhe jemi në situatën e 400 vjetëve më parë, kur një njeri i urtë, Frensis Bejkën, e tha këtë çështje në raport me shoqërinë dhe sundimin e ligjit. Por, unë jam më se i ngushëlluar, se zotëri Zemaj ka dhënë garanci të forta, se është në proces e sipër duke punuar, që më në fund të hiqemi nga lista e vendeve shumë të rralla në botë, po them ndoshta i parafundit i Afrikës, që nuk e ka një ligj për deputetët dhe, detyrimisht, që e detyron secilin deputet të kalkulojë këtu, sa më i dëgjueshëm të bëhet ndaj liderit politik, ose ndaj atyre, që kanë para. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Deshishku e ka fjalën.

HASHIM DESHISHKU: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar ministra, edhe pse i kemi të pranishëm vetëm dy ministra, si zakonisht!

Të nderuar deputetë dhe deputete,

Unë do ta shkurttoj fjalimin tim, për arsye se shumë gjëra u thanë këtu nga deputetë paraprakisht.

Pas shfletimit të raportit të Avokatit të Popullit krijohet përshtypja se ai mbetet i vetmi institucion, të cilit ende i beson populli. Ai ende ka shpresë se nëpërmjet tij do ta realizojë të drejtën, të cilën, sipas ankuesve, shteti ia ka uzurpuar. Kjo vërehet kur kemi parasysh numrin e përgjithshëm të ankesave të qytetarëve, ku janë 1 453 sosh, ku palët përgjegjëse, sipas rasteve të hetuara, kryesisht janë gjykatat, ministrinë dhe komunat.

Nga raporti, i cili kërkon shumë kohë që të analizohet dhe të përpunohet, duket qartë se Avokati i Popullit ka bërë përpjekje që t'i mbulojë të gjitha fushat, për të cilat ka përgjegjësi. Por, njëherësh janë edhe pikat më të ndjeshme për qytetarët. Është fjala për raportin e tyre me institucionet e pushtetit, ku në të shumtën e rasteve të drejtat e tyre nëpërkëmben dhe ato janë të pafuqishme për ndërmarrjen e veprimeve të duhura. Mirëpo, nga raporti del edhe një konstatim, i cili tregon për situatën alarmante në këtë fushë.

Duket se Institucioni i Avokatit të Popullit qëllimisht është injoruar nga organet e pushtetit. Ndoshta, pikërisht për faktin se ai po i nxjerr shumë parregullsi, që kanë të bëjnë në raport me popullatën. Prandaj, ky institucion nuk gëzon përkrahje dhe duket se ai ekziston vetëm sa për ta kompletuar mozaikun e ndërtimit institucional të Kosovës, e jo për t'i kryer punët, që ka në përgjegjësi, e që janë tejet të ndjeshme. Në këtë punë ai është i penguar, Për këtë, raporti ofron shumë fakte. Po i numëroj vetëm disa prej tyre. Nën 1, Institucioni i Avokatit të Popullit ende nuk është i kompletuar me numër të mjaftueshëm të punëtorëve, pikërisht për shkak të mungesës së përkrahjes nga Qeveria e Kosovës, përkatësisht për shkak të shkurtimeve buxhetore, që i bëhen atij. Në vitin 2011 i janë lejuar vetëm 629 000 euro, nga 1 500 000 të kërkuara nga ky institucion.

Për më keq, kjo shumë i është aprovuar buxhetit, pa dhënë mundësinë që zyrtarët e këtij institucioni ta paraqesin mundësinë e arsyetimin e kërkesës, apo së paku të jenë të konsultuar për shkurtimin e buxhetit.

Megjithëse këtu u përmend shumë herë që 13 000 euro ua ka marrë Ministria e Financave, unë nuk do ta arsyetoja këtë për arsye se ministria nuk i ka kthyer përgjigje se për çfarë arsye i ka tërhequr.

Janë këto vetëm disa prej rasteve, që tregojnë qartë se Institucioni i Avokatit të Popullit nuk ka përkrahje institucionale, madje as nga Kuvendi i Kosovës, i cili është themelues i tij.

Qeveria e Kosovës, më saktësisht Ministria e Financave, duke ndërhyrë në mënyrë arbitrare në buxhetin e këtij institucioni, në mënyrë të vrazhdë e cenon pavarësinë dhe integritetin e IAP-it, domethënë të Institucionit të Avokatit të Popullit. Kjo mënyrë e sjelljes ndaj këtij institucioni është shqetësuese, meqenëse lëndimi i pavarësisë dhe integritetit drejtpërdrejt i dëmton të gjithë qytetarët e Kosovës. Qytetarët te avokati e shohin të vetmen mundësi që të krijojnë mbrojtje nga parregullsitë dhe arbitrariteti i institucioneve të pushtetit. Ndoshta, qëllimi i Qeverisë së Kosovës, që nëpërmjet këtyre ndërhyrjeve të paligjshme, ta bllokojë dhe ta pamundësojë punën e Avokatit të Popullit, qasja e tillë ndaj këtij institucioni tregon qartë se po bën përpjekje që t'i bllokojë të gjitha mundësitë, që qytetarët t'i realizojnë të drejtat e tyre përballë institucioneve të pushtetit. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti ministër Hamzaj e ka kërkuar fjalën për replikë.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti kryesues!

Prapë po përkufizohen vetëm në çështjet financiare. Institucioni i Avokatit të Popullit nuk është ndonjë organizatë buxhetore, që e rrezikon qëndrueshmërinë makrofiskale të vendit. Është e vërtetë se në fillim dhe në bartje të kompetencave nga institucionet ndërkombëtare te institucionet vendore, pasi që shumë veprime janë kryer pas proceseve të rregullta buxhetore, ka pasur problem jo me masën e parave, po me akomodimin e atyre pozitive brenda listës së pagave në Ministrinë e Administratës Publike.

Ministria e Financave çdoherë e ka të drejtën nëse në bazë të ligjeve në fuqi vëren që ka ndonjë tepricë, në procedurë t'i bëjë veprimet e caktuara. Po, për informatën tuaj deputetë të nderuar, ky institucion nuk është i diskriminuar negativisht, sa i përket çështjes së pagave, po ua jap disa shënime:

Drejtori ekzekutiv, pagën mujore e ka 961 euro, për një zyrtar financiar, udhëheqës i Zyrës së Buxhetit dhe të Financave, paga del diku te 650 euro, prandaj ju lutem mos ta konsiderojmë ndërhyrje. Unë edhe gjatë rishikimit të buxhetit 2012 i kam marrë në konsideratë të gjitha kërkesat, të cilat kanë qenë të arsyetuara të Institucioni i Avokatit të Popullit. Dhe, Institucioni i Avokatit të Popullit ka ardhur dhe ka folur në Komisionin për Buxhet dhe Financa për kërkesat, të cilat i ka pasur të plotësuara nga Ministria e Financave.

Prandaj, pavarësia e një institucioni për ta kryer punën e tij, që të gjithë po angazhohemi, të gjithë po pajtohemi, nuk nënkupton të drejtën të mos i zbatojë rregullat sa i përket menaxhimit të financave publike. Edhe për llogaridhënie, edhe për transparencë dhe për të gjitha çështjet. Këtu është kërkesë e Institucionit të Avokatit të Popullit. Thotë: Paga dhe mirëqenie për shërbyes civilë, brenda institucioneve të Kosovës, për të cilët po flasim. Të dhënat po thonë që nuk janë të diskriminuar, apo po thonë që janë të diskriminuar pozitivisht, që ne nuk e kemi kontestuar. Është organizatë e vogël buxhetore, kemi dashur ta përkrahim dhe po siguroj, që edhe në buxhetin e vitit 2013, Institucioni i Avokatit të Popullit do t'i ketë të plotësuara kërkesat, që i ka të arsyetuara. Mirëpo, duhet të vijë për dëgjime buxhetore në Ministrinë e Financave. Ne nuk do të propozojmë buxhet paushall. Unë kam parë, edhe ju e keni parë, që ka staf civil brenda Institucionit të Avokatit të Popullit, pa e ditur hierarkinë. Ne, me gjithë respektin për secilin, duhet t'u drejtohet kryetarit të Kuvendit, kryeministrit dhe ministrit të Financave. Po, të paktën, kërkesën le ta drejtojë nëpërmjet Avokatit të Popullit dhe institucionit, që mund t'u drejtohet këtyre institucioneve.

Prandaj, Ministria e Financave sigurisht do t'i marrë në konsideratë të gjitha kërkesat e arsyeshme. Mirëpo, kërkesat e paarsyetuara edhe nëse nuk i përgjigjen...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Konstatoj që debati është ezauruar. Vazhdojmë me votimin e Raportit vjetor të Avokatit të Popullit për vitin 2011. Konstatoj që në sallë janë të pranishëm 67 deputetë, 69 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Faleminderit! Konstatoj se me 66 vota për dhe 1 abstenim, asnjë kundër, Kuvendi e miratoi Raportin vjetor të Avokatit të Popullit për vitin 2011.

Doni të marrim pauzë, apo ta vazhdojmë? Atëherë, marrim pauzë deri në orën 14:30.

* * *

(Pas pauzës, seanca plenare i vazhdoi punimet.)

KRYESUESI: Të nderuara deputete, të nderuar deputetë, vazhdojmë me pikën e 5-të të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2011

Komisioni Funkcional për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar Raportin vjetor të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2011 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim. Gjithashtu, edhe Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e ka shqyrtuar Raportin vjetor dhe pasqyrat e audituara financiare të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2011 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

E ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional, deputeten Hadërgjonaj, për arsyetimin e raportit me rekomandime.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më 10 korrik 2012, e ka shqyrtuar Raportin e Bankës Qendrore për vitin 2011 dhe ka vlerësuar se ai e prezanton një përmbledhje për gjendjen e ekonomisë në vend dhe parashikimet në vitet në vijim, arritjen e objektivave të politikave të Bankës Qendrore të Kosovës dhe gjendjen e sistemit financiar të Kosovës. Raporti si i tillë reflekton aktivitete të Bordit të Bankës Qendrore të Kosovës, të Bordit Ekzekutiv dhe të stafit të Bankës Qendrore të Kosovës mbi zhvillimet më të rëndësishme në ekonominë e Kosovës, duke pasur në fokus zhvillimet në sektorin financiar për vitin 2011.

Në bazë të raportit shihet se gjatë vitit 2011, ekonomia e Kosovës ka pasur rritje prej 5% të bruto-produktit vendor, e cila në krahasim me vendet e rajonit është më e lartë, me gjithë problemet që ka shkaktuar kriza globale dhe veçanërisht ajo e euro-zonës. Ndër komponentët kryesorë, që reflektojnë në rritjen ekonomike, ishte rritja e konsumit, rritja e investimeve private dhe publike, të nxitura prej rritjes së kredithënies dhe aktiviteteve të sistemit bankar, rritja e dërgesave të emigrantëve, në vlerë absolute prej 585 milionë eurove, investimet e huaja direkte me një rritje prej 14,5%, apo 414 milionë euro, rritja e investimeve publike dhe rritja e eksporteve dhe importeve.

Sektori i sistemit financiar, sipas raportit që na ka ofruar Banka Qendrore, vazhdon të jetë i qëndrueshëm.

Asetet e sektorit financiar kanë arritur deri në 3,5 miliardë euro në fund të vitit 2011, që është 9% rritje vjetore. Ndërkaq, asetet e sektorit bankar kanë arritur në rreth 2,65 miliardë euro.

Sektori financiar dominohet kryesisht nga sistemi bankar, me rreth 76% të aseteve të sektorit financiar.

Sa u përket kredive, në vitin 2011 ka pasur rritje prej 16%, kurse struktura e kredive nuk ka ndryshuar shumë. Në krahasim me të kaluarën, ende vazhdon të jetë diku 70% për ndërmarrje, ndërsa 30% për ekonomitë familjare.

Në aspektin sektorial nuk ka pasur ndonjë ndryshim të madh të kreditimit, ndërsa në aspektin e maturimit vërehet një performansë e mirë.

Depozitat në sistemin bankar në vitin 2011 arritën vlerën 2,1 miliardë, që paraqet rritje vjetore 8,5%.

Norma e interesit vazhdon të mbetet e lartë, me një rënie të lehtë dhe sugjerimet e anëtarëve të komisionit ishin që Banka Qendrore dhe Qeveria, me gjithë mungesën e mekanizmit direkt për të ndikuar në normat e interesit për shkak të mungesës së valutës nacionale, duhet të përpiqet që të ndikojnë në rritjen e ofertës bankare, ta rritin konkurrencën, që do të mund të ndikonte në uljen e normave të interesit, në mënyrë që të ketë investime në punësim dhe në sektorin real, që do të prodhonin mallra dhe shërbime, që do të mund ta përmirësonin gjendjen në sektorin e jashtëm, si dhe të mbështeten disa vija kreditore, që janë specifike për zhvillimin e industrisë dhe të prodhimit me vlerë.

Sa i përket performansës së sektorit bankar, është ruajtur profitabiliteti dhe është realizuar një profit prej 37 milionë eurove, pra me një rritje vjetore prej 12,8%.

Sistemi bankar në Kosovë mbetet ende një vend që ka kredi joperformuese më të mira në regjion. Domethënë, kreditë joperformuese janë në nivel dhe kështu, duke pasur parasysh qëndrueshmërinë e sektorit financiar, si dhe parashikimet për normën pozitive të rritjes ekonomike, le të besohet se edhe në vitin 2012 stabiliteti financiar do të vazhdojë të jetë i fuqishëm dhe do të jetë një kontribuues i rëndësishëm i stabilitetit makrofinanciar në vend.

Ndër problemet kryesore, me të cilat është ballafaquar ekonomia e Kosovës në periudhën raportuese janë papunësia e lartë, mungesa e kapaciteteve ekonomike për ta absorbuar fuqinë e re punëtore, si dhe presionet inflacioniste, që u karakterizuan me një normë të inflacionit prej 7,3%.

Mbështetja e lartë e ekonomisë në importe ndikoi negativisht në normën e rritjes dhe deficitin në llogaritë rrjedhëse. Mbulueshmëria e importit me eksport është vetëm 12,6%. Kështu që sektori i jashtëm mbetet sfidë për ekonominë e vendit.

Nga raportimi i vitit 2011 shohim se ka pasur të arritura në Bankën Qendrore dhe, në përgjithësi, në Kosovë është bërë një ruajtje e madhe e stabilitetit financiar, që ka rezultuar edhe me nënshkrimin e marrëveshjes me Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Themelimi i fondit për sigurimin e depozitave, themelimi i byrosë kosovare të sigurimit, si dhe kompletimi i platformës për tregtimin elektronik të letrave me vlerë të Qeverisë së Republikës së Kosovës janë ndër arritjet kryesore për vitin 2011 në sektorin financiar.

Gjithashtu, pozitiv duhet vlerësuar edhe rolin dhe kontributin e Bankës Qendrore në hartimin e disa ligjeve në fushën financiare, që janë miratuar nga Kuvendi, si dhe ngritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe profesionalizmit të stafit, për çfarë edhe janë shpërblyer me çmime ndërkombëtare dhe disa prej tyre ofrojnë edhe ekspertizë në fushën e statistikave, në emër të Fondit Monetar Ndërkombëtar në vendet tjera.

Meqenëse raporti vjetor i Bankës Qendrore për vitin 2011 është gjithëpërfshirës dhe përmbush kushtet ligjore për raportim, komisioni i ka rekomanduar Kuvendit ta miratojë atë si të tillë.

KRYESUESI: Faleminderit! Radhën e ka kryetari i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, zoti Sadriu, që ta arsyetojë raportin me rekomandime.

ALI SADRIU: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Përshëndetje për ministrin!

Deputetë, kolegë,

Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike i ka shqyrtuar pasqyrat financiare të audituara të Bankës Qendrore nga një kompani e jashtme, përzgjedhjen e së cilës e ka bërë vetë ajo. Sipas dispozitave ligjore në fuqi, Banka Qendrore është e autorizuar të bëjë vetë përzgjedhjen e auditorit, gjë që mendojmë se nuk është krejt në rregull.

Sa i përket formës së tabelave të prezantuara, ato janë të prezantuara drejt dhe Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike, në bazë të radhitjes dhe prezantimit të tyre, konstaton se nuk ka parregullsi. Por, unë kam vërejtje dhe e kam bindjen që Kuvendi duhet të kërkojë nga Banka Qendrore që guvernatorit vetë ta bëjë prezantimin këtu.

Ne më herët i dhamë hapësirë Avokatit të Popullit ta bëjë prezantimin e raportit. Mendoj se nuk ka raport më të vlefshëm e më përmbajtësor se ky, andaj edhe ai është dashur ta prezantojë këtu. Sigurisht, nuk është ftuar! Se, e di që edhe vitin e kaluar ka ndodhur kështu, por mendoj se kjo praktikë nuk është e mirë.

Unë mendoj se sa i përket performansës së punës së Bankës Qendrore, kemi shumëçka të themi dhe mendoj se duhet t'i jepet hapësira Kuvendit dhe delegatëve që në mënyrë të detajuar të bisedohet për të gjitha format e performansës, që mund të jenë më të mira.

E kam bindjen personale se nuk e kemi performansën më të mirë, jo me fajin e menaxhmentit apo të punëtorëve, por për fajin e dispozitave ligjore, që e kornizojnë veprimtarinë e asaj banke tej mase. Dhe, realisht, efektet për ekonominë e Kosovës janë tepër minimale. Ne jemi dëshmitarë për çdo natë të reklamimit të kompanive, të cilat bëjnë tërheqjen e depozitave të njerëzve tanë, që u janë plaçkitur më herët. Ato kanë mundur dhe Banka Qendrore mund ta sistemojë atë çështje, sepse ato tërheqje bëhen pikërisht nga banka, që sot në një mënyrë a formë tjetër, kanë veprimtari legale, nuk po flas për bankat ilegale, sepse ato janë objekt i hulumtimit të tyre dhe kanë pasur disa rezultate. Do të thosha se ka hapësirë edhe më tutje për t'i ndjekur, se ato ekzistojnë në Kosovë, por veprimtaritë legale të bankave, që janë në Kosovë, e të cilat janë licencuar,

kanë mundur të kushtëzohen që ata qytetarë të mos paguajnë deri në 40% nga depozitat e veta për kompaninë, e cila ua bën tërheqjen.

Ka edhe shumë e shumë të tjera, që i përmendi kolegia, kryetarja e Komisionit për Buxhet dhe Financa, prandaj mendoj se po të shtrohet një çështje e tillë dhe të bisedohet, do t'i ndihmojmë bankës, por mbi të gjitha Kuvendi do ta hedhë në tavolinë nevojën për ndryshimin e atyre kornizave, që tejskajshëm e limitojnë veprimtarinë e Bankës Qendrore. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Radha është e përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Zonja Krasniqi, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.

HASIME KRASNIQI: Faleminderit zoti nënkryetar i Kuvendit!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar dhe analizuar Raportin vjetor të Bankës Qendrore për vitin 2011 dhe konsiderojmë që është një raport gjithëpërfshirës, i cili pasqyron në mënyrë të detajuar zhvillimet ekonomike e financiare në vend, si dhe aktivitetin e Bankës Qendrore gjatë vitit 2011.

Në raport është pasqyruar qartë performansa pozitive e ekonomisë së Kosovës gjatë vitit 2011, e cila, e me gjithë kushtet e vështira me të cilat është ballafaquar ekonomia globale, ka arritur ta ruajë trendin pozitiv të rritjes, madje duke shënuar një normë vjetore të rritjes prej 5%, që Kosovën e vë në vendin me normën më të lartë të rritjes në rajon.

Raporti e thekson rolin e sektorit privat në këtë rritje ekonomike dhe po ashtu e thekson rolin e rëndësishëm të investimeve publike në rritjen e aktivitetit të përgjithshëm ekonomik në vend.

Rëndësi e veçantë në këtë raport i është kushtuar sektorit financiar të vendit, ku është inkurajues fakti që Kosova vazhdon ta ketë një sektor financiar stabil dhe në shërbim të ekonomisë së vendit.

Sistemi bankar, që paraqet komponentin kryesor të sektorit financiar të vendit, ka vazhduar të shënojë rritje, si të depozitave, ashtu edhe të kredive dhe në të njëjtën kohë ka vazhduar të ketë nivel të lartë të qëndrueshmërisë.

Në këtë mënyrë, sistemi bankar i vendit ka vazhduar t'i kontribuojë rritjes së aktivitetit dhe po ashtu një stabiliteti ekonomik në vend.

Raporti e shtjellon në mënyrë të hollësishme edhe aktivitetin e vetë Bankës Qendrore gjatë vitit 2011, ku shihet avancimi në të gjitha funksionet që ushtron ky institucion, duke nisur nga mbikëqyrja e institucioneve financiare, administrimi i sistemit të pagesave dhe furnizimi i ekonomisë me para të gatshme, përpilimi i statistikave dhe analizave ekonomike, e deri te menaxhimi i aseteve dhe ofrimi i shërbimeve tjera bankare për institucionet publike të vendit.

Në këtë kontest, duhet theksuar edhe nivelin e lartë të bashkëpunimit të Bankës Qendrore me institucionet tjera shtetërore, të cilat kanë mundësuar forcimin e mëtejme të kapaciteteve për të siguruar rritjen e qëndrueshmërisë dhe efikasitetit të sistemit bankar në vend.

Në fund duhet nënvizuar se Raporti i Auditorit të Jashtëm përmban një opinion të pastër mbi pasqyrat financiare dhe aktivitetin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2011.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e mbështet këtë raport. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i LDK-së, zonja Bajrami e ka fjalën.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryesues!

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë,

LDK-ja nuk e përjashton faktin se Banka Qendrore e Kosovës mund të bëjë edhe më shumë. Por, gjithashtu, e pranon faktin që Banka Qendrore e Kosovës viteve të fundit i ka rritur kapacitetet dhe tani për të punojnë shumë ekspertë të fushës.

Raporti i Bankës Qendrore të Kosovës është një raport i mirë, që e pasqyron realitetin e ekonomisë sonë. Ajo, për të cilën ne shqetësohemi në masë të madhe është neglizhenca totale, që Qeveria i bën këtij raport.

Raporti, të cilin ne po e diskutojmë sot, bile jo vetëm ky, por edhe ai i gjashtëmujorit të fundit, paraqesin diagnozën e saktë të ekonomisë sonë. Raportet e tilla do të duhej të shërbenin si një kampanë për Qeverinë. Qeveria do të duhej të kuptonte se rruga në të cilën ajo e ka shpënë ekonominë mund të quhet gjithçka, pos rrugë për zhvillim. Të gjithë indikatorët, të dalë nga analizat ekonomike, tregojnë për regres. Tregojnë se vendi ynë tashmë në krizë, se po varfërohet edhe më tutje.

Raporti tregon se Kosova në vitin 2011 e ka pasur një rritje prej 5% dhe këtë nuk po e konteston askush, por është mirë që indikatorët e tillë të komentohen në plotësi, duke i shoqëruar me indikatorë të tjerë. Është mirë të themi se bruto-produkti vendor apo GDP-ja për kokë të banorit të Kosovës është sa 10% e GDP-së së vendeve të Evropës, dhe vetëm sa 50% e GDP-së për kokë banori të vendeve fqinja.

Kur komentohet kështu, kjo tregon se ne e kemi një bazë të ulët, e kemi një papunësi të madhe dhe të gjithë e dimë se vetëm për ta absorbuar numrin e të papunëve, që për herë të parë hyjnë në tregun e punës, ne do të duhej të kishim një rritje mbi 6%.

Raporti në mënyrë shumë të qartë thekson edhe disbalance të tjera të ekonomisë sonë, siç është deficit i madh tregtar prej 2,2 miliardë. Ky deficit ka shkuar vazhdimisht duke u rritur.

Deficiti tregtar ka qenë 39% e bruto-produktit vendor në vitin 2009 dhe tani merr pjesë me 43% të bruto-produktit vendor.

Kosova e eksporton gjithë “kesh”-in e saj, duke përfshirë këtu edhe paratë, që vijnë në formë të remitencave nga Diaspora. Ky vend nuk prodhon asgjë, për arsye se i del shumë shtrenjtë dhe nuk ka llogari të prodhojë. Është shumë e rëndësishme gjithashtu edhe përbërja e asaj se çka prodhojmë, si e prodhojmë dhe çka eksportojmë.

Kosova e ka një buxhet të vogël me nevoja të mëdha për investime publike. Gjithashtu, ne e kemi një nevojë shumë të madhe për kredi dhe një ofertë shumë kufizuese. Importi arrin në 63% të bruto-produktit vendor për vitin 2011, ndërsa investimet private janë vetëm 22% e bruto-produktit vendor. Gjatë vitit 2011, u përmend edhe më herët, si dukuri shqetësuese ka qenë inflacioni prej 7,3%, derisa ky inflacion në vendet e rajonit dhe vendet fqinja ka qenë 3-4%.

Raporti gjithashtu ka theksuar se deficiti buxhetor, nga 93,3 milionë, në vitin 2010, ka rënë në 84,5 milionë në vitin 2011, e kjo më së shumti i atribuohet mosrealizimit të shpenzimeve, apo realizimit të buxhetit në masën vetëm 91,9%.

Një çështje tjetër është pjesëmarrja shumë e vogël e të hyrave buxhetore në raport me bruto-produktin vendor, që është 27,7%. Në të gjitha vendet e rajonit, kjo arrin shumën prej 37%.

Shqetësim tjetër është se të gjitha të hyrat po mblidhen në kufi. Rreth 63,4% ose 826 milionë euro, e prej tyre vetëm në emër të TVSH-së mblidhen 418 milionë euro, dukuri kjo tepër shqetësuese, sepse kemi një rritje prej 16,1% të të hyrave në kufi, çka do të thotë se ne heqim gjysmë miliard euro në vit prej qarkullimit të bizneseve, duke e inkasuar TVSH-në në kufi, pa marrë parasysh se ku realizohen ato mallra kur hyjnë në territorin e Kosovës.

Raporti, gjithashtu cek se në Kosovë ka 325 261 punëkërkues të regjistruar dhe gjithashtu e thekson si fakt shqetësues që anketa e papunësisë nuk është bërë që nga viti 2009. Ajo çka ceket në raport është se buxheti për pensionet bazë ka rënë nga 95 milionë, sa ishte në vitin 2010, në 93,5 milionë, në vitin 2011, pavarësisht asaj se në buxhetin e vitit 2011 kemi planifikuar një rritje të pensioneve bazë.

Derisa situatën në sektorin bankar, u tha edhe më herët, e kemi pak më ndryshe. Do të thotë, sektori financiar gjendet në pozitë më të mirë. Asetet financiare kanë pësuar një rritje gjatë vitit të kaluar për 9,3%. Kreditë janë rritur me 16,4%, ku 1,7 miliard janë kredi dhe 2,1 miliardë janë depozita. Kreditë joperformuese janë gjithashtu më të ulëta në rajon dhe kanë pësuar rënie nga viti 2010, do të thotë kreditë e këqija kanë qenë 5,9%, në vitin 2011 i kemi 5,7%, edhe pse në raportin 6-mujor të Bankës Qendrore ato janë rritur në 6,5%.

Megjithatë, kamatat janë shumë të larta dhe sillen rreth 14%.

Para se të lavdërohem për situatën e sektorit bankar, duhet të parashtrojmë disa pyetje. Nëse bankat i kanë punët shumë mirë, cili është ndikimi i këtyre të fundit në zhvillimin e sektorit privat. Bankat nuk mund të konsiderohen si promotor të zhvillimit, nëse krejt aktiviteti i tyre kufizohet në rritjen e aseteve dhe fitimin e tyre. Bankat duhet ta ndihmojnë zhvillimin duke kredituar sektorë të tjerë me kamata të arsyeshme e kushte, që kushtimisht do të plotësoheshin nga ata që kërkojnë kredi.

Sektori i bujqësisë pothuaj i ka të paarrtshme kreditë. E para, asnjëherë nuk mund t'i plotësojë kushtet e bankave në terma të kolateralit dhe dokumenteve të tjera, dhe e dyta, kamatat janë aq të larta sa askush nuk ka llogari që të merret me bujqësi, nëse aktivitetet e veta i financon me kredi, sepse do të punonte vetëm për kamatën e bankës.

Për këtë arsye, pjesëmarrja e kredive për bujqësi për vitin 2011 është shumë e vogël, 3,5%. Ne do ta inkurajonim Bankën Qendrore të Kosovës që të punojë brenda kapaciteteve të veta, ta inkurajojë konkurrencën në sektorin bankar, në mënyrë që kamatat të ulen në presionin e konkurrencës, ose të ndërmerren masa të tjera të parapara me ligj. Pra, ne do ta përkrahim Raportin e Bankës Qendrore të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, deputetja Fetoshi!

ALBANA FETOSHI: Faleminderit, kryetar!

Në përgjithësi, Raporti vjetor i BQK-së për vitin 2011 është kualitativ në aspektin teknik. Aty, në mënyrë të detajuar paraqitet puna e BQK-së gjatë vitit 2011 dhe njëherësh edhe performansa e sektorit bankar, pensional, të sigurimeve dhe atij të këmbimit valutor.

Megjithatë, kjo nuk nënkupton se ne jemi të kënaqur me punën që ka bërë BQK-ja gjatë këtij viti. Me gjithë përmirësimet evidente në raport, në vitin 2010, ende vërehen dobësi në implementimin e obligimeve të BQK-së karshi sistemit financiar të vendit.

Ne, për shembull, nuk jemi aspak të kënaqur me performansën e Trustit Pensional, i cili edhe gjatë këtij viti ka regjistruar humbje shumë të mëdha në investimet me ekuitete.

Po të mos ishin të hyrat nga investimet në letra me vlerë të indeksuara, në total, trusti do të kishte operuar me rreth 9 milionë humbje.

Njësoj jemi të pakënaqur edhe me rezultatet e mbikëqyrjes së kompanive të sigurimeve. Është fakt se gjatë këtij viti është krijuar Byroja Kosovare e Sigurimit, por as edhe deri më sot nuk e kemi regjistruar as suksesin më të vogël të kësaj byroje në avancimin e interesave të të siguruarve.

Nuk kemi ende anëtarësim në kartonin e gjelbër, e ç'është më e keqja, bashkatdhetarët tanë vazhdojnë të plaçkiten në kufi nga këto kompani të sigurimeve.

Sa i përket sistemit bankar të vendit, është fakt se për momentin sektori reflekton stabilitet. Por, fatkeqësisht, ky stabilitet është arritur me norma shumë të larta të interesit dhe me dominim të sistemit nga dy banka me kapital të huaj.

Gjithashtu, në bazë të raportit, shohim edhe një rritje të vogël të kredive të këqija. Ndërkaq te portfolio, edhe më tej vërehet dominim i kredive për sektorin e tregtisë dhe atë të ekonomive familjare, ndërsa kreditë për prodhimtari dhe bujqësi mbeten ende marginale.

Nga të dhënat e prezantuara vërehet se në raport me vitin paraprak, BQK-ja ka regjistruar një përgjysmim të fitimeve të saj dhe atë nga 3 milionë euro në vetëm 1,5 milion. Shkaku kryesor del të jetë pagesa shumë e lartë e interesave, shpenzime këto që arrijnë në 7,5 milionë euro, apo tri herë më shumë se në vitin 2010. Do të ishte me interes për qytetarët e vendit që të kemi më shumë informacione për pozicionet në të cilat janë derdhur këto mjete.

Si përfundim, Lëvizja “Vetëvendosje” do ta votojë Raportin e BQK-së. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, fjalën e ka zoti Neziraj.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit, i nderuar zoti nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka shqyrtuar Raportin e Bankës Qendrore dhe mund të themi lirisht se është një prej raporteve të mira që Banka Qendrore e ka sjellë në këtë Kuvend dhe në të pasqyron në mënyrë shumë reale çështjet financiare dhe ekonomike, edhe të vendeve në rajon, edhe në Evropë, por edhe na furnizon me mjaft të dhëna edhe për sistemin financiar dhe ekonomik të Kosovës.

Në bazë të këtij raporti, thuhet se norma e rritjes ekonomike të bruto-produktit është 5%, fakt ky që gëzon, edhe pse ende e kemi një shkallë të lartë të papunësisë, mirëpo në rritjen ekonomike kryesisht ka ndikuar konsumi i brendshëm, kanë ndikuar investimet private, kanë ndikuar edhe dërgesat, do të thotë remitancat gjithashtu, edhe investimet e huaja dhe si rezultat i kësaj kemi rritje ekonomike. Mjerisht, të gjithë do të kishim dëshiruar që të ketë një rritje më të madhe ekonomike, me qëllim të absorbimit të një numri më të madh të papunëve, mirëpo për momentin ekonomia është e tillë.

Një fakt shqetësues është edhe raporti ndërmjet importit dhe eksportit, ku e kemi një deficit të madh tregtar dhe është një prej deficiteve më të mëdha që ka pasur vendi, që përfshin 25% të produktit të brendshëm bruto dhe gjithashtu në këtë raport lavdërohet shumë puna e sistemit bankar.

Unë besoj se sistemi bankar nuk duhet ta zhvillojë vetëm vetveten dhe në këtë drejtim edhe Banka Qendrore, edhe institucionet e Kosovës, por sidomos Qeveria duhet të ndikojë në uljen e kamatave të bankave, sidomos në sektorin privat, sidomos në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, kur e dimë që në Evropë është treguar i suksesshëm

financimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Ka vende në të cilat kreditë jepen me norma shumë simbolike, ose me norma shumë të vogla, ose pa hiç kamatë, e qëllimi kryesor është zvogëlimi i papunësisë, ndërsa te ne nuk bëhet dallimi ndërmjet normave të interesit të sektorit privat dhe ekonomik dhe kredive familjare, për ç'gjë ishte dashur në të ardhmen që Qeveria dhe institucionet tjera të kenë një vëmendje të posaçme për arsye të zvogëlimit të numrit të madh të papunësisë në Kosovë. Thuhet se është 45%, por unë besoj që ky numër është edhe më i madh, për arsye se nuk ka evidencë të saktë, për arsye se Enti i Statistikës së Kosovës nuk është duke funksionuar ashtu siç duhet, por besoj se e kalon 50-përqindëshin. Dhe, me qëllim të zvogëlimit të kësaj shkalle, sistemi bankar do të kishte qenë një zhvillim shumë i hovshëm dhe jo vetëm në zhvillimin e sistemit të vet, por të ndikojë shumë edhe në zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Prandaj, për fund, do të them se Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës e përkrah këtë raport, me shpresë që këto ndryshime të ndodhin me qëllim që ekonomia e Kosovës ta ketë një zhvillim më të hovshëm. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, kryetarja Myzejene Selmani!

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, zotëri nënkryetar!

Përshëndetje për ministrin dhe deputetët,

Duke marrë parasysh se Raporti i Bankës Qendrore është raport i cili vjen edhe në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës për çdo vit paraprak, mund të themi se BQK-ja në raportin e saj e ka pasqyruar gjendjen ekonomike dhe financiare nëpër të cilën ka kaluar shteti i ri i Kosovës.

Në raport shihet mjaft mirë sa ka qenë rritja buxhetore, apo më mirë të themi sa kemi pasur rritje të zhvillimit ekonomik në Kosovë, mirëpo prapëseprapë, të mos përsëris, mbetet akoma punë për përmirësim dhe shpresojmë që në të ardhmen ta kemi një rritje më të madhe të zhvillimit ekonomik, për arsye se ajo i duhet Kosovës.

Në rast se e shohim gjendjen nëpër bankat e Kosovës dhe e shohim gjendjen faktike të zhvillimit ekonomik në Kosovë, atëherë kemi shumë parametra, të cilët e japin mundësinë që në të ardhmen të kemi ndryshime dhe besoj që edhe me politikat e Qeverisë dhe me politikat e Kuvendit do të ketë ndryshime në favor të qytetarëve, meqë shihet se një ndër pengesat, apo më mirë të themi një ndër të këqijat e këtij raporti, pasi kjo është gjendja faktike e raportit, është numri i madh i të papunëve. Të hyrat buxhetore, të cilat mbliidhen në kufi - edhe kjo kërkon që në të ardhmen ta kemi një gjendje tjetër; sektori financiar - duhet të kemi kujdes se i kemi këto banka, mirëpo prapëseprapë, u theksua edhe nga parafolësi, që kemi kamata shumë të larta, e për uljen e kamatave të këtyre bankave besoj që BQK-ja dhe vetë Ministria e Financave do të përpiqen ta gjejnë një zgjidhje që në të ardhmen ta kemi një zhvillim të biznesit të vogël nëpërmjet kredive. E kemi çështjen e eksportit dhe importit, që mbetet për të dëshiruar, me qëllim që raporti i ardhshëm të jetë më i mirë, mirëpo në total ky raport shpreh gjendjen faktike nëpër të cilin ka kaluar shteti i Kosovës në vitin 2011.

Si Grup Parlamentar, ne e përkrahim raportin dhe shpresojmë që në të ardhmen gjendja faktike të jetë më ndryshe. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Deshishku e ka fjalën.

HASHIM DESHISHKU: Faleminderit, kryesues!

I nderuari ministër, zoti Hamza,

Të nderuar deputetë,

Kur e analizojmë Raportin vjetor të Bankës Qendrore të Kosovës, gjithsesi nuk mund e të mos i vërejmë dy karakteristika thelbësore: Tregu financiar në Kosovë reflekton stabilitet dhe përmirësim të ndjeshëm në krahasim me gjendjen e para 3-4 vjetësh. Ky fakt është trimërues, meqenëse në rajon e më gjerë ende janë të pranishme vatrat e mëdha të reziqeve, të cilat gjithsesi mund të interferojnë edhe në tregun financiar të vendit tonë.

Ndonëse ka rritje thuajse të gjithë treguesit e gjendjes në tregun financiar, situata e përgjithshme ekonomike e sociale në vend nuk po shkon kah përmirësimi. Do të thotë, potenciali i tregut financiar nuk ka aq ndikim në përshpejtimin e zhvillimit ekonomik në Kosovë.

Kur i kemi parasysh këto dy fakte, gjithsesi do të ndodhemi përballë dilemës se si është e mundur qëndrueshmëria e tregut financiar, konkretisht e atij bankar, të ndodhë në një ekonomi me plot probleme dhe me likuiditet të rrezikuar.

Edhe për këtë ka përgjigje brenda Raportit të Bankës Qendrore të Kosovës, posaçërisht kur i kemi parasysh burimet dhe strukturën e financimit të bankave komerciale dhe investimeve të tyre. Që në fillim duhet të them se të gjitha bankat kryesisht bazohen në financimin e brendshëm, ndërsa nuk janë shumë të interesuara të gjejnë burime tjera të parasë. Mjaftojnë burimet e brendshme që likuiditeti i tyre të mbetet në një nivel të kënaqshëm, ndërsa raporti ndërmjet depozitave dhe kredive të sillet në nivelin si e ka përcaktuar Banka Qendrore e Kosovës.

Por, kjo para ende mbetet e shtrenjtë për shfrytëzuesit, ndonëse ka shenja të lehta të uljes së saj. Është një element pozitiv se kreditimi është në rritje. Afro 1,7 miliard euro, sa ishin kreditë, janë rritur për 16,1%, përderisa kjo rritje në nivelin 2009 ishte 8,9, kurse në 2010 - 13,3%. Kjo është rritja më e shpejtë edhe në raport me rritjen e depozitave, e cila është 9,5%.

Rritja e kreditimit ka ndodhur edhe për shkak të fokusimit të bankave në investimet e brendshme. Për këtë ishin të shtrënguara për shkak të rrezikut, që ende është i lartë në Evropë. Kjo është arsyeja pse vjet investimet në tregjet e jashtme ishin 22,4% më të vogla. Mirëpo, edhe në këto rrethana, bankat vështirë po heqin dorë nga tradita e tyre për investime. Janë kredituar degët që premtojnë kthim të shpejtë, por të cilat nuk kanë ndikim të madh në zhvillimin e përgjithshëm. Është përkrahur tregtia dhe shërbimet, të cilat i shfrytëzuan 71% të kredive, kurse janë injoruar prodhimet dhe bujqësia.

Për ilustrim po përmendi se bujqësia merr pjesë me 3,5%, ndërsa 90% e parave që i shfrytëzoi kjo degë janë investime vetëm nga një bankë. Do të thotë se 7 bankat tjera pothuajse fare nuk e kanë në agjendë këtë degë strategjike të vendit. Pra, këtu del edhe një përgjigje se pse gjendja në tregun bankar nuk reflekton më fuqishëm në shkallën e zhvillimit ekonomik të vendit, ndërkaq shkalla e zhvillimit ende është e zymtë, gjë që vërehet edhe nga ky raport, e që karakterizohet me një deficit të lartë tregtar dhe me ngecje të konsumit publik në raport me prodhimin e brendshëm bruto, i cili mbetet në nivelin 15% të tij.

Nga raporti del edhe një element, i cili, ndonëse nuk është alarmues, nuk duhet të nënçmohet kur janë në pyetje depozitat. Rritja nuk po e përcjell nivelin e viteve të mëhershme. Në total, ato u rritën për 9,5%, krahasuar me 11%, sa ishin në vitin 2010. Depozitat e ekonomive familjare nuk e kanë arritur as gjysmën e normës së rritjes, që e kishin në vitin 2010. Ato të ndërmarrjeve publike kanë mbetur në nivelin e njëjtë, ndërsa Qeveria pothuaj se nuk ka fare depozita, apo nga 11,7 milionë euro, ra në 2,7 milionë euro.

Nga kjo del ajo që më shqetëson - rritja më e ngadalshme e nivelit të depozitave paralajmëron mungesën e parasë, do të thotë se ngadalë po shteren burimet e brendshme të saj. Madje, sivjet gjendja mund të jetë edhe më e rëndë, meqenëse, sipas Bankës Qendrore të Kosovës, rritja ekonomike do të jetë dukshëm më e ulët se ajo që shpreson Qeveria e Kosovës. Prandaj, bankat duhet të gjejnë burime alternative, por me kujdes që nëpërmjet tyre të mos e importojnë edhe krizën.

Pa marrë parasysh këto zhvillime, megjithatë duhet pranuar se gjendja është e mirë kur kemi parasysh përvojat që aktualisht kanë shumë vende të Evropës. Këtu nuk duhet mohuar angazhimin dhe përkushtimin që e ka treguar Banka Qendrore e Kosovës, posaçërisht për mbikëqyrje, përkatësisht që të veprojnë në preventivë, ashtu që bankat të mos futen në zonën e rrezikut. BQK-ja duhet të insistojë që bankat të gjejnë edhe burime të tjera të financimit, e të mos mbështeten vetëm në shtrydhjen e tregut të brendshëm dhe të ndihmojnë në krijimin e mekanizmave që paratë që janë jashtë të futen në qarkullim brenda vendit, po në të njëjtën kohë BQK-ja duhet ndihmuar që autoriteti i saj të shtrihet në tërë vendin, përkatësisht për mbylljen e të gjitha bankave ilegale në Kosovë, si dhe në përpjekjet që i tërë qarkullimi i parasë të bëhet nëpërmjet rrugëve institucionale, pra nëpërmjet kanaleve bankare.

Edhe njëherë duhet ta theksoj se shumë herë në Kuvend po përmenden nga deputetët se kamatat e bankave ndaj qytetarëve janë të mëdha. E pranoj këtë realitet - janë të mëdha, po ne duhet ta dimë se janë banka komerciale dhe e kanë alternativë profitin e vet dhe më duhet të them që Qeveria jonë, institucionet tona, duhet medoemos që mjetet e investuara jashtë vendit t'i kthejnë në vend dhe bankat komerciale t'i marrin ato mjete dhe t'i qarkullojnë nëpërmjet kredive me kamata shumë më të ulëta. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Gashi e ka fjalën!

ARBEN GASHI: Faleminderit!

Unë e mora fjalën për të diskutuar për Raportin e Bankës Qendrore, por më shumë për gjendjen ekonomike me të cilën po përballlet vendi dhe po na dalin gjithmonë diskrepanca ndërmjet realitetit në të cilin po jetojmë ne dhe qytetarët e Kosovës dhe letrave të cilat po dorëzohen në institucionet e Kosovës.

Këtu e kemi një mburrje që po rezulton se i kemi rritur shpenzimet publike dhe me rritjen e shpenzimeve publike po rezulton se kemi ndikuar në rritjen ekonomike të vendit.

Po ashtu, e kemi një mburrje tjetër që i kemi rritur importet, por pak i kemi rritur edhe eksportet, e kjo ka ndikuar pozitivisht në ekonominë e vendit. Dhe, po ashtu, mburrja që janë rritur investimet kapitale dhe si rezultat i investimeve kapitale dhe shpenzimeve publike ka pasur përmirësim edhe ekonomia e vendit.

Fatkeqësisht, ne shohim se është rritur varfëria, e po ashtu është rritur varfëria ekstreme. Fatkeqësisht, ne e shohim se investimet publike janë koncentruar vetëm në një degë, vetëm në një projekt kryesisht - projekti i autostradës, për të cilin kemi folur dhjetëra herë këtu dhe kemi dhënë edhe mendimin, edhe vizionin, edhe qëndrimin tonë.

Projekti i autostradës, kemi thënë se është një projekt i rëndësishëm për Kosovën dhe duhet të përfundohet, por po ashtu kemi thënë se ekonomia e Kosovës nuk duhet të rrezikojë që gjithë kapitali i investimeve publike të shkojë në një projekt. Po ashtu, kemi thënë se investimi i një projekti të vetëm te një kompani e huaj do të ndikojë negativisht dhe fatkeqësisht ka ndikuar negativisht në sektorin e industrisë së ndërtimit. Industria e ndërtimit, ju e dini se para 3-4 vjetësh e ka pasur një investim shumë të madh nga Qeveria, meqë çdo vit mbi 300 milionë euro janë investuar në sektorin e ndërtimit, e këto para i ka absorbuar kryesisht sektori privat i Kosovës.

Në hyrjen e “Bechtel&Enka”-s në tregun e ndërtimit në Kosovë, të gjitha këto investime janë koncentruar në këtë kompani dhe kjo kompani tashmë i ka nxjerrë jashtë loje të gjitha kompanitë e reja të Kosovës, të cilat pretendonin që të merrnin pjesë në industrinë e ndërtimit. Dhe, kjo politikë e gabuar e investimeve kapitale të Qeverisë së Republikës së Kosovës sot ka lënë me mijëra njerëz të papunë dhe ka lënë mjete nëpër rrugë. Ju shihni sot nëpër Kosovë kamionë, bagerë dhe mjete të tjera të punës që kanë mbetur pa punë. Ju e shihni si ofertojnë dhe konkurrojnë kompanitë kosovare vetëm për të mbijetuar nëpër disa komuna të vogla, për të marrë ndonjë tender sa për t’i paguar kreditë, të cilat i kanë marrë për t’u pajisur me ato mjete.

Kjo ka ndikuar po ashtu edhe në rritjen e kredisë të keqe, sepse kthimi i kredisë është problematik, ngase ato kompani nuk kanë punë. Dhe, të gjitha këto probleme kanë lindur dhe vazhdojnë të rriten kur t’i shtohet kësaj edhe një element tjetër. Elementi i rëndësishëm që shtohet këtu është investimi direkt i jashtëm. Investimi i jashtëm direkt në Kosovë llogaritet investimi në autostradë, që është para e Kosovës, që i jepen një kompanie që vjen nga jashtë, e në të njëjtën kohë regjistrohet si investim i jashtëm direkt për Kosovën gjë që është katastrofale, e paarsyeshme dhe e palogjikshme.

Prandaj, krejt këto politika ekonomike, të cilat i ndjek kjo Qeveri dhe të cilat po dalin nëpër raporte të ndryshme, edhe në raportin të cilin sot e kemi përpara, janë problematike, sepse në vetvete nuk po gjenerojnë zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.

Vitin e kaluar, më kujtohet, kur e patëm debatin lidhur me Raportin e shpenzimeve të buxhetit, i patëm diskutuar pak a shumë këto problematika dhe kryeministri mburrej se Kosova po zhvillohet, e ju që jeni kundër autostradës jeni kundër Kosovës, gjë që realisht nuk ishte e vërtetë se ne ishim kundër autostradës, ne ishim kundër politikës për ndërtimin e autostradës, sepse vendimi dhe financimi i autostradës ka qenë një vendim dhe financim i gabuar. Nuk është dashur që gjithë investimet kapitale të koncentrohen në një projekt. Ky ka qenë një qëndrim, të cilin Lidhja Demokratike e Kosovës e ka thënë në vazhdimësi dhe vazhdon ta thotë, sepse sektori i ndërtimit në Kosovë është dëmtuar rëndë dhe mundësia e investimit të shtetit dhe të komunave në aspektin e industrisë së ndërtimit është në gjendje shumë të keqe dhe realisht shumë problematike.

Mirëpo, dalim te problemi tjetër. Problemi tjetër me të cilën po ashtu po përballet sot Kosova është problemi i shpenzimeve publike, për të cilat Qeveria mburret që e ka rritur. Ju e dini se ne kryesisht jemi një ekonomi konsumuese. Prodhimi vendor është shumë i ulët. Duke i rritur shpenzimet publike, Qeveria ka ndikuar po ashtu edhe në rritjen e inflacionit, sepse ne e importojmë shumicën e produkteve, të cilat i konsumojmë, e ideja e rritjes së konsumit publik është që të rritet prodhimi i brendshëm. Ndërsa, realisht, ka ndikuar në rritjen e prodhimit të vendeve fqinje, nga të cilat ne kryesisht i marrim produktet e konsumit bazë.

Prandaj, mendoj se këto janë problematika të orientimit strategjik të zhvillimit ekonomik të vendit dhe të qëndrueshmërisë ekonomike dhe zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm.

Te zhvillimi ekonomik i qëndrueshëm nuk hyn vetëm aspekti ekonomik dhe financiar për të cilën po flitet dhe diskutohet, por hyn edhe aspekti social. Sa kemi arritur të gjenerojmë mirëqenie dhe sa mund me ato para të cilat prodhohen në Kosovë, në kuptimin e zhvillimit ekonomik, edhe në kuptimin e interaksionit ekonomik, të kemi përmirësim të kualitetit të jetës?

Po rezulton se fuqia e blerëse e parasë nuk është e kënaqshme dhe rroga, të cilën e marrin sot qytetarët e Kosovës, me të cilën Qeveria mburret se i ka rritur, vlejnë më pak se sa ka vlerë rroga e një zyrtari të Kosovës para 2 apo 3 vjetëve. Ky është një problem, i cili po reflektohet në kualitetin e jetës dhe ky është një problem, i cili duhet realisht të sfidohet dhe të përballohet edhe Qeveria edhe gjithkush që mund të merret me këtë punë.

Prandaj, mendoj se orientimi ekonomik duhet të jetë më i qartë dhe në këtë rast e kemi humbur tragetin me politikat ekonomike që i ndjek Qeveria. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ministri Hamza e ka kërkuar fjalën. E keni fjalën, zoti ministër.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Raporti, të cilin e ka prezantuar Banka Qendrore nuk ka ndonjë diskrepancë dhe shpërputhje ndërmjet asaj që e ka prezantuar Ministria e Financave, ndoshta 5-6 muaj më herët.

Dhe, Banka Qendrore, në këtë raport thekson se rritja ekonomike për vitin 2011 ka qenë 5%. Të gjithë ne pajtohemi që Kosova ka nevojë për një rritje ekonomike më të madhe, mirëpo është fakt se nuk është rritje ekonomike e vogël dhe posaçërisht kur e kemi për bazë ambientin e jashtëm, në të cilin është realizuar kjo rritje ekonomike. Gjithashtu, ky raport e thekson faktin se kemi pasur një rritje të të hyrave për buxhetin e Kosovës; kemi pasur një përmbushje të planit prej 100% me një tejkalim të lehtë; kemi pasur një ekzekutim të buxhetit prej 92%, që është për t'u vlerësuar; kemi pasur rritje të investimeve kapitale; kemi pasur rritje të investimeve të jashtme prej 14 e sa për qind më tepër. Prandaj, është e pamundshme të thuhet që, me gjithë këta parametra, kur i merr njeriu dhe i shikon, në të njëjtën kohë kemi pasur rritje ekonomike, kemi pasur këtë e atë rritje, dhe kemi pasur përkeqësim të gjendjes ekonomike. Diçka këtu nuk shkon.

Unë nuk do të kisha thënë që projekti kapital i Kosovës ka shkuar vetëm në një projekt. Është vlerë e madhe që ka shkuar në atë projekt. Vitin e kaluar kanë shkuar rreth 240 milionë euro, por dua të theksoj që ne jemi duke punuar me intensitet nga vitet paraprake. Të mos flasim në njëjës për autostrada, por të flasim në shumës. Jam i sigurt se nga viti i ardhshëm ne do të fillojmë me ndërtimin e dy autostradave, përfundimin e kësaj dhe fillimi i autostradës së re.

Sigurisht se ka çështje tjera në të cilat ne duhet të përmirësohemi. E kemi deficitin tregtar të pafavorshëm, por kjo është një gjendje e trashëguar dhe nuk do të ndryshojë brenda një viti, apo brenda dy vetëve. Është me rëndësi të kemi progres, e progresi të jetë sa më i madh. Dhe, kemi normën e papunësisë.

Kur jemi te norma e papunësisë, në mungesë të të dhënave ekzakte statistikore, është vështirë për të ardhur deri te shifra e sigurt. Presim që publikimi i rezultateve zyrtare të regjistrimit të popullsisë ta qartësojë gjendjen, mirëpo papunësia nuk bëhet me anketa, e posaçërisht nuk bëhet me anketat të vitit 2009. Prandaj, konsideroj që në segmente të caktuara, Kosova ka ecje pozitive. Kemi nevojë për përmirësime, por, në përgjithësi, është një raport korrekt dhe si i tillë i plotëson kushtet, meqë na jep informata të mjaftueshme, sikur edhe publikut. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Bajrami është lajmëruar për replikë.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit!

Ndoshta nuk është replikë, po vetëm për ta përforcuar atë që e thashë. Të gjitha shifrat i kam marrë nga raporti. Në Raportin e Bankës Qendrore thuhet se kemi 325 261 punëkërkuar të regjistruar. Aty shprehet si shqetësim se nuk kemi anketë për papunësinë që nga viti 2009. Nëse papunësia nuk matet me anketa, atëherë Ministria e Financave, Qeveria Thaçi, në krye me planin kombëtar për zhvillim ekonomik, nuk e kanë bërë ende

një dokument për ta parë, le ta gjejnë ndonjë instrument ose një mekanizëm për ta matur papunësinë. Gjendjen ekonomike, që është në regres, e ka reflektuar edhe raporti i gjashtëmujorit të fundit të Bankës Qendrore, që është gjashtëmujori i vitit 2012, ku thuhet se kanë rënë investimet e huaja direkte, kanë rënë remitencat, kemi thellim të bilancit tregtar, që do të thotë se po zvogëlohet eksporti dhe po rritet në masë të madhe importi. Edhe rritja ekonomike është rishikuar për këtë vit, që do të thotë nga 5,8%, ka rënë në 3,8%, e të gjitha këto tregojnë regres ekonomik. Ne u pajtuam se ka pasur rritje 5%, por e thamë që nuk është e mjaftueshme, bile as nuk e absorbon numrin e të papunëve, që janë 30 mijë të rinj, të cilët për çdo vit hyjnë në tregun e punës në Kosovë.

Kështu që assesi nuk mund të pajtohem dhe të duartrokasim për gjendjen ekonomike, sepse gjendja ekonomike shihet në rrugë, shihet kudo. Për një vend të punës ne kemi 100 deri 200 aplikacione. Kemi njerëz me fakultet që lypin me të punojnë si kamerierë, si recepsionistë e tjera. Dhe, kjo është gjendja ekonomike. Gjendja ekonomike është e tillë që qytetarët e Kosovës po vuajnë dhe po vuajnë pikërisht për shkak të politikave të gabuara dhe Qeverisë së autostradave...

(Ndërprerje nga regjia)

KRESUESI: Zoti Hamza, kundër-replikë.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Bëra përpjekje të jem i kujdesshëm, të mos krijojë situata për replikë.

Rritja ekonomike 5%, edhe sipas raporteve të Bankës Botërore, është rritja më e madhe ekonomike në vendet e Evropës Juglindore.

Ju isha lutur, referojuni këtyre raporteve. Po e themi, po pajtohem të gjithë që synojmë që kjo rritje ekonomike të jetë më e lartë. Mirëpo, Kosova është i vetmi vend në regjion që e ka arritur këtë normë të rritjes ekonomike. Të gjithë e dimë që baza është e ulët dhe s'po duam ta ndryshojmë atë fare. I vetmi vend është Kosova, prapë po u referohem raporteve të Bankës Botërore, që viteve të fundit ka trend pozitiv edhe në pjesën e të hyrave, edhe të shpenzimeve të buxhetit. Unë e di që mund të ketë dallime konceptuale, unë e di që ka modele të ndryshme të zhvillimit ekonomik. Unë pajtohem dhe e vlerësoj atë që dikush...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Kundër-replikë është, mbaroi. Atëherë nuk ka tjerë të paraqitur.

Në sallë janë të pranishëm 66 deputetë. E hedh në votim Raportin vjetor të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2011. Votojmë tani!

Me 59 vota për, 2 abstenim dhe një votë kundër, konstatoj se Kuvendi e miratoi Raportin vjetor të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2011.

Pika e gjashtë e rendit të ditës:

6. Shqyrtimi i Raportit vjetor të performansës me pasqyrat e audituara financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2011

Komisioni FunkSIONAL për Mbikëqyrjen e Financave Publike e ka shqyrtuar Raportin vjetor të performansës me pasqyrat e audituara financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2011 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Sipas Rregullores, fjalën e ka kryetari i Komisionit FunkSIONAL, zoti Sadriu, për arsyetimin e raportit. Zoti Sadriu, e keni fjalën.

ALI SADRIU: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Raporti vjetor i performansës së pasqyrave të audituara financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2011:

Sipas Ligjit për themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Auditorit të Kosovës, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm - KZAP-i duhet t’ia dorëzojë Kuvendit të Republikës së Kosovës deklaratën financiare të certifikuar nga auditorët e jashtëm dhe një raport mbi veprimtarinë e saj gjatë vitit.

Auditimi i pasqyrave financiare të KZAP-it bëhet nga auditorët e jashtëm, të cilët zgjidhen dhe emërohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, përkatësisht Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike.

Në bazë të përfundimit të Kryesisë së Kuvendit, numër 04P-060/K, të datës 29 nëntor 2011, dhe në bashkërendim me Administratën e Kuvendit, Divizioni i Prokurimit ka bërë përzgjedhjen e kompanisë, e cila ishte “Deloitte Touche”, për auditimin e pasqyrave financiare të KZAP-it për vitin 2011.

Raporti mbi veprimtarinë e KZAP-it gjatë vitit 2011 është proceduar për shqyrtim në Kuvend sipas ligjit, por shqyrtimi i tij është shtyrë derisa është proceduar dhe Raporti i auditimit të pasqyrave financiare të vitit 2011. Kjo për arsye se raporti vjetor nuk ka fuqi të njëjtë, nëse nuk e ka edhe mendimin e auditimit të jashtëm.

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike mendon se edhe raportet vjetore të institucioneve tjera do të duhej realisht t’i kenë të bashkangjitura edhe pasqyrat e audituara në rastin e trajtimit.

Në mbledhjen e mbajtur më 29 gusht 2011, Komisioni e ka shqyrtuar Raportin të performansës dhe pasqyrat e auditimit financiar të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2011.

Sipas vlerësimit të Komisionit, raporti i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike është bërë në kohë, sipas afateve ligjore.

Cilësia dhe mbulimi i auditimit po përmirësohen dukshëm nga një rritje e numrit të auditimeve të kryera.

Së paku në tre vjetët e fundit e kemi një performansë pozitive. Janë kryer 89 auditime, prej të cilave janë raportuar 87. Dy raporte të auditimit nuk janë raportuar për arsye të kualitetit të dobët. Kemi të bëjmë me llojin e auditimit të performansës, meqë kapacitetet e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm ende janë të limituara.

Për sezonin e auditimit të viteve 2010-2011, KZAP-i ka planifikua të bëjë 105 auditime, prej të cilave 4 do të jenë të performansës.

Me kalimin e kohës është reduktuar numri i auditimeve të kontraktuara, e kjo si rezultat i rritjes së burimeve të KZAP-it. Shembull, derisa vitin e kaluar, tabelat financiare të komunave auditoheshin nga kompanitë private, tani, në vitin 2011, Zyra e Përgjithshme e Auditorit e ka mbuluar më se gjysmën e tyre. Do të thotë është një rritje e auditimit, që e kryen Zyra Qendrore.

Kufizimet e mëparshme të kapaciteteve janë duke u zvogëluar në mënyrë graduale. Nga 119 punëtorë, në vitin 2010, në vitin 2011 numri i të punësuarve është rritur në 124, plus 2 që janë në zëvendësim.

Objektiv kryesor deri në vitin 2014 është themelimi i një institucioni të qëndrueshëm që vepron në pajtim me standarde ndërkombëtare të auditimit dhe që siguron që organet e auditimit t'i adresojnë rekomandimet në mënyrë efektive.

Sipas vlerësimit që i është bërë KZAP-it nga SKSA është binjakëzimi i zyrës sonë me Zyrën e auditimit suedez dhe, në bashkëpunim me USAID-in, është thanë se ZAP-i është në rrugën e duhur, por i nevojitet mbështetje që të mund t'i zbatojë plotësisht standardet ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik.

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike në vazhdimësi kujdeset për nevojat e Zyrës së Auditorit dhe rekomandimet e Komisionit për Buxhet dhe Financa, i cili deri më tani e ka përkrahur Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm. Pra, të dy komisionet deri më tani kanë qenë në funksion të mbështetjes dhe përkrahjes për rritjen e kapacitetit, në mënyrë që zvogëlimi i donacioneve në kuptimin e ndihmës që i është dhënë Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të zëvendësohet me njerëz lokalë dhe ata të aftësohen për marrjen e atyre kompetencave.

Azhurimi i kornizës ligjore për sigurim më të mirë të KZAP-it, zgjerimi i fushave të reja të auditimit, ngritja e kapaciteteve të brendshme dhe auditimet e certifikuar janë rezultat që tregojnë avancimin më të mirë të KZAP-it.

KZAP-i i ka pasur rezultatet më të mira në këto vite tek auditimet e rregullsisë dhe mendojmë se janë në nivel të kënaqshëm.

Megjithatë, kapacitetet e Zyrës së Auditimit për auditimin e performansës së institucioneve mbeten në shumëçka për të dëshiruar dhe do të jetë sfidë e të gjitha institucioneve që ta përkrahim që edhe në këtë drejtim ajo ta mbulojë me kompetencë këtë sferë.

Bazuar në këtë, Komisioni i rekomandon Kuvendit që ta miratojë Raportin vjetor të performansës së Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm me pasqyrat financiare të vitit 2011. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Sadriu! Fjala është e përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, zonja Dibra e ka fjalën.

VALBONA DIBRA: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Raportin vjetor të performansës së Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës për vitin 2011.

Raporti e pasqyron punën e Zyrës së Auditorit gjatë vitit 2011, zyrë kjo e cila dita-ditës po profesionalizohet në aspektin e kryerjes së auditimeve.

Gjatë vitit 2011, kjo zyrë, me staf prej rreth 100 auditorëve, ka kryer 89 auditime të ndryshme, prej tyre 76 auditime të rregullsisë në kuadër të Buxhetit të Kosovës, 4 auditime të rregullsisë të ndërmarrjeve publike, 4 auditime të menaxhimit financiar dhe një auditim të performansës.

Me gjithë angazhimin e madh të stafit të kësaj zyre, shqetësues mbetet ende numri i vogël i auditimeve të performansës, meqë në vitin 2011, siç e ceka edhe më lart, është kryer vetëm një auditim i performansës. Vlen të theksohet se në sesionin e auditimit 2011-2012 janë planifikuar katër auditime të performansës, që shihet se ka tendencë të rritjes së këtij lloji auditimi. Shikuar në përqindje, mbulimi i auditimit të Buxhetit të Kosovës është 87% e shpenzimeve dhe 99% e të hyrave.

Krahasuar me vitet e kaluara, ka pasur rritje të numrit të auditimeve, nga 70, sa ishin në vitin 2010, në 89 në vitin 2011 dhe 105 në vitin 2012. Nga krejt këto auditime janë dhënë 16 opinione të pakualifikuara, 35 opinione të pakualifikuara me theksim të çështjes, 19 opinione të kualifikuara dhe 3 opinione të kundërta. Sa u përket opinioneve të auditimit, dallimi nga viti 2010 është te opinionet e pakualifikuara, me theksim të çështjes, ku shihet se ka pasur rritje, si dhe ka pasur rënie të opinionit të kualifikuar. Ky është një tregues që organizatat buxhetore janë duke bërë përmirësim në menaxhimin dhe shpenzimin e parasë publike.

Po ashtu, pasqyrat vjetore të audituara të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm janë të bashkangjitura në këtë raport. Këto pasqyra janë audituar nga një auditor i jashtëm i pavarur. Auditori i pavarur ka dhënë opinion të pakualifikuar, që do të thotë se pasqyrat

financiare në të gjitha aspektet materiale paraqesin një pamje të drejtë të gjendjes financiare.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e përkrah raportin dhe i fton edhe kolegët që ta përkrahin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i LDK-së, në emër të grupit, zoti Sadriu(?). Për Grupin Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, fjalën e ka zoti Hoti.

AFRIM HOTI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Raporti vjetor i performansës në brendinë e tij shpreh nivelin solid të punës së Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Fakti që e vërteton punën solide të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm konsiston periudhën kohore të auditimeve, duke filluar prej vitit 2010 dhe përfunduar në fund të gushtit të vitit 2011. Zyra e Auditorit gjatë kësaj periudhe kohore kishte kryer gjithsej 89 auditime të ndryshme të ndërmarrjeve publike dhe të institucioneve tjera shtetërore, duke dhënë opinione të ndryshme, varësisht prej rregullsisë së menaxhimit të financave publike nga ndërmarrjet dhe institucionet shtetërore të audituara.

Kësisoj, cilësia e Zyrës së Auditorit mbetet e dëshirueshme për shkak se praktika na ka vërtetuar se jo gjithëherë opinionet e Zyrës së Auditorit kanë qenë në përputhje me skandalizimin e menaxhimit të financave nga institucionet publike, që do të thotë se opinionet e Zyrës së Auditorit për ndërmarrjet publike të audituara në disa raste nuk e kanë treguar pasqyrën e vërtetë të keqpërdorimeve të financave publike nga organet e audituara.

Mirëpo, ndryshe thuhet në këtë raport, ku Zyra e Auditorit i bën lajka vetvetes për nivelin e cilësisë së saj. Kësisoj, për auditimin e subjekteve të audituara, Zyrës së Auditorit i është ndarë buxhet prej 1 866 000 euro, më pas ZAP-it i janë tërhequr 500 802 euro për financimin e projektit të autostradës Morinë - Merdar, me logjikën e kësaj Qeverie që të ndjekë diskursin në ndërhyrjet financiare në institucionin e pavarur dhe kushtetues, siç është Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, me qëllim që ato mjetet të shpenzohen në shtrimin e asfaltit.

Ndryshe, shpenzimet e buxhetit nga Zyra e Auditorit paraqitet në këtë mënyrë, ka rritje të shpenzimeve në paga dhe mëditje në krahasim me vitin 2010, kurse për mallra dhe shërbime, shërbime komunale dhe investime kapitale shpenzimet kanë rënë në krahasim me vitin 2010. Mirëpo, një gjendje shqetësuese, e cila i preokupon, përveç Zyrës së ZAP-it, edhe disa institucione të pavarura, janë shpenzimet e buxhetit që kanë destinim pagesën e objekteve me qira, ku janë të vendosura këto institucione. Për më tepër, në këtë raport theksohet se Zyra e Auditorit ka shpenzuar hiç më pak se 168 000 euro për një vit lidhur me pagimin e qirasë së objektit, ku është e vendosur.

Prandaj, në këtë rast kërkojmë nga Qeveria dhe komunat përkatëse që të ndërtojnë objekte në pronat publike, ku do të vendoseshin këto institucione dhe rrjedhimisht do të ketë shmangie nga këto pagesa marramendëse dhe ruajtje të parasë së taksapaguesve. Mirëpo, ndryshe e theksojnë pasqyrat financiare të detajuara për vitin e përfunduar 2011. Këtu vërehen shpenzime më të larta nëpër udhëtime brenda vendit, në krahasim me vitin 2010. Pastaj, ka pasur rritje të shpenzimeve për vaj, për ngrohje, dreka zyrtare, shpenzime për gostitë e fundvitit për 130 anëtarë të stafit etj.

Mirëpo, duke e analizuar në tërësi raportin, kemi ardhur në përfundim se puna e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm është e nivelit mesatar, prandaj Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” do ta votojë dhe e përkrah këtë raport. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, fjalën e ka zoti Muharremaj.

BALI MUHARREMAJ: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka shqyrtuar Raportin vjetor të performansës për vitin 2011 të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, si dhe Raportin e auditimit të jashtëm të pasqyrave financiare për vitin 2011.

Ne presim që nga viti në vit të zvogëlohet numri i auditimeve të kontraktuara deri në eliminimin e tërësishëm të atyre, ngase ato nuk e kanë cilësinë e dëshiruar. Por, deri në momentin që nuk ndodh një gjë e tillë, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm duhet me kujdes t’i përzgjedh dhe t’i mbikëqyrë këto kompani gjatë punës. Mbulimi me auditimin e Buxhetit të Kosovës është i kënaqur duke marrë parasysh kapacitetet e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, por duhet bërë përpjeke për një mbulueshmëri më të madhe në fushën e shpenzimeve, ngase pikërisht në atë fushë mund të ketë më shumë keqpërdorime.

Aspak nuk jemi të kënaqur me auditimin e performansës. Numri i tyre është jashtëzakonisht i vogël dhe cilësia e tyre është nën nivelin e kërkuar. Jemi të vetëdijshëm për vështirësitë që ka kjo fushë, prandaj kërkon ekspertizë dhe buxhet më të madh, por është e vetmja mënyrë për të vlerësuar që paratë e shpenzuara nga e shkuara në destinacion duhet të jenë përdorur në mënyrë të drejtë dhe transparente.

Një matës i suksesit apo të mossuksesit të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm është edhe zbatimi i rekomandimeve nga organizatat buxhetore, përderisa niveli qendror ka adresuar më shumë rekomandime dhe gjendje tjetër kemi në ato lokale. Nga 275 rekomandime, niveli lokal i ka adresuar plotësisht vetëm 15% të tyre. Kjo mbase edhe për shkak të pasqyrave financiare në nivelin lokal, në masë të madhe auditohen nga kompanitë private dhe shpeshherë rekomandimet janë të paqarta dhe mungon bashkëpunimi ndërmjet palëve të audituara dhe auditorëve.

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm ka regres për afro 6% në përmbushjen e planifikimit të shpenzimeve në krahasim me vitin 2010. Ky trend nuk guxon të ndodhë në vitin e ardhshëm, kur kihet parasysh se buxheti i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm ka ardhur

duke u rritur nga viti në vit. Kapacitetet e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm janë zgjeruar në vazhdimësi. Në krahasim me vitin 2009, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm ka arritur kuadër për 40 pozita, që është shifër e kënaqshme. Presim që vitin e ardhshëm të plotësohen shifrat prej 120 auditorëve, siç kërkohet në bazë të marrëveshjes së planit të veprimtimit për partneritet evropian.

Jemi të kënaqur me bashkëpunimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm me Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike, i cili është në rritje të vazhdueshme. Në sajë të këtij bashkëpunimi, është rritur edhe niveli i përgjegjësisë dhe i llogaridhënies. Ajo çfarë mbetet të përmirësohet është qartësia e raporteve dhe rekomandimeve që janë më konkrete. Ndërsa, sa i përket auditimit të pasqyrave vjetore financiare, ashtu edhe siç duhet të ishte, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm ka menaxhuar mirë me paratë e saj. Disa vërejtje janë dhënë në fushën e prokurimit, por ato cilësohen të jenë më shumë të natyrës së gabimeve teknike se sa që kanë për qëllim dëmtimin e buxhetit.

Grupi Parlamentar i Aleancës në parim do ta votojë këtë raport. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Koalicioni Kosova e Re, fjalën e ka kryetarja Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Koalicioni për Kosovë të Re e ka shqyrtuar Raportin vjetor të performancës me pasqyrat e audituara financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2011 dhe në tërësi mund të themi se ai është i mirë, për arsye se jepen faktet në tabelat e përshkruara, mënyra e menaxhimit të financave të administratës publike.

Në tërësi, raportin mund ta përkrahim dhe shpresojmë që në të ardhmen të kemi raporte edhe më të mira. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin “6+”, fjalën e ka zoti Kinolli.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar “6+” e ka shqyrtuar Raportin vjetor të performancës së Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe e mbështet vlerësimin e komisionit bazuar në raportin e ZAP-it, ku shihet se cilësia e auditimit është duke u përmirësuar dukshëm.

Andaj, Grupi Parlamentar “6+” e përkrah rekomandimin e komisionit dhe është për miratimin e tij. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Deshishku e ka fjalën.

HASHIM DESHISHKU: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Fillimisht më duhet ta përgëzoj Auditorin e Përgjithshëm për një raport të shkurtër, konciz dhe të qartë. Posaçërisht është me rëndësi që në raport janë qartësuar të gjitha

problemet me të cilat ballafaqohet procesi i auditimit, madje me një terminologji të kuptueshme për secilin.

Nga raporti vërehet se kushtet dhe rrethanat në të cilat ka punuar Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, krahasuar me vitet e mëhershme, kanë shkuar drejt përmirësimit. Kjo vërehet, si kur është në pyetje shuma e mjeteve të ndara për financimin e veprimtarisë së tij, ashtu edhe për numrin e të punësuarve në këtë zyrë, i cili është në rritje. Krejt kjo reflektohet te numri i auditimeve të kryera, kështu që në sezonin 2011-2012 janë bërë 105 auditime, ose 16 më shumë se në sezonin 2010-2011, apo 35 më shumë se në sezonin 2009-2010.

Krahas kësaj, kam disa vërejtje, që sado të vogla, përmirësimi i tyre do të ndikonte në përmirësimin e punës së auditorit të përgjithshëm, si dhe në cilësinë e raportimit. Opinione të dhëna, po e përmend vetëm një shifër, pa hyrë thellë në detaje: në raport thuhet se janë dhënë 16 opinione të pakualifikuara dhe 19 opinione të kualifikuara. Numri më i madh i opinionëve të pakualifikuara në raport me ato të kualifikuara tregon se ende ka çalime dhe parregullsi në mënyrën e shfrytëzimit të parasë publike. Por, megjithatë, raporti nuk jep shumë indikacione se gjendja po shkon kah përmirësimi, apo kah përkeqësimi. Meqenëse nuk jep një pasqyrë të progresit sipas viteve, do të ishte mirë që raporti të kompletohet me të dhënat e tilla, në mënyrë që të shohim se sa po avancohet procesi i auditimit brenda agjencive buxhetore.

Edhe çështja e dytë ka të bëjë me opinionet. Në pikën e fundit të kësaj kaptine thuhet se për 8 komuna auditorët nuk mund të japin një opinion për shkak të paqartësisë, apo konfuzionit të fushëveprimit. Kjo çështje është shqetësuese, pasi 8 shfrytëzuesit e parasë publike kanë pasqyra financiare nën nivelin që nuk merren vesh, dhe tjetra nëse ato e kanë kufizuar fushëveprimin e auditorëve. Përgjegjësit e këtyre komunave, jo vetëm që e kanë shkelur ligjin, por thjesht nuk kanë dashur të dalin në sipërfaqe me parregullsitë dhe keqpërdorimet rreth shfrytëzimit të parasë publike. Lidhur me këtë, Auditorit të Përgjithshëm i parashtrij pyetje: a). Cilat janë këto 8 komuna, të cilat nuk jepen në raport?; b). Çka nënkupton saktësisht kufizimi i fushëveprimit? dhe c). A i ka ndërmarrë të gjitha veprimet në bazë të autorizimeve ligjore që ka, apo i ka raportuar rastet te institucionet, të cilat mund të ndihmojnë në krijimin e kushtit për auditim më të mirë?

Dhe, çështja e tretë ka të bëjë me numrin dhe përqindjen e rekomandimeve të adresuara në vitin 2010. Në pasuesin e fundit të kësaj kaptine thuhet: “Në disa raste, rekomandimet tona kanë qenë të papërgjithësuara dhe ose jo më shumë specifike. Në disa raste, ne mendojmë se mungon gatishmëria dhe aftësia për t’i adresuar si duhet mangësitë”. Ky konstatim lë vend për shqetësim, meqenëse sado që të jetë autokritik Auditori, ai nuk guxon të japë rekomandime të përgjithësuara dhe jo specifike, e posaçërisht të mos jetë i gatshëm që mangësitë t’i adresojë mirë. Kjo krijon dyshime për cilësinë e rekomandimeve apo edhe të auditimit, në përgjithësi. Ndoshta për ta hequr këtë dyshim në raport rreth kësaj çështjeje do të ishte mirë të jepen më shumë detaje, ashtu që ne ta kemi më të qartë se për çka bëhet fjalë saktësisht. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Morina e ka fjalën.

SALIH MORINA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Besoj që u tha edhe nga kolegët lidhur me raportin e Auditorit të Përgjithshëm, që ka të bëjë me performansën, njëkohësisht për ngritjen e kapacitetit të tyre. Mendoj që një raport i tillë është një sinjal pozitiv, mirëpo çështja që mua më brengos janë opinionet, të cilat pak a shumë e ngrenë kualitetin e buxhetit të organizatave buxhetore dhe shqetësuese për mua është pikërisht çështja e 8 komunave. Raporti i 8 komunave për të cilat është një opinion i kundërt, apo një opinion për të cilat pasqyrat financiare nuk janë përmbyllur në mënyrë të drejtë dhe njëkohësisht kemi të bëjmë me një keqmenaxhim të buxhetit të këtyre komunave.

Një shqetësim tjetër që është paraqitur në këtë raport, u përmend edhe nga parafolësit, kolegët deputetë, është edhe çështja e qirasë, për të cilën kjo zyrë e ka një buxhet jo të mjaftueshëm dhe jo të kënaqshëm, që i ndahet nga Parlamenti, përkatësisht nga Qeveria. Mirëpo, pjesa më e madhe e buxhetit që është paraqitur në këtë raport dedikohet për qiranë. Prandaj, do të ishte mirë që në këtë rast të mendohet edhe nga Qeveria, që gjithsesi Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, si njëra prej zyrave më të rëndësishme, të cilat kryesisht merret me çështjen e shpenzimit të parasë publike, të ketë hapësira publike, në kuptimin e asaj që ato mjete buxhetore që i janë ndarë për qira t'i shfrytëzojë për çështje tjera.

Do të thotë, unë e përgëzoj edhe një herë Auditorin e Përgjithshëm për një raport të tillë, në të cilin e ka dhënë një pasqyrë reale të Buxhetit të Kosovës në përgjithësi nga të gjitha organizatat buxhetore, prandaj Grupi Parlamentar i LDK-së e tha fjalën e vet që ky raport do të mbështetet dhe do të përkrahet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur. Kërkoj nga regjia të verifikojë numrin e deputetëve në sallë. Ju lus t'i ftoni deputetët për të votuar.

Atëherë, pasi nuk kemi kuorum, votimi mbetet për seancën e ardhshme. Mirupafshim!

Përgatiti:

Njësia për Transkriptim dhe Lekturë